

**SEKRETET PUBLIKE TE MAQEDONISE:
SI E PERMBYS KORRUPSIONI NJE VEND**

14 GUSHT 2002



Raport i ICG në Ballkan N°133
Shkup/Bruksel

TABELA E PERMBAJTJES

PERMBELEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	i
I. HYRJE	4
II. QENDRIMET NDAJ KORRUPSIONIT	6
III. SPEKTRI I KORRUPSIONIT	8
A. NGERTHIMI I PLOTË I SHTETIT: SKANDALI NE TRANSPORTIN E MALLRAVE	8
1. Evolucion i problemit	9
B. KORRUPSIONI DHE MARRËVESHJA E OHRIT: VJELJA E FONDIN SHËNDETËSOR RAPORTIN E GRUPIT UDHËZUES	10
1. Pasojat.....	11
C. KORRUPSIONI MULTIETNIK: TRANSANKCIONET 'E KUSHTËZUARA' NË NJË MINISTRI	12
D. KONFRONTIMI ME HUA-DHËNËSIT NDERKOMBËTARË: RASTI I TELEKOMIT TË MAQEDONISË	15
E. PRIVATIZIMI I RAFINERISË OKTA	16
F. UJDIA E BRENDSHME: BANKA E MAQEDONISË.....	18
G. PRESIONET NDAJ GJYKATAVE: MARRJA E MAK TABAK	20
H. TRAFIKIMI SHTETEROR: TREGTIA ME DUHAN	21
I. BASHKEPUNIMI NDER-ETNIK NE KONTRABANDE	23
IV. KONSPIRACION APO MARREVESHJE: SI NDIHMOI KORRUPSIONI TË SJELLE MAQEDONINE NE PRAG TE LUFTES	25
A. NUK KA KOMPLOT TË MADH.....	25
B. KRIMI, KORRUPSIONI DHE KAPACITETI NË RRRITJE PER KONFLIKT: PROBLEM SHQIPTAR APO RAJONAL?.....	28
V. PERPJEKJET E MJERRA TE QEVERISE KUNDER KORRUPSIONIT	30
VI. SI NDIHMON KOMUNITETIT NDERKOMBËTAR QË KORRUPSIONI TË JETË I MUNDSHËM.....	31
A. TESTIMI I ANGAZHIMEVE NDERKOMBËTARE: LIGJI ANTI-KORRUPSION	33
B. HUMNERA E UDHEHEQESISE NDERKOMBETARE	34
VII. KONKLUDIM: GJETJA E MËNYRAVE PËR TA LUFTUAR KORRUPSIONIN TANI	38

SHTOJCA

A. HARTA E MAQEDONISE	44
B. RRETH GRUPIT NDERKOMBETAR PER KRIZE.....	45
C. RAPORTI I ICG DHE DOKUMENTACIONET KONSULTATIVE	46
D. BORDI I ANETAREVE TE ICG.....	52

SEKRETET PUBLIKE TE MAQEDONISE:

SI E PERMBYS KORRUPSIONI NJE VEND

PERMBELEDHJE E PERZGJDHUR DHE REKOMANDIMET

Korrupsioni në Maqedoni, sidomos në qarqe të larta të Qeverisë, është është në përmasa te gjera. Evoluimi I tij ka kaluar nga eksploatimi pasiv ne koercion aktiv dhe arrin kapacitetin jo vetëm që të retardojë progresin ekonomik por edhe të ushqejnë krimin e organizuar, dhe më pastaj jostabilitetin politik dhe kolektiv. Në fakt, shteti ka arritur pikën që të funksionojë si një 'kaos' në çështje të rëndësishme, përderisa reketarët depërtojnë në një kulturë cenzure.

Kjo sëmundje ka infektuar sistemin bankar si dhe strukturat qeveritare, duke bërë kështu Maqedoninë burrim dhe pikë tranzite për kontrabandën dhe kriminalitetit. Ky system inkurrajon administratën autokrate përderisa koekziston mjaft me komoditet me joefikasitetin dhe politizimin e gjyqësisë Kjo degradon moralin e Maqedonisë, duke lënë kështu shoqërinë civile në letargji ndërsa popullatën në përgjithësi në cinizëm.

Marrëveshja Kornizë e përmbyllur në Ohër, në gusht 2001 ndërpreu luftën që me të shpejtë shkante kah një luftë civile, por marrëveshja mvaret nga mundësia e saj për të zhvilluar institucionet demokratike dhe ekonominë e tregut. Korrupsioni që edhe më tej vazhdon ta kapërdijë vendin në shumë mënyra është një aktivitet I përbashkët mes komuniteteve. Në pikën minimale, me të madhe po dëmton ekonominë dhe rrit shkallën e jostabilitetit shoqëror. Sidoqoftë, korrupsioni gjithashtu josh konspiracion të plotë mes liderëve etnikë për të rritur tensionet dhe luan një rol të rëndësishëm për të sjellur vendin në gjendje të gatshme për luftë. I lënë për t'u keqësuar dhe zgjeruar më tej, do të vazhdojë të shkatërrojë unitetin fragjil të Maqedonisë dhe që të sjellë efekte të rrezikshme me intenzitete të ndryshme në Ballkanin Perëndimor.

Fatkeqësisht, komuniteti ndërkombëtar jep vetëm pak indikacione që pranon se sa fort korrupsioni punon kundër objektivave fundamentale në Maqedoni. Zyrtarët zakonisht arsyetojnë Maqedoninë me frazën boshe ' korrupsioni është problem në të gjithë vendet në tranzicion'. Jo shpesh, zyrtarë të lartë ndërkombëtarë parashtrojnë kërkesa morale për Maqedoninë që të pastrojë punët e veta, por këto kërkesa asnjëherë nuk janë marrë më seriozitet. Disa herë, investitorë të huaj oportunistë e intensifikojnë problemin.

Strategjia tejet e dobët ndërkombëtare potencon 'procesin' dhe 'krijimin e kapaciteteve'- miratimin e ligjeve dhe trajnimin e zyrtarëve, siç thotë një zyrtar, 'për të zvogëluar mundësitë e korrupsionit'. Në ndërkohë, duhet vetëm pak përpjekje për të analizuar pse kjo qasje nuk ka arritur rezultate kuptimplota, pse p.sh. prokurorët nuk veprojnë sipas të dhënave të shumta që posedojnë mbi korrupsionin or më saktë atje ku pretekstet e procedurës kriminale lejojnë që zyrtarët e korruptuar të vazhdojnë më tej dhe që fitimet e papastërta t'u mbeten atyre.

Komuniteti ndërkombëtar insiston në atë se Maqedonët marrin mbi vete 'pronësinë' e problemit (përgjegjësinë), përderisa 'pronarët' ende janë vetë ata- ata në pozita të larta qeveritare- të cilët vazhdojnë të dominojnë, eksploatojnë dhe rrezikojnë institucionet. Në rrethana aktuale, është naivitet dhe neglizhencë që të mbështetesh në vëzhgues të dobët vendorë siç është Ombudsman, Komisionin e ardhshëm Anti-Korrupsion, apo mediave dhe shoqërisë civile, për t'u ngritur vetëm kundër elitës së korruptuar. Me dërrdhjen e parave në Maqedoni dhe pa insistuar për një përpjekje më serioze kundër korrupsionit, komuniteti ndërkombëtar thjeshtë po mbush vrimat në buxhet dhe si rastësisht vepron si një nga fasilitatorët e sistemit.

Shpesh diskutohet rreth asaj se ' nëse me ata merremi me pçështjen e korrupsionit atëherë ata s'do të angazhohen rreth implementimit të Marrëveshjes së Ohrit'. Por dështimi në këtë dëmton pikërisht marrëveshjen drejt së cilës diplomatët I kanë koncentruar energjitë e veta.

Këtu atëherë nevojitet një pikëpamje krejtësisht e ndryshme. Maqedonia nuk është' vetëm edhe një vend tjetër në tranzicion" por një shtet me të vertetë të dobët me sfida të jashtme dhe të brendshme deri në vetë ekzistencën. Kjo do të thotë se korrupsioni sjell dëme specifike dhe se në fakt, Maqedonia ose mund të korrupsion të lartë ose stabilitet, por jo të dyjat.

Udhëzime të jashtëzakonshme duhen për këtë. Për të plotësuar programet aktuale për 'krijimin e kapaciteteve', komuniteti ndërkombëtar duhet të bëjë ndryshime fundamentale në qasjen e vet. Duhet të luajë rolin e katalizatorit dhe jo vetëm të një këshilltarit të thjeshtë dhe në mënyrë të guximshme të kërkojë reforma nëse mendojnë të vazhdojnë me asistencën financiare, dhe duhet të dakordohet për t'u fokusuar në përpjekjet e veta anti-korrupsionit në mënyrë retrospective dhe ndëshkuese, dhe jo thjesht potenciale dhe instructive. Edhe pse ky raport përmban shembuj specifikë, është shkruar me kujdes duke respektuar të drejtat e individit. Sidoqoftë, ICG është e gatshme të diskutojë rreth një sërë çështjesh në më shumë hollësi nëse I kërkohet ta bëjë këtë korrektësisht, para strukturave të autorizuara qeveritare dhe legjislative.

Gjithashtu, përderisa ky raport ka të bëjë me të tashmen dhe të kaluarën e afërt dhe se mund të duket që koncentrohet në partitë tani në pushtet, korrupsioni është një aspekt i kulturës politike të vendit, dhe jo mbrojtëse eksklusivë të ndonjë grupi të veçantë. Për të qenë sulmi ndaj korrupsionit sa më efektiv, të gjitha partitë politike duhet të bashkojnë përpjekjet, së bashku me shoqërinë civile dhe komunitetin donator ndërkombëtar. Korrupsioni kategorikisht nuk është një çështje që I përket, apo që duhet të keqpërdoret për qëllime politike entuziaste., dhe do të ishte gabim I madh nëse besohet se ndërrimi I qeverisë me zgjedhjet e shtatorit 2002 automatikisht do ta largonte problemin.

REKOMANDIMET

Qeverisë së Maqedonisë dhe partive politike:

1. Zotohuni që të luftoni korrupsionin duke e vënë si prioritet parësor që vazhdon edhe përtej jetës së qeverisë aktuale dhe zgjedhjevetë 2002, dhe këtij zotimi jepini nje formë konkrete duke pranuar propozimet dhe strategjitë e komunitetit

ndërkombëtar përfshirë këto që përmenden më poshtë si dhe ato të dhëna nga shoqëria civile.

Donatorëve të mëdhej ndërkombëtarë, përfshirë Unionin Evropian dh vendet anëtare dhe dhe SHBA-ve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare:

2. Të dallojnë rolin e korrupsionit që ndihmon në jostabilitetin e Maqedonisë dhe të pranojnë nevojën për të luajtur rolin udhëheqës për ta luftuar atë.
3. Të zhvillojnë programe dhe pozita strategjike që do të merren me korrupsionin në të kaluarën, dhe jo vetëm me parandalimin e episodave në të ardhmen.
4. Të identifikojnë si fusha prioritare për një aksion përmirësues ata sektore që janë veçanërisht të rrezikuara nga korrupsioni për shkak të mundësive përfituese që ofrojnë ato apo që janë të ndjeshme ndaj ndëshkimit dhe parandalimit të korrupsionit; në veçanti, kërkohet që qeveria e Maqedonisë të dakordohet me emërimin e 'vëzhguesve' ndërkombëtarë që të punojnë Brenda Fondit për Sigurim Shëndetësor, Shërbimit Doganor, zyrës së Prokurorit dhe Gjykatësve.
5. Qeverisë t'I vejnë kusht mbi ndihmën financiare, në veçanti përkrahjen për të gjitha balancimet e pagesave dhe përkrahjen e buxhetit, mbi reformat e njëmendta anti-korrupsion, dhe të punojnë me qeverinë në zhvillimin e standardeve realiste në vlerësimin e besimit të mirë dhe efektivitetit.
6. Të Make convictions and confiscations the express goals për arritjen e rezultateve të një strategjie për anti-korrupsion, si një plotësim I qasjes ekzistuese që nënvizon përmirësimin e 'kapaciteteit' të institucioneve të Maqedonisë dhe forcimin e kornizës ligjore.
7. Të inkuadrojnë elemente specifike 'të vazhdimësisë në të gjitha përpjekjet anti-korrupsion.
8. Të sigurojë përkrahje financiare për Komisionin e posa formuar qeveritar Anti-korrupsion, kështu që të mund të veprojnë në mënyrë efektive menjëherë pas lansimit, në tetor 2002, si dhe përkrahje për përpjekjet e shoqërisë civile Transparenca Ndërkombëtare e Maqedonisë në zhvillimin e një strategjie anti-korrupsion dhe për ndërtimin e një 'koalicioni anti-korrupsion'.

9. Të nxisë miratimin e ligjeve gjë që do të kufizonte fushë-veprimin e partive pushtetare për të emëruar kuadro në bazë të patronazhit politik para punësimit bazuar në aftësi.
10. Të angazhojnë partitë politike shqiptare dhe shoqërinë civile në mënyrë më aktive në përpjekjet anti-korrupsionit.

Unionit Evropian (UE):

11. Të emërojë një Këshilltar të UE për Anti-Korrupsion në Maqedoni, me qëllim që të plotësojë punën e Përfaqësuesit Special të UE.

Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN):

12. Të zbusë restriksionet për angazhimin e e një personeli shtesë në Zyrën e Revizionit Shtetëror dhe agjensive relevante.
13. Të caktojë caqet e të ardhurave të rritura për ministrat atje ku korrupsioni Set targets of increased revenue for ministries ëhere corruption zvogëlon të ardhurat.

Shkup/Bruksel, 14 gusht 2002

SEKRETET PUBLIKE TE MAQEDONISE: SI E PERMBYS KORRUPSIONI NJE VEND

I. HYRJE

Implementimi I Marrëveshjes Kornizë – nënshkruar në Ohër më 13 gusht 2002- mbetet mjete matës I progresit në Maqedoni që nga konflikti I ndërsjellë e deri stabiliteti demokratik. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishme për realizimin e kërkesave kyçe që dalin nga Marrëveshja. Rikthimi I policisë në 'zonat e krizës' (më herët nën kontroll të forcave kryengritëse shqiptare) ka përfunduar, shënuar me ca incidente dhe vetëm me protesta të kohëpaskohshme. 90 për qind personave të zhvendosur si rrjedhojë e konfliktit janë kthyer në shtëpitë e tyre.

Më 7 mars 2002, Kuvendi miratoi ligjin për Amnesti të gjerë, duke u hequr frikën ish-kryengritësve shqiptarë për arreste dhe akuza si 'terroristë'. Më 30 maj 2002, u miratua ligji që lejon përdorimin e gjuhës shqipe në lejet e njoftimit, dhe më 20 qershor, u aprovuan edhe pesëmbëdhjetë ligje të tjera të dale nga Marrëveshja e Ohrit të cilat përkrahin të drejtat për gjuhën dhe që u jep bashkësive locale një rol më të madh në zgjedhjen e shefave të policisë.

Qëndrimet e komunitetit ndërkombëtar kanë hasur në më pak konfrontime. Kryeministri Ljubčo Georgievski propozoi vazhdimin e mandatit të Misionit të NATO-s, duke treguar faktin se Aleanca, edhe pse e shfrytëzuar si qengj kurban nga ana e politikanëve vendas ka demonstruar efektivitetin e vet dhe ka ofruar ndihmë të paanshme.

Megjithate progresi ende është fragjil. Zyrtarët ndërkombëtarë vlerësojnë se plani për 'rikthimin' e policisë më tepër është sipërfaqësor, duke përfshirë kryesisht vizita simbolike në fshatrat shqiptare. Në rajonet më herët të përfshirë nga kriza mungon policia e uniformuar, duke I lënë kështu maqedonasit

veçanërisht të rrezikuar në ato zona ku ata janë pakicë.¹ Burrimet ndërkombëtare vazhdimisht vejnë në dijeni se ka inflirtime, se mund të vijë deri te sulme ndaj pozicioneve të largëta të ushtrisë maqedone dhe se disa ish-komandantë të UCK-së vazhdojnë të jenë të armatosur dhe marshojnë përreth.

Përkundër numrit të madh të refugjatëve të kthyer në vend, UNHCR dhe ICRC bëjnë të ditur se pakicat maqedonase ende vuajnë nga persekutime të nivelit të ulët', dhe se rindërtimi I shtëpive që shkon ngadalë dhe probleme tjera me infrastrukturën parandalojnë kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre. Thuhet që pakica shqiptare e qytetit jugor-Manastir po shet pronat e veta si pasojë e incidenteve që kanë ndodhur, njëllos si edhe pakicat etnike në zona të tjera. Sondazhi I paradokohshëm tregon se konflikti I vitit të kaluar ende ka peshë ndaj qëndrimeve etnike. Maqedonasit vazhdojnë të kundërshtojnë kompromiset e arritura në Ohër, përderisa shqiptarët ankohen për ndryshime të pakta praktike në jetën e tyre.²

Komponenti më I madh I Marrëveshjes së Ohrit-decentralizimi I Qeverisë-po fillon me vështirësi.

¹ Zyrtarë të UNHCR nënvizojnë se madje edhe kthimi simbolik I patrullave 'të përziera' jep përshtypje të gabuar. Në shumë fshatra, këto patrulla 'të përziera' nuk kanë anëtarë të komunitetit maqedon, të cilët I frigohen pasigurisë. Intervistë me UNHCR, më 8 gusht 2002.

² Një anketë e finansuar nga Departamenti I Shtetit amerikan, realizuar në maj 2002, ofron të dhëna se 2/3 e maqedonasve kundërshtojnë Marrëveshjen e Ohrit, përderisa 90 për qind të shqiptarëve përkrahin atë. 3/4 e shqiptarëve mendojnë se implementimi shkon tepër ngadalë. Zyra e Departamentit të Shtetit për Hulumtim dhe Analizë të Opinioneve " Opinioni Publik në Maqedoni Teston Fatim e Marrëveshjes Kornizë: qëndrimet ndaj ligjeve të marrëveshjes ndajnë linjat etnik", 8 maj 2002, pf. 1-2.

Madje edhe instrumenti kyç- Ligji I ri mbi Vetë-qeverisjen Lokale –në esencë siguron vetëm një kornizë duke lënë kështu detajet kritike për t'u negociuar më vonë. Deklarata e rëndësishme shoqëruese – Ligji mbi Finanat Lokale – nuk do të aprovohet para vjeshtës, dhe kjo ndodh përafërsisht në të njëjtën kohë kur do të bëhet edhe regjistrimi I popullsisë, që pritet të jetë mjaft kontravers.

Gjithçka përveç vetë-qëndrueshmërisë, procesi I Ohrit ka kërkuar vëmendjen konstante të reshes nga ndërmjetësues ndërkombëtarë: Emisarin Amerikan James Holmes,³ Ambasadorin Laërence Butler, dhe Përfaqësuesin e UE, Alain LeRoy. Ata kanë punuar bashkarisht dhe në mënyrë efektive, mirëpo edhe kur ata arrijnë të kalojnë ngecjet, nëse mund të themi kështu, përdorimi I gjuhës shqipe në kopertinën e pasaportave të Maqedonisë, ose selektimi I anëtarëve të komisionit zgjedhor, njëra nga partitë vazhdimisht bën pengesa, duke krijuar nevojën për ndërmjetësime të tjera.

Detyra e ndërmjetësuesve ka hyrë në një fazë të re, madje edhe më komplekse, me një fushatë zgjedhore që akoma nuk ka filluar zyrtarisht⁴ por që tash më ka dhënë shenja shqetësuese të një retorike edhe më radikale.⁵ Fushata nga të dyja anët (njëra mes komunitetit shqiptar dhe tjetra mes atij maqedon, në veçanti) ka shumë shansa të luajë me kartën nacionaliste dhe kështu të polarizojë vendin edhe më shumë.⁶

Pasi Maqedonia u afrohet zgjedhjeve Parlamentare, të caktuara për 15 shtator 2002, partitë opozitare të të dy kampeve vazhdimisht shprehin shqetësimin për dhunë gjatë votimeve, friksime dhe manipulime-që të gjitha elemente të pranishme në zgjedhjet e kaluara. Disa diplomatë të lart shqetësohen për atë se partitë maqedone dhe shqiptare në pushtet madje edhe mund të veprojnë bashkarisht për nxitur incidente etnike apo të frikësojnë votuesit duke treguar forcë. Këto shqetësime fitojnë në peshë nga disa të dhëna të dyshimta të policisë⁷, sidomos njësisë speciale të njohur si 'Luanët', që gjendet nën komandë të Ministrit për Punë të Brendshme, Ljube Boshkovskit.

Harxhimet rreth zgjedhjeve veç më kanë vështirësuar rimëkëmbjen e ekonomisë. Pasi Maqedonia realizoi fundamentin legjislativ të Marrëveshjes së Ohrit, donatorët premtuan më shumë se çerek miliardë dollarë amerikanë në konferencën e donatorëve mbajtur më 12 mars 2002, për të finansuar rindërtimin dhe reformat, por e dhënë si një kusht mjaft I qartë për komponentin e vetëm më të madh-165 milionë dollarë si ndihmë për balancimin e pagesave- që Maqedonia të arrijë marrëveshjen (përkrahëse) Stand-by me FMN. Bisedimet ngecën kur qeveria refuzoi të zvogëlojë shpenzimet për zgjedhjet.⁸ Si rezultat I kësaj, donatorët kanë tërhequr prapa 115 milionë dollarë të dedikuara për të plotësuar zbrastirën në pagesat.⁹

³ Më 11 korrik 2002, qe kumtuar se roli I Holmse kishte mbaruar. Nga Uashingtoni ka indikacione se ai nuk do të zëvendësohet.

⁴ Zgjedhjet janë caktuar për 15 shtator 2002 .

⁵ Si një shembull, lideri I PDSH, Arben Xhaferi veten e ka deklaruar për "radikal" dhe një përkrahu një retorikë të përshtatshme. Shih "Xhaferi: Ne jemi radikalët"; *Fakti*, 10 qershor 2002: "Kur u formua partia [e Ahmetit] ... mendova që do të bëhemi një parti e moderuar, por pas prezantimit të tyre të parë, atë pozicion do ta marë partia e tij [Ahmetit]. Pa dyshim, ne jemi ato që do ta vazhdojmë politikën tonë radikale," tha kryetari I PDSH, Arbën Xhaferi, në fjalimin e tij mbajtur në Tetovë më 8 qershor." Ali Ahmeti, I cili që të rehabilitojë imazhin e tij prej "terroristi", u përpoq të barazohet me Xhaferin, me përdorimin e fuqishëm të imazhit shqiptar në paraqitjen e tij të parë që nga konflikti, në Shkup, në hapjen e zyrës së partisë së tij, BDI, më 30 qershor 2002. U këndua hymni shqiptar dhe u mbajt homazh për luftëtarët e rënë të UCK.

⁶ Ashtu siç maqedonët asnjëherë nuk pushojnë së theksuari, në Maqedoni ka grupe tjera përveç 'dy të mëdhave'. Megjithatë, sipas regjistrimit të v.1994 turqit, Serbët dhe të tjerët përbëjnë vetëm deri 1/3 e popullsisë. Si në pjesët tjera të Ballkanit, këto pakica të vogla nuk kanë pretendime

territoriale dhe, për këtë ata nuk paraqesin burrim kryesor të konfliktit.

⁷ Mes probleme kryesore sa I përket veprimeve të policisë, është vrasja e shtatë 'terroristëve islamikë' të dyshuar, më 2 mars 2002 . Ministria ka nxjerrë një libër 'të dhënash' mbi të dyshuarit, por gazetarët që kanë hulumtuar rastin thonë se ata ndodh të kenë qenë 'refugjatë ekonomike' të pafat, në rrugë drejt hyrjes ilegale në Bashkësinë Evropiane. Shih "Ruga për në Evropë Rrit rrezikun për Refugjatët Optimistë Myslimanë", *Wall Street Journal*, 28 may 2002, dhe "Qeveria e Maqedonisë Insiston se Personat e Sulmuar ishin Terroristë", *Wall Street Journal*, 4 qershor 2002. Komuniteti ndërkombëtar disa herë ka kërkuar shpërbërjen e 'Luanëve'; shih *inter alia* Dokumentacionin e Punës së Stafit të Komisionit Evropian, ish-Republika jugosllave e Maqedonisë, Raporti I Stabilizim-Asociimit, Bruksel, SEC (2002) 342, f.8.

⁸ Qeveria aprovoi një postë pëer bankën e kursimeve-TAT dhe pranoi kërkesat e punonjësve shtetërorë për rritje prej 10 për qind të rrogave, duke iu kundërvënë paralajmërimeve të ashpra të MNF..

⁹ Informata nga ekspertë bankarë bë Shkup. Ndihma për rindërtim dhe implementimin e marrëveshjes së Ohrit nuk ndikohet nga bisedimet e dështuara të FMN..

Ekspertët ndërkombëtarë thonë se ende nuk ka përmirësime në ekonomi. Prodhimtaria është zero, rritja e papunësisë alarmuese për të dyja komunitetet, dhe numri i pjesëtarëve të komunitetit maqedonas që po migrojnë është më i madh se kurrë.¹⁰ Ata nga brenda thonë se reputacioni i qeverisë për korrupsion edhe më tej pengon FMN që të përkrahë finansimin e programeve apo që të lehtësojë caqet e defiçitit në buxhet të cilat mund të nxisin ndgripte. Thënë shkurt, papërgjegjësia e vet qeverisë sjell deri tek një situatë strikte që mund të jetë e papërshtatshme për një ekonomi të dobët.

Situata kritike me kredite është një arsye tjetër për ekonominë e dobët, por Banka Qendrore operon me kamata të larta, duke i sjellë kështu hua-marrësit në gjendje që të mos paguajnë dhe duke dekurajuar bankat që të japin kredi dhe këtu janë afaristët që me ngulm kërkojnë, sepse kjo shpreh edhe nevojën që të vëzhgohet dekadencia e qeverisë në lidhje me zgjedhjet.

Si total, intervenca më e suksesshme e komunitetit ndërkombëtar në Ballkan është relative dhe e kufizuar. Qëllimi përfundimtar për një process stabil dhe të vetë-qëndrueshëm që lejon një profil të zbehur ndërkombëtar mbetet i paqartë. Del pyetja, pse?

Distanca mes dy komuniteteve më të mëdha është sqaron më shumë nga të gjithë. Por kjo thjesht deklaron një fakt- komuniteti shqiptar dhe ai maqedon është i ndarë. Sidoqoftë, ndarja nuk shpjegon pse ata në 2001gati sa hynë luftë. Dhe kjo pikëpamje as edhe nuk siguron ndonjë zgjidhje, tjetër nga ndarja territoriale, që mund të ishte po aq e vështirë për t'u negociuar sa edhe për t'u realizuar dhe do të gjeneronte një sërë trazirash të rrezikshme në mbarë rajonin.

Shmangja e ndarjes dhe komplikimeve që ngreh pas vetes- jo thjesht duke arritur aprovimin nominal të ligjeve të Marrëveshjes së Ohrit- është interesi ndërkombëtar i vërtetë në Maqedoni. Korrupsioni në masë të gjerë është faktori më i madh që kontribuon në forcat centrifugale që ende veprojnë në Maqedoni. Marrëveshja e Ohrit për të zbutur konfliktin etnik me decentralizimin e institucioneve qeveritare dhe me nxitjen e përfaqësimin të shqiptarëve në këto institucione mund të ketë sukses

deri në atë masë vetëm me funksionimin të institucioneve në mënyrë efektive dhe me kredibilitet. Me fjalë tjera, në një shtet sa më demokratik dhe sa më pak etnik mund të arrihet nëse shqiptarët dhe maqedonët e shohin mundësinë për të prezantuar pakënaqësitë përmes shtetit.

Megjithatë, në vent të zbutjes së dallimeve etnike përmes pushtetit të ndarë mes vete, partitë në pushtet kanë funksionuar si koalicione korrupsioni, duke ndarë fushë-veprimet mes dhe përbrenda ministrive, dhe madje edhe duke shkuar ndarazi në eksploatim. Ndarja e 'fushë-veprimeve' funksionon si një provë gjenerale për ndarjen e territorit pasi politikanët me inizëm paraqesin veten si mbrojtës të intereseve kombëtare, përderisa në fakt, duke komplotuar me palën tjetër për përfitime/pasurime personale apo partiake. Me thellimin e korrupsionit dy-etnik (dy-palësh), po bëhet edhe më rrezikshëm- një kaos ku inspekcioni qeveriar bashkon bizneset e forta në 'blerje'. Si pasojë, këta trazues kanë kështu mjetet (shuma të mëdha për para në dorë/ kesh) dhe motivin (frikën për revansh juridik dhe politik) për elitat pushtetare që të influencojnë zgjedhjet në prag të të cilave jemi, duke u kërcënuar ose blerje totale të votave.

Kuptueshëm, maqedonët shpesh ankohen për rrezikun e një kryengritjeje ndër-kufitare nga Kosova. Megjithatë, shumë më pak vëmendje i kushtohet kontrabandës dhe trafikimit të armëve, jo vetëm nga kontrabanduesit me mushka, por edhe nga aktivistë që bashkëpunojnë me vet autoritetet.¹¹ Tejet e injoruar është linja kritike mes korrupsionit dhe trafikimit- një zhvillim destruktiv që ka implikime jo vetëm për Ballkanin Perëndimor, por gjithashtu edhe më gjerë në Evropë. Siç thotë një ekspert, ' korrupsioni siguron oksigjen për krimin e organizuar(I jep jetë), dhe në disa mënyra është problem shumë i madh. Është vështirë të

¹⁰ Të dhënat e siguruar nga ICG bëjnë të njohur se aplikimet për emigrim, të cilat kryesisht vijnë nga maqedonët, dhe që vijnë në adresë të disa ambasadave kryesore , gjatë vitit të fundit janë dyfishuar.

¹¹ Në të vërtetë, vetë fjala ' kontrabandë', që do të thotë vjedhje dhe fshehje nga autoritetet, nuk ka përdorim të drejtë në Maqedoni dhe, ndoshta edhe në rajon.

Vëzhgues thonë se pjesë e konsiderueshme e 'kontrabandës' bëhet në bashkëpunim me, apo madje nga zyrtarët qeveritarë, dhe thonë se termi "trafikim shtetëror",do të ishte më i saktë se fjala e përdorur 'kontrabandë'. Terminologjia është më tepër se një çështje akademike, pasi që vendimet strategjike rrjedhin nga të kuptuarit e supozuar të problemit. Iniciativa për Bashkëpunim në Evropën Jug-lindore (SECI), për shembull, vepron në bazë të asaj se një bashkëpunim më i mirë mes autoriteteve të doganës dhe policisë do të ndihmonte në ngulfatjen e 'kontrabandës', edhe pse një komponentë e rëndësishme e problemit ka të bëjë me komplikueshmërinë e zyrtarëve të të dy institucioneve.

parashtrohet sepse ai vepron përbrenda kornizës ligjore, duke involvuar edhe aktorët ligjorë. Është e lehtë që të ndalosh ata që janë të korrumpuar në nivel të ulët, për shembull, ...rojet kufitare... por ata të nivelit të lartë të korrupsionit, është e vështirë t'i eliminosh."¹²

Trashëgimia kolektive e vendit nga periudha socialiste, ndërmarrjet e saj shoqërore dhe shtetërore, shumë shpesh janë privatizuar në një mënyrë tejet jo-transparente. The fundi rezulton me një shtet të dobët me kufij jo aq të sigurtë dhe ekonomi të dobët- një shtet që dëshpëron respektimin e ligjit dhe që krijon ekstremistë, duke hidhëruar ata që ndjejnë se iu është mohuar pjesa e vet ose që I kanë injoruar parimet e tyre për para. Një zyrtar I lartë I Qeverisë është kategorik kur thotë ' korrupsioni është kërcënimi më I madh ndaj sigurisë sonë kombëtare'.¹³

Me rritjen e cinizmit dhe pesimizmit, sidomos mes maqedonëve, shoqëria civile po dobësohet, duke lënë kështu zyrtarët e korrumpuar në rehati dhe paturpësi. Me vazhdimin e ciklit në teposhtëzë, shanset për konflikt rriten. Ligjet e reja të Ohrit, shpesh duken jorelevante në sytë e shqiptarëve të papunë dhe në anë tjetër, poshtëruese për maqedonët e dekurajuar.

Ky raport përshkruan korrupsionin në detaje, duke treguar se si funksionojnë disa këto malverzime dhe çfarë domethënë kjo për stabilitetin e Maqedonisë. Gjithashtu teston se sikomunitetit ndërkombëtar përgjigjet e ndaj korrupsionit, dhe si kjo të përmirësohet më tej. Nuk të habit ajo se një komunitet ndërkombëtar që punon mbi agjendën imediate të Ohrit ka aq pak zell për të konfrontuar qeverinë për çështjen më sensitive, siç është kjo. Sidoqoftë, fakti dëshpërues është as UE, ose një lojtar I rëndësishëm individual si SHBA-të, dhe as ndonjë tjetër organizatë ndërkombëtare nuk po nrgrihet dhe marë përgjegjësinë për të luftuar korrupsionin.¹⁴ Ky vakum I udhëheqësisë ua lë çështjen në dorë të

instituvioneve, asociacioneve dhe programeve që në përgjithësi supozojnë bashkëpunim me besim të mirë mbi palën e autoriteteve. Për shembull, GRECO-raporti I Këshillit të Evropës mbi korrupsionin në Maqedoni do të basohet në një pyetësor I plotësuar nga vetë qeveria.¹⁵

Qasja ndërkombëtare ndaj korrupsionit predikohet në dy koncepte të gabueshme fundamentale; se liderët e Maqedonisë kanë interes që ta ndalojnë problemin,¹⁶ dhe se Maqedonia ka kohë, si çdo vend normal në tranzicion, që ta ndjekë 'planin afat-gjatë'. Duke derdhur ndihma në adresë të qeverisë për të pëëmbushur obligimet ndaj shqiptarëve pa kërkesa për reforma,¹⁷ donatorët akisidentalisht të apin përshtypjen tek shumë maqedonas se vetë projekti I Ohrit është një lloj 'mit/ korrupsion; në vend që të të japin pëërshtypjen e zemërgjerësisë dhe drejtësisë, komuniteti ndërkombëtar rrezikon të njëjloset si një nga 'fasilitatorët' e Maqedonisë.

Ka dy rreziqe në ndriçimin e çështjes së korrupsionit tani. E para është se kjo mund të zbeh prospektet për joshjen e investimeve të rëndësishme nga jashtë. Megjithatë, siç tha një zyrtar I lartë maqedon, I cili është angazhuar në çështjen e stabilitetit financiar, ' është më mirë që problemi të del në sipërfaqe dhe të përmirësohet, se sa të mbahet në errësirë'.¹⁸ E dyta është se, me publikimin e raportit në prag të

¹² Dr. Paddy Rawlinson, Ligjërues, Qendra për Kriminologji Komparative dhe e Drejta Kriminale, në Universitetin e Wales, thotë " Përmirësimi në forcimin e Ligjit dhe bashkëpunimin në aspektin e sigurisë për ta luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe trafikim e armëve", raport I seminarit të mbajtur më 15-16 qershor 2001, fondacioni Saferworld and EURISC, f.15.

¹³ Intevistë e ICG , 10 prill 2002.

¹⁴ Disa nga shtetet e interesuara, si Hollanda dhe SHBA finansojnë programe, por zyrtarët I përshkruajnë ato që të kenë qëllim për të parandaluar mundësitë për korrupsion, dhe jo për korrigjimin e keqpërdorimeve.

¹⁵ Intervistë e ICG Iniciativën e Paktit të Stabilitetit për Anti-korrupsion dhe me anëtarët e stafit të Këshillit të Evropës.

¹⁶ Vlerësimet e Kryeministrit Georgievski në konferencën e Institutit për Shoqëri të Hapur, me temën në fjalë, mbajtur më 21 qershor, të jep të kuptosh përpjekjen për ta hequr përgjegjësinë mbi problemin: "Ne balafaqohemi me një problem të paevitueshëm mbi atë neës korrupsioni ekskluzivisht I përket qytetarëve të Maqedonisë apo që korrupsioni I është imponuar Maqedonisë nga jashtë". Insuniata e Kryeministrit ishte se ka pasur korrupsion ndërkombëtar në ndihmën humanitare gjatë krizës kosovare të 1999. Shih " Vendi ynë ka qenë I ekspozuar për korrupsion", *Nova Makedonija*, 22 qershor 2002. Partia shqiptare PDSH ashpër ka kundërshtuar vlerësimet e ICG për pjesëmarrje në korrupsion. Përfaqësuesi I PDSH në parlament, I ka dërguar një letër ICG për këtë, më 25 qershor, dhe në të njëjtin takim, verbalisht ka komentuar se "ne nuk fitojmë nga korrupsioni aq sa ju mendoni", intervista e ICG intervieuë me Zamir Dika, 25 qershor 2002. revista e pavarur *Lobi* ka shkruar se ujdia kryesore mes PDSH dhe VMRO-DPMNE ËSHTË 1/3 / 2/3 e përfitimeve. "Maqedonia, pas një viti: Ku po shkojmë?", *Lobi*, 25 shkurt 2002.

¹⁷ Ndërprerja e finansimit për balancing e pagesave ishte rezultat I marrëveshjes së dështuar me FMN për Anrazhmanin Stand-by, dhe jo vetëm për shkak të korrupsionit *per se*.

¹⁸ Intervistë e ICG.

fushatës zgjedhore, ICG do të akuzohet për motive politike. Raporti domosdoshmërisht ka të bëjë me pamundësinë e qeverisë që aktualisht bart përgjegjësinë për çështjet e vendit. Me gjithatë, korrupsioni jo për herë të parë arriti në Maqedoni me ardhjen e qeverisë aktuale në pushtet, dhe një pjesë e materialit të prezantuar më poshtë ka të bëjë me politikanë dhe parti që aktualisht janë në opozitë dhe që deri në v. 1998 ishin në pushtet. Të dhënat nga ajo periudhë e kaluar të kujton se zgjedhjet e ardhshme jo se do të sjellin ndonjë zgjidhje për korrupsionin përkundër rezultateve. Qasja më e mirë për çdonjërin parti e cila është e interesuar të justifikojë luftën politike do të duhej të merrte në konsideratë rekomandimet e këtij raporti përkrahë iniciativat e shoqërisë civile, dhe të kërkojë për ndihmë më të plotë nga ndërkombëtarët.

Ky raport nuk ka për qëllim të ketë ndikim mbi zgjedhjet, por të sigurojë që çështja e korrupsionit dhe, çka është më me rëndësi, çfarë mund të bëhet rreth saj, të arrijë një spektër mundësisht sa më të gjerë në Maqedoni dhe mes komunitetit ndërkombëtar gjatë kësaj fushate. Nëse diçka nga përpjekjet për të pasur një qeverisje të mirë në Ballkan është e qartë, është se thjesht vetëm mbajtja e zgjedhjeve dhe shpresa 'se të tjerat do të jenë më të sinqerta', nuk është zgjidhje.¹⁹ Që të dy partitë më të mëdha maqedonase I kanë njollosur-të dhënat, ashtu si edhe dy nga partitë shqiptare. Tani është koha që qytetarët e Maqedonisë të pyesin jo vetëm se kush do të udhëheq me qeverinë e ardhshme, por si mund të funksionojë më mirë pa marrë parasysh përbërjen politike të saj.

Pikërisht për atë se qeveria si duket do të luan rolin brojtës, dhe për shkak se çfarë do qeverie e ardhshme do të luajë atë rol akoma më pak, tani është koha më e mirë që komuniteti ndërkombëtar të jetë më i guximshëm në parashtrimin e kërkesave për reforma dhe ofrojë asistencë. Diplomatët nuk duhet të konfutojnë qeverinë publikisht për të dhënat që ka, por ata duhet ta prezentojnë në konfidencë me iniciativa serioze, për shembull, të vendosin 'vëzhgues ndërkombëtarë' në disa nga institucionet që janë më ekspozuara për korrupsion. Kush do që do të fitojë në zgjedhjet 2002 do të jetë i lidhur për zotime. Rekomandime të tjera specifike janë më të

detajuara dhe përfshihen pjesën përmbyllëse të raportit.

¹⁹ Vazhdimësia e korrupsionit dhe joefikasitetit ekonomik në Kroaci, përkundër një qeverie që siç duket është më transparente dhe e sinqertë, është dëshmi e nevojës që të mbështetesh më shumë në parti dhe personalitete, se sa në ndryshim.

II. QENDRIMET NDAJ KORRUPSIONIT

Anketa më e gjerë që është organizuar ndonjëherë për qëndrimet publike në Ballkanin Perëndimor tregon se qytetarët shqiptarë dhe maqedonas në Maqedoni janë përafërsisht në masë të barabartë të distancuar nga liderët e tyre politikë.²⁰ Ata shprehën nivelin më të ulët të besimit publik ndaj qeverisë së tyre (12 për qind),²¹ ishin më pesimistët në parashikimet për ekonominë dhe mendimin më të ulët rreth të pavërtetave që plasojnë mediat lokale në rajon.

Pjesa më e madhe e të dy komuniteteve kanë identifikuar problemet më shqetësuese me të cilat ballafaqohet vendi, si papunësia, varrferia dhe korrupsioni— tri çështje që përfshinë politikat etnike. three issues that straddle ethnic politics. Në mënyrë të jashtëzakonshme ata i shqetëson korrupsioni dhe që dy palët dalin me përqindje gati të barabartë.²² Fokus-grupet të përgatitura nga Instituti Demokratik Kombëtar-NDI shpreh të njëjtin shqetësim: "Shqiptarët dhe maqedonasit thonë se [mes] problemet më të mëdha me të cilat ndeshet vendi janë.. mungesa e shtetit ligjor [dhe një] sistem që favorizon ata me lidhje personale dhe anëtarësi në partitë politike'. Pjesëmarrësit e lidhën korrupsionin me gjendjen e mjerrueshme ekonomike (çështje që shpesh ceket si më e rëndësishme). Një nga pjesëmarrësit shqiptarë thotë, ' korrupsioni tani është

forca dominuese në qeverinë tonë. Nëse nuk e eliminojmë atë, ne do të kemi më shumë varrferi'.²³

Ekspertët lokalë vazhdimisht paralajmërojnë për përmasat dhe dëmet nga korrupsioni. Nikola Tupançevski, përfaqësuesi i Maqedonisë pranë GRECO (Grup i Shteteve kundër Korrupsionit) iniciativë e Këshillit të Evropës, pak kohë më parë ka deklaruar se "Korrupsioni po kërcënon vendin tonë".²⁴ Kapitulli maqedon i organizatës jo-qeveritare, Transparency International, tha se "Korrupsioni është pranuar si diçka normale ose mënyrë e jetës"²⁵ shprehet për korrupsionin, Gjorgje Marjanoviç, profesor i drejtësisë në Universitetin e Shkupit dhe politikan në rradhët e opozitës, se "Maqedonia është shtet që nuk i nënshtrohet ligjit",²⁶ dhe se "Qeveria e Maqedonisë është një organizëm krejtësisht i papërgjegjshëm që përfundimisht duhet të vëhet nën mbikqyrje".²⁷

Sondazhet e biznesit japin gjykime të ngjashme. Bjë studim i Bankës Botërore i vitit 1999 gjen se '[Maqedonia] dhe Shqipëria tregojnë nivele të larta të korrupsionit administrative. Këto vende kanë administratë publike jashtëzakonisht të pazhvilluar dhe u mungon kontrolli dhe mekanizmat kontabiliste përbrenda shtetit'.²⁸ " Cmimi i lartë i korrupsionit" ishte dytësor vetëm për ' burokracinë shtetërore" pasi që problemi kryesor qëndron operimin e biznesit, sipas anketës së Transparency International, që arriti të kuptojë se katër nga dhjetë investitorë në Maqedoni duhet t'u jepnin mite inspektorët e doganave apo zyrtarët për të shmangur ndërhyrjet në punën e tyre.²⁹

²⁰ Sondazhi i Agjendës Publike për Evropën Jug-lindore u realizua në janar-shkurt 2002 nga Përkrahje të Demokracisë në Evropën Jug-lindore (SEEDS), finansuar nga Instituti Ndërkombëtar për Demokraci (NDI) dhe Asistencë për Zgjedhjet (International IDEA). Rezultatet e plota mund t'i gjeni në veb-faqen www.idea.int.

²¹ Serbia që radhitet në vendin e dytë për nga besueshmëria më e ulët: 29 për qind.

²² Sipas sondazhit të SEEDS, vetëm 3 për qind i ndajnë shqiptarët dhe maqedonët në seleksionimin e korrupsionit që të jetë në krye të problemeve shqetësuese (41.7 për qind për shqiptarët dhe 38.5 për qind për maqedonët, f. 5.) Anketa të tjera konfirmojnë të dhënat e IDEA-s, përfshirë edhe atë të bërë në nëntor 2001 nga Transparency International, që tregon se mbi 80 për qind thonë se në Maqedoni nuk respektohet ligji.

Sondazhi i janarit nga BRIMA-Shkup jep të dhëna se 64 për qind të atyre që janë përgjigjur besojnë korrupsionin nuk mund ta pakësojë rritja e kompetencave të qeverisjes lokale (siç shkruan në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit).

²³ "Qëndrimet ndaj Kushteve Politike, Ekonomike dhe Sociale në Maqedoni: Rezultatet e Hulumtimit të Focus Grupeve", Prezantuar nga Penn, Schoen & Bertland Associates (hulumtimi përkrahet nga NDI), 31 janar 2002, pp. 4, 7.

²⁴ Intervistë në revistën *Forum*, 28 mars 2002.

²⁵ Revista *Forum*, 28 mars 2002.

²⁶ Intervistë me Profesorin Gjorgji Marjanoviç, Revista *Aktuel*, 29 mars 2002. Gjithashtu, intervista e ICG Marjanoviç, 25 mars 2002.

²⁷ *Dnevnik*, 22 prill 2002.

²⁸ " Anketa e vitit 1999 për Mjedisin e Biznesit dhe Veprimtarinë Afariste (BEEPS)", me përkrahje të Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cituar në raportin e Grupit Udhëzues të Iniciativës së Paktit të Stabilitetit për Anti-korrupsion, "Masat për Anti-korrupsion në Evropën Jug-lindore— Shqyrtimet dhe reformat e vendit për reforma", Shtypi i Këshillit të Evropës: Strasburg, shtator 2001, f. 22.

²⁹ "Korrupsioni dhe Investimi i Huaj nuk mund të shkojnë sëbashku", *Dnevnik*, 15 shkurt 2002.

Me shkallë ndryshuese të besimit, organizatat ndërkombëtare dhe zyrtarët gjithashtu kanë bërë të njohur se korrupsioni në Maqedoni është I përhapur kudo. Raporti I mëhershëm I Komisionit Evropian mbi Stabilizim-asociimin thotë se 'korrupsioni është arsye e madhe për shqetësim korrupsioni në shërbimet publike është një problem I pranishëm kudo dhe zbeh besimin në institucionet politike dhe administrative'³⁰ Banka Botërore ka kuptuar se Maqedonia I nënshtrohet 'një korrupsioni administrativ' me nivel veçanërisht të lartë.³¹ Pak më herët, Komisioneri I UE për Marrëdhënie me Jashtë, Christopher Patten, tha se 'Ne jemi të përcaktuar që në Maqedoni të shohim përpjekje të prqëndruar në çrrënjosjen e korrupsionit. Korrupsioni hekmon jetën politike dhe ekonomike'.³²

Më shqetësuese është se trendi në Maqedoni- jo si në vendet tjera ballkanike-dukët që po keqësohet. Një sondazh I bërë nga USAID, thotë se pesë nga shtatë indekset që masin sensibilizimin mbi korrupsionin gjatë vitit të kaluar kanë pësuar rrënie. Ky sondazh shënon se në matjet kritike të 'Përfshirjes në Praktikën e Korrupsionit, vlerat e indeksit janë dyfishuar'.³³

Slagjana Taseva, Drejtor Ekzekutiv i Transparency International (TI) në Maqedoni, mendon se me senzibilizimin e qytetarëve për përmasat e korrupsionit, toleranca e tyre ka rënë dukshëm.³⁴ Averzioni ndaj korrupsionit është fundamental për mungesën e besimit në institucionet dhe politikanët dhe supozohet të jetë arsyeja kryesore pse aq shumë vetë thonë që nuk do të votojnë këtë vjeshtë.³⁵

³⁰ Dokumentacionin e Punës së Stafit të Komisionit Evropian, ish-Republika jugosllave e Maqedonisë, Raporti I Stabilizim-Asociimit, Bruksel, SEC (2002) 342, f.8.

³¹ Studimi I Bankës Botërore, citon raportin e Grupit Udhëzues të Iniciativës së Paktit të Stabilitetit për Anti-korrupsion, "Masat për Anti-korrupsion në Evropën Jug-lindore- Shqyrtimet dhe reformat e vendit për reforma", Shtypi I Këshillit të Evropës: Strasburg, shtator 2001, f. 22.

³² Fjalimi I Chris Patten, Komisioner I UE për Marrëdhënie me Jashtë, Forumin e Demokracisë në Ballkanin Perëndimor, në Selanik, 11 prill 2002. Megjithatë, në vizitën e tij në Maqedoni më 3 korrik, diplomatë të lartë thonë se Patten nuk përmendi korrupsionin.

³³ "Indekset e Korrupsionit, Monitorim mbi Korrupsionin Rajonal", prill 2002, USAID, Instituti I Zhvillimit Ligjor në Evropën Jug-lindore, në bashkëpunim me hulumtimin e Vitosha-s, f. 6.

³⁴ "Vendi gjendet ne krizë për shkak të korrupsionit në elitat qeveritare", *Capital*, 10 janar 2002.

³⁵ Një sondazh i zhvilluar nga Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI), në vjeshtë të 2001 and jo I afërt me mediat lokale thotë se gati gjysma e të anketuarve (47.1 për

Megjithatë, abstenimi nga procesi demokratik ka më shumë gjasa të inkurrajojë korrupsionin se sa të sfidojë atë.

Organizatat e shoqërisë civile janë shumë të dobëta për të zhvilluar një fushatë efektive kundër korrupsionit.. Kjo mund të bëhet vetëm me një koalicion të ri të grupeve politike ekzistuese ose komunitetit ndërkombëtar. Në praktikë, ky I fundit ka pozitë më të mirë që të inicojë një fushatë të tillë. Ky raport shqyrton pavullnetshmërinë e komunitetit ndërkombëtar për t'u angazhuar seriozisht me korrupsionin dhe të japë propozime se si mund t'ia dilet me të. Së pari, sidoqoftë, të ilustron shkallën e problemit dhe implikimet e tij në stabilitetin duke ofruar disa studime mbi çështjen.

qind) ose "nuk e dinin" se për kë do të votonin, ose nuk favorizonin asnjë parti të përmendur gjatë anketës. Pak nga ata zgjedhën kategorinë e veçantë 'parti tjetër'.

III. SPEKTRI I KORRUPSIONIT

A. NGERTHIMI I PLOTË I SHTETIT: SKANDALI NE TRANSPORTIN E MALLRAVE

Iniciativa Anti-Korrupsion e Paktit të Stabilitetit (SPA) e përshkruan korrupsionin si një simptom I qeverisjes së dobët dhe si një barrierë për sundimin e ligjit përmes institucioneve ekonomike, shoqërore dhe politike.³⁶ Banka Botërore bën dallime mes dy formave më të mëdha të korrupsionit.

- "ngërthimi I shtetit" – që do të thotë aftësia e individëve/kompanive të fuqishme për të ndikuar në formulimin e ligjeve ose strategjive të qeverisë në dobi të vetën
- "korrupsioni administrativ" – kur implementimi I ligjeve dhe rregullave ndikohet nga blerja e zyrtarëve publikë (sh. Për marrjen e lejeve, për heqjen e pengesave doganore, ose për të fituar tenderat publike kontraktuese).³⁷

Në Maqedoni tani po lulëzon edhe forma e tretë, hibride- ngërthimi I plotë I shtetit- bashkë me kërcënimin. Jo që bizneset janë vetëm viktimat e nevojës për mite; por ata u nënshtrohen edhe represalieve dhe presioneve të vazhdueshme nëse nuk veprojnë ashtu.

Shembull më I qartë, të themi I supozuar, është Shërbimi Doganor, ku, sipas disa burimeve të ndryshme, Drejtori I Doganave, Dragan Daravelski, flitet të detyrojë afaristët që të shfrytëzojnë kompaninë e preferuar për bartjen e mallrave, e cila është nën kontroll të tij. Sipas një zyrtari të doganave, I intervistuar nga ICG, shfrytëzimi I kompanive bartëse rivale mund të rezultojë me 'probleme'.³⁸ Ky

zyrtar,, dhe një tjetër individ mjaft I njohur në industrinë e transportimit të mallrave, I kanë konfirmuar raportet e mediave të vendit që deklarojnë se Daravelski ka eliminuar ose minimizuar bizneset transportuese që nuk I shkojnë atij për shtati. Është llogaritur se kjo firmë e favorizuar nga ai fiton 10,000 dollarë në ditë për atë se e ka këtë përkrahje. Supozimet që qarkullojnë në opinion (disa edhe në mediat lokale) përfshijnë:

- Cigaret për eksport në një firmë kroate vazhdimisht janë ndaluar në vend-kalimin kufitar Tabanovcë për arsye se nuk ka shfrytëzuar kompaninë e favorizuar. Dhe qeverisë kroate i është dashur të intervenojë në Shkup për të nxjerrë mallin.
- Një kompani transportuese në konkurrencë, Fershped, ka deklaruar me shkrim se në v. 2001 dhe 2002, 200,000 tonë të prodhimit të çimentos qenë bllokuar nga policia dhe zyrtarët e doganës, "por kur punën e kishte marë në dorë kompania [e favorizuar transportuese], po I njëjti mall qe bartur me lëhtësi, ndërsa ne humbëm punën për shkak të qëndrimeve qartësisht të një-anshme të autoriteteve të Doganës..."³⁹ Një importues I pajisjeve medicinale me kontratë për ri-eksport deklaroi se kamionat e tij qenë bllokuar nga doganierët derisa Fershpedi e humbi rastin në avantazh të kompanisë së favorizuar transportuese.⁴⁰

Ambasadori amerikan, Butler publikisht ka shprehur dëshpërim ndaj Shërbimit Doganor, dhe u bëri thirrje afaristëve që të flasin haptas për problemet e tyre: " Disa mallra janë ndaluar në vend-kalimet kufitare për gjatë kohë (më shumë se sa nevojitet). Disa nga mallrat tonë janë konfiskuar pa ndonjë arsye të veçantë".⁴¹

³⁶ Studimi I Bankës Botërore, citon raportin e Grupit Udhëzues të Inicativës së Paktit të Stabilitetit për Anti-korrupsion, "Masat për Anti-korrupsion në Evropën Jug-lindore- Shqyrtimet dhe reformat e vendit për reforma", Shtypi I Këshillit të Evropës: Strasburg, shtator 2001, f. 18. Në kontrast, krimi I organizuar është definuar si 'grupe që kryesisht fokusohen në përfitime ilegale, merren me krime që lënë pasojë të rënda për shoqërinë dhe që arrijnë të shfaqin këto krime në një mënyrë relativisht të suksesshme, në veçanti kur tregojnë se janë të gatshëm të përdorin dhunë psikologjike ose duke I ndaluar personat duke I korruptuar." Cituar në Rawlinson, "Kanosja nga krimi I organizuar", op. cit., f. 13.

³⁷ "Anti-korrupsioni në tranzicion – kontributi në debatin strategjik", Banka Botërore © 2000. Gjithashtu shih raportin e Grupit Udhëzues të SPAI op. cit., f.19.

³⁸ Intervistë e ICG zyrtarë të doganave.

³⁹ Teksti I dhënë ICG: "Informata mbi problemet që kemi pasur me zyrtarë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë", Fershped A.D., Shkup, 12 prill 2002. Fershped akuzon edhe se kontigjente për KFOR në Kosovë janë ndaluar në kufirin Greko-Maqedon për më shumë se 60 ditë, dhe se Shërbimi I Doganave nuk i pranon dokumentat e KFOR-it si çertifikata të faturave të mallit në Kosovë (kështu që, I largon ato nga tatimi doganor), dhe se praktikat e mëvonshme rezultojnë me pagesa të padrejta deri në 75,000 dollarë.

⁴⁰ Intervistë e ICG.

⁴¹ "Butler: Qeveria e SHBA është dëshpëruar me Doganën e Maqedonisë", *Dnevnik*, 20 qershor 2002. Ambasadori Butler nuk është I vetëm në këtë dëshpërim; disa dhjetra kopje të Raportit të ICG për Ballkanin108, *Pas Millosheviqit: Një Agjendë Praktike për Paqen e Qëndrueshme në Ballkan*, 26 prill 2001, u ndalua nga zyrtarët e doganës për gati një vit.

Drejtori I Doganave, Daravelski, ka instistuar duke I thënë ICG se aas ai dhe as Shërbimi I Doganave nuk janë të përfshirë në ndonjë nga aktivitetet e përmendura dhe se nuk ka lidhje me asnjë nga firmat transportuese.⁴² Sigurisht që është e drejtë që mohimet e tij të merren parasysh gjatë ndonji hetimi. Do të vëhet në shërbim edhe interesi I fortë publik, sidoqoftë përmes një hulumtimi të hollësishëm nga ana e autoriteteve përkatëse maqedonase, së paku për të rikthyer besimin publik dh afarist.

1. Evolucion i problemit

Lidhjet korruptive mes sipërmartjeve të mëdha, organeve shtetërore dhe partive politike ishin karakteristikë e peisazhit në Maqedoni shumë më përpara se qeveria aktuale të vijë në pushtet. Siç duket, korrupsioni del të ketë qenë I shpërndarë kudo gjatë dhe në qeverinë e mëhershme, të udhëhequr nga koalicioni LSDM-PPD.⁴³ Po Fershped supozohet të ketë lidhje me partitë opozitare dhe që ka pasur avantazhe gjatë qeverisë së kaluar. Ish-krye Ministri Branko Cërvenkovski, lider i the LSDM, njëherë mbajti një flajim që mbahet mend ku paralajmëronte mbi 'oktopodin' e korrupsionit, por ai krejtësisht dështoi në luftën kundër këtij problemi.

Megjithatë, kontrolli mbi transportimin e mallrave për të cilin flitet dhe supozohet do të demonstronte një evolucion të rëndësishëm:

- Në vend të një favorizimi eventual ndaj firmave transportuese përmes 'lidhjeve' me qeverinë (d.m.th. ngerthimi I plotë I shtetit), Kaosi I ri në Dogana tregon që demonsttron ngërthimin e plotë I shtetit: bashkimi I firmave private, firmave me lidhje partiake apo të ngjashme me to me elemente të strukturës shtetërore. Siç tregohet në vazhdim, eksploatimi I kontrolleve të përkrahur nga shteti nuk ka restriksione për transport të mallrave.
- Në vend të miteve të thjeshta për shërbime ('korruocion administrativ'), akuzat aktuale tregojnë keqpërdorim sistematik të

Gjithashtu, për një publikim që ICG deshi ta shpërndante pa pagesë, kërkohej të pagohet një "taksë importi" e trilluar e cila nuk parashihet në legjislacionin e Maqedonisë. ICG refuzoi të paguajë dhe raportet nuk u dërguan asnjëherë.

⁴² Intervista e ICG me Dragan Daravelski, 22 korrik 2002.

⁴³ Shembuj të njohur dhënë mbi korrupsionin është banka e dështuar 'piramidale', TAT, korrupsioni administrativ në Doganat, maashtrimi në blerje, manipulimet në eksport, akuzat mbi keqpërdorimin e importit të makinave nga ASIBA, dhe privatizimi jo-transparent.

procedurave regulative për të imponuar shfrytëzimin e një kompanie të favorizuar (presion administrative)

Me fjalë tjera, elemente të rëndësishme të një agjencie shtetërore besohet të kenë evoluar nga oportunistë pasive në reketarë aktivë. Siç flitet më poshtë, ka një prospekt të një bashkëpunimi aktiv në kontrabandë mes elementeve kriminale dhe strukturave shtetërore. Një ministër I dalluar qeveritar ia pranoi këtë evolucion ICG-së.

Birraria e Shkupit, furnizuesja me e madhe në Maqedoni, është një firmë tepër e suksesshme me një GDP prej 1.6 për qind. Kjo I ka dorrëzuar ICG me shkrim akuza të detajuara mbi keqpërdorim selektiv dhe arbitrar të procedurës nga ana zyrtarë të lartë dhe ish-zyrtarëve të Doganave dhe Zyrës për Të Ardhurat Publike.⁴⁴ Burrimet thonë se Birraria është e rrezikuar sepse refuzon të paguajë mite. Burrime të tjera raportojnë modele të ngjashme të korrupsionit në fusha të tjera. Një pronar toke I mëkëmbur thotë se të dy shtëpitë e tij janë shkatërruar me bulldozer pasi ai ka rrefuzuar të paguajë 1 milion dollarë, që ia ka kërkuar nga një zyrtar qeveritar.⁴⁵

Borce Davitovski, profesor universitar në lëmin drejtësisë, përshkruan ndikimin e presionit administrativ ndaj një firme të madhe farmaceutike: 'Zyra e të Ardhurave Publike...ka inspektuar punën financiare dhe atë të privatizimit dhe që të gjithë komisionet nuk gjetën ndonjë parregullsi. Është e qartë se qëllimi është të bëhet presion. Këto aktivitete nuk janë në dobi të ekonomisë...dhe as të investitorëve të huaj. Kush do që të investojë në një firmë që çdo ditë kontrollohet?'"⁴⁶

⁴⁴ Dokumenti që Birraria e Shkupit ia ka dhënë ICG, AD, me datë 10 prill 2002. Akuzat mbi Doganën kanë të bëjnë edhe memoslejimin e një përfaqësuesi të birrarisë që të jetë I pranishëm në pranimin e sheqerit të importuar, dhe kjo nxiti tarifa të mëdha, vonesë të qëllimshme dhe refuzim që t'u kthehen paratë e ndalura në doganë.

Akuzat ndaj Zyrës për Përfitimet Publike kanë të bëjnë me inspeksione arbitrarë dhe të prolonguara të përfitimeve si dhe konfiskime të pa-autorizuara të materialeve.

⁴⁵ Intervistë me ICG. Pronari ia ka dhënë dokumentet ICG.

⁴⁶ "Intervistë me Borce Davitovski, profesor në fakultetin e drejtësisë", revista *Aktuel*, 5 prill 2002. Profesori Davitovski nuk ka pozitë zyrtare me LSDM por besohet të jetë I afërt me këtë parti opozitare. Kompania në fjalë është shtëpia farmaceutike, Alkaloid. Drejtori I Alkaloid thotë se firma veç më shtetit I pagon mesatarisht më shumë se € 10 milionë në vit përin çështje ligjore. "Investimet në kushte

B. KORRUPSIONI DHE MARRËVESHJA E OHRIT: VJELJA E FONDIN SHËNDETËSOR RAPORTIN E GRUPIT UDHËZUES

Me harxhime prej gati 160 milionë dollarë,⁴⁷ Fondi I Sigurimit Shëndetësor në thelb ka kontroll mbi tregun medikal vednor. Ai funksionon si mekanizëm pagesash për sistemin shëndetësor shtetëror, duke siguruar medikamentet dhe pajisjet. Drejtori I Fondit Shëndetësor, Vojo Mihajlovski, gjithashtu është edhe Sekretar I Përgjithshëm I partisë në pushtet, VMRO-DPMNE.

Fondi me vite ka operuar në humbje, që në vitin 1998 arrin në 37 milionë dollarë. Për t'u marrë me këtë, firmave që kanë nënshkruar kontrata për furnizim me barrëra u është kërkuar që ta zbrasin çmimin e ofertës (të zvogëlohet ajo që I fitohet nga Fondi) me deri në 25 për qind për t'i paguar llogaritë e tyre.

Sipas burimeve që pretendojnë të kenë njohuri të dorës parë, procedura pat ndryshuar nga mesi I vitit 2000. Dhe në vend që t'u kërkohej ulje e çmimit, furnizuesit qenë të detyruar të paguajnë 5 për qind të balancit pagesor, I pranueshëm në kesh (para të gatshme-në dorë) Kjo shumë qe destinuar-me shkrim, sipas burimit- si kontribut për partinë VMRO-DPMNE. Me fjalë tjera, furnizuesve u qe kërkuar të shpagojnë 5 për qind në kesh direkt për partinë, në vend që të marrin 25 për qind zbritje në vlerë të tenderit të tyre. Shumë kompani janë dakorduar me këtë. Atëherë, thuhet, që ky kontribut të jetë rritur në 10, e pastaj në 15 për qind. Një nga furnizuesit thotë se pagesa jo shpesh ndodh të jetë edhe 30 për qind. Një vëzhgues I atribuon këto ndritje përqindjesh faktit se ' ky është vit zgjedhesh'. Burrimet thonë se nëse rrefuzohet atëherë pason vizita nga inspektorët, disa herë nga Zyra për të Ardhura Publike, në kërkim të parregullive.⁴⁸

Burrimet gjithashtu flasin për abuzime të mëdha në furnizimin/blerjen e pajisjeve për kujdes shëndetësor, përfshirë këtu edhe një mite të realizuar deri në shumën prej 425,000 dollarë amerikanë për blerjen e aparatit për trajtim të kancerit, dhe blerjeve të

vazhdueshme pa tenderë. 'Kontributi' zakonisht paguhet në kesh ndërsa 'kontribuuesi' ofron faturë.

Zyrtarët në Zyrën e Revizorit Shtetëror I kanë konfirmuar ICG se gjatë shqyrtimit të Fondit për Sigurim Shëndetësor, në gusht të 2002, ka hasur në shkelje, *inter alia*, në lidhje furnizimin, përdorimin e resurseve dhe tenderëve.⁴⁹ ICG posedon kopje të Revizionit (e cila nuk është publikuar). Përveç mosrespektimit të metodave kontabiliste në përgjithësi- 'Raportet e Fondit Shëndetësor nuk janë përgatitur sipas parimeve bazë the kontabilitetit'—revizorët në veçanti kanë hasur në, se:

- të ardhurat për fondinin kanë qenë minimale si pasojë e shqlyerjes së obligimeve pa marrëveshje nga ana e kreditorëve dhe pa vendim të Bordit Administrativ.⁵⁰
- Nuk ka evidencë për pagesat nga kontributet nga ta që janë siguruar; dhe
- Një kontakt për blerje është bërë nga ' një marrëveshje direkte' me firmën e cila as edhe ka konkurruar në tenderin e publikuar.⁵¹

Llogaritë mujore për të ardhurat nga skema e miteve rangojnë prej 200,000-250,000 dollarë amerikanë. Llogaritë nga të ardhurat e përgjithshme nga korrupsioni brenda Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (përshirë edhe manipulimet në blerje) arrin derin 20 milionë dollarë në vit.

Financierët theksojnë se në çdonjërin sistem ku mitet janë aq të zakomshme sa duket të jenë në Fondin Shëndetësor, mungon lidhja sfiduese e natyrshme mes blerësit dhe shitësit (e cila normalisht prodhon çmimin më ekonomik). Në vend të kësaj, Fondi ndan kamatën e shitësit në rritjen e çmimit të barrërave, pasi që edhe kjo do ta nxisë dhënien e miteve.

Drejtori i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Mihajlovski nuk iu përgjigj kërkesës me shkrim të ICG për të diskutuar rreth akuzave në fjalë.⁵² Megjithatë, pasi që veprimtaria e sistemit për kujdes shëndetësor është një shqetësim I madh për të gjithë qytetarët, do të ishte në interes të gjerë publik për

lufte dhe tranzicioni", Trajçe Mukaetov, Buletini I Ministrisë së Financave 12/2001, f. 97.

⁴⁷ Të dhënat e Ministrisë së Financave, f.22.

⁴⁸ ICG ka intervistuar individë të cilët pohojnë se kanë përjetuar këtë.

⁴⁹ Intervista e ICG me Zyrën e Revizionit Shtetëror, 11 prill 2002.

⁵⁰ Ekspertë financiarë thonë se kjo është një referencë për provisionet e përshkruara më sipër.

⁵¹ "Raporti Final për Revizionin e Kontabilitetit Vjetor për Fondin Shëndetësor, viti 2000", Zyra e Revizionit Shtetëror, Republika e Maqedonisë.

⁵² ICG ka kërkuar takime me z. Mihajlovski, me letër dhe përmes telefonit, më 15 korrik 2002 and 29 korrik 2002 prej të cilëve nuk morëm përgjigje.

qeverinë maqedonase që me kujdes t'I shikojë dhe raportojë mbi të gjitha këto çështje. Si hap të parë, qeveria duhet të publikojë raportin e përgatitur nga Zyra e Revizorit Shtetëror.

1. Pasojat

Shtrydhja e supozuar e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore do të del që sjell për pasoja të mëdha për liberalizimin e kujdesit shëndetësor dhe zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit. Nga sensi ekonomik, pagesat e vjelura nga furnizuesit janë një 'kursim' që I përket qytetarëve të cilët kontribuojnë në vet Fondin. Në përgjithësi, çdo kursim I dalur nga furnizuesit duhet t'I kthehet sistemit të kujdesit shëndetësor gjë që do të sjell në ngritjen e pagave të të punësuarve në shërbimet shëndetësore, të zvogëlojnë pagesat, përmirësojnë kushtet ose të risin mundësitë e kujdesit dhe medikamenteve. Në vend që kjo të ndodhë, mbushen arkat e partive politike, ndërsa nga ana tjetër kemi shkatërrim të sistemit për kujdes shëndetësor. Pagat e ulëta I nxisin mjekët dhe personelin ndihmës që të pranojnë mite për shërbimet që kryejnë.⁵³ Më 11 prill 2002 punonjësit në kujdesin shëndetësor u kanosën me grevë, duke kërkuar kompenzim..⁵⁴

Në tërësi, siç thotë një ekspert, për shkak se të ardhurat dhe shpenzimet e vërteta asnjëherë nuk raportohen si duhet, varrferia elementare në sistemin shëndetësor asnjëherë nuk shqyrtohet si problem sepse' paratë e reja' gjithmonë janë tërhequr.⁵⁵

Më 21 qershor 2002, në konferencën mbi korrupsionin, organizuar nga Instituti I Shoqërisë së Hapur, ICG e ka pyetur krye-Ministrin Georgievski rreth akuzave për korrupsion në Fondin e Shëndetësisë. Pa cekur në veçanti nëse paratë kanë shkur në arkën e partisë, ai tha se defiqiti I Fondit është eliminuar dhe se investimet në kujdesin shëndetësor kanë pësuar rritje.⁵⁶

Para pak kohe, autoritetet kanë vepruar kundër disa rasteve relativisht të vogla. Policia ka arrestuar një

mjek (the Shef I Sektorit të Psikiatrisë në Spitalin Ushtarak), accusing duke akuzuar atë për praninë të miteve me deklaratat që ka dhënë për ushtarët duke I nxjerrë' si mentalisht të paaftë për shërbim ushtarak'.⁵⁷ Mjeku, siç duket njëri nga disa të tjerë të arrestur për praninë parashë, mohon këto akuzat dhe pretendon se I është montuar për arsye se vllau I tij është I afërt me kryetarin Trajkovski, I cili nuk qëndron në marrëdhënie të mira me krye-Ministrin.⁵⁸ Mediat e kontrolluara nga qeveria raportojnë për spastrime në farmacitë shtetërore në Shkup dhe Manastir, nisur me përjashtimin e Drejtorit të Qendrës Mjeksore në Manastir, për 'punët ilegale të farmacisë'.⁵⁹ Sidoqoftë, masat e tilla duken më tepër si qengj kurban, për të rritur besimin publik ndaj sistemit.⁶⁰

Koncepti qendror I Ma. Së Ohrit ishte që të parandalohet dezintegrimi I Maqedonisë duke u dhënë më shumë të drejta shqiptarëve dhe mundësia për t'u përfaqësuar dhe decentralizimi I pushtetit qeveritar. Ligji për Vetë-qeverisje Lokale konsiderohej si shumë I rëndësishëm, dhe për këtë deklarata si e vetme u specifikua formalisht si parakusht për konferencën e donatorëve që do të mbahej atëherë. Negociatat rreth sektorit të shëndetësisë ishin elementi më kontravers I ligjit.⁶¹ Partitë politike shqiptare vazhdimisht kërkonin një të tretën e shfrytëzimit përfitues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Duke punuar me vite të tëra në përmirësimin dhe privatizimin e sektorit të shëndetësisë, donatorët I bindën shqiptarët që në vend të kësaj të pranojnë përshejtimin e privatizimit të klinikave private; decentra e aspekteve të kufizuara të sistemit të kujdesit shëndetësor, jashtë Fondit; dhe në supervizion më të plotë ndaj sistemit, përfshirë edhe Fondin.⁶² Në konsideratë u morrën dy

⁵³ Një Burrin I tregon ICG se si një mjek që punon në sistemin shtetëror ka insistuar që t'I paguhet tretmani nga ana e tij (duke kërkuar më shumë se sa i është ofruar); kur mjeku kaloi në një spital privat ku paguhej më shumë, ai nuk kërkonte më.

⁵⁴ "Sektori për Kujdes Shëndetësor, në Shtrajk", *Utrinski Vesnik*, 11 prill 2002.

⁵⁵ Komunikimi me ekspertë mjeksor, 9 korrik 2002.

⁵⁶ Përgjigjja e Georgievskit injoron qëllimin kryesor, përkundër përmirësimit në fushën e bilancit, kickbacks vazhdojnë ta vjelin fondin nga sistemi shëndetësor.

⁵⁷ "U arrestua një mjek I korruptuar që jep raporte mjeksore false për të liruar nga detyrimi ushtarak.", *Dnevnik*, 9 prill 2002. Mjeku, Gjorgji Mitrovski, akuzohet të ketë pranuar shtatëmbëdhjetë herë mite, secila me vlerë prej € 1,500.

⁵⁸ "Mjeku në spitalin Ushtarak është një nga atë që do të arrestohen", *Utrinski Vesnik*, 10 prill 2002.

⁵⁹ *Vecer*, 11 prill 2002.

⁶⁰ "Korrupsioni nuk mund të luftohet me eliminimin e gjahtarëve të vegjël", *Dnevnik*, 5 prill 2002.

⁶¹ Dy probleme tjera u paraqitën gjatë negociatave – mbi arsimin dhe të drejtën ekomunave për administrim të përbashkët. Asnjëra nuk doli as përafërsisht kontraverze sa mospajtimet rreth sektorit shëndetësor.

⁶² Nën-paragrafin (1)-9 i Nenit 22 I Ligjit për vetë-qeverisje Lokale cakton kompetencat specifike të komunave mbi kujdesin shëndetësor: "qeverisja e rrjetit e organizatave të shëndetit publik dhe ndërtesave për kujdes primar të përfshijnë përfaqësimin e qeverisë lokale në të gjitha bordet

inovacione: rritja e numrit të numrit të Ministrave në 'këshillin shëndetësor' aktual duke përfshirë më shumë shqiptarë dhe angazhimi I një 'mbikqyrësi shëndetësor' I pavarur ndër kombëtar.⁶³

Megjithatë, shumë pak është punuar rreth kësaj në marrjen e masave të nevojshme. Privatizimi po vonohet; këshilli shëndetësor nuk është zgjeruar; dhe 'mbikqyrësi' ndër kombëtar siç u premtua nuk është angazhuar. Zyrtarë të Bankës Botërore pranojnë nevojën për reforma por që nuk zotohen të financojnë mbikqyrësin ndër kombëtar, duke thënë se ai do të ngelet në hije të zyrtarëve për ta përdorë atë pastaj si alibi kundër akuzave për korrupsion. Ata këtu thonë se vetë maqedonasit duhet 'ta marrin në dorë' situatën përmes Ombudsman-it dhe iniciativave të shoqërisë civile, dhe për të dyja këto Banka Botërore mund të jep përkrahje.⁶⁴

Partia politike shqiptare-PDSH- disa nga liderët e së cilës thuhet të kenë luftuar mjaft për 'një të tretën' e aksioneve- nuk është ajo që me këmbëngulje kërkon implementimin e marrëveshjes për mbikqyrje të Fondit të Shëndetësisë. Më 28 shkurt 2002, anëtarët e PDSH në Parlament bashkë me partnerët e tyre maqedonas të koalicionit VMRO-DPMNE, votuan që të bllokujnë një evaluim nga ana e revizorit shtetëror të lartpërmendur mbi Fondin Shëndetësor.⁶⁵ Me fjalë të tjera,, në vend që të sillen faktet për keqpërdorim të Fondit, PDSH siç po shihet ndihmoi të mbulohej kjo në favor të partnerit në koalicion.⁶⁶ Me humbjen e tenderit të supozuar

e organizatave shoqërore për kujdes shëndetësor; përmirësimi I shëndetësisë; aktivitetet preventive; mbrojtja e punonjësve të shëndetësisë dhe mbrojtja e tyre në vendin e punë; mbikqyrja shëndetësore ndaj ambientit jetësor; mbikqyrje ndaj sëmundjeve infektive; asistencë për pacientët me nevoja të posaçme; dhe fushat që do të caktohen sipas ligjit".

⁶³ Sipas burimeve të UE , këto janë pranuar në të ashtuquajturat ' ujdite anësore' jashtë termave formale të ligjit.

⁶⁴ Intervista e ICG me një zyrtar të lartë të Bankës Botërore në Shkup, 19 prill 2002. Ekspertë maqedonas, si profesori Marjanoviç dhe ish-ministri I Drejtësisë, Vlado Kambovski mendojnë se institucionet vendore dhe shoqëria civile janë shumë të dobta që ta luftojnë korrupsionin, nëse ata nuk marrin ndihmë direkte ndër kombëtare. Intervistë me Kambovskin më 9 korrik 2002.

⁶⁵ Sipas Petar Gosev, lider I partisë opozitare LDP, Nikolla Popovski I ka propozuar parlamentit që të diskutohet raporti I Revizionit Shtetëror mbi veprimtaritë e Fondit Shëndetësor. Kërkesa u refuzua nga shumica në parlament më 28 shkurt 2002. Propozimin e votuan vetëm 23 deputetë.

⁶⁶ Një zyrtar I partisë, I pyetur pse PDSH mënyrë efektive mer pozicionet e VMRO-DPMNE dhe stopoi debatin mbi revizionin ndaj Fondit Shëndetësor, ai vetëm tha se

për një-të- tretën e aksioneve të veprimeve të Fondit gjatë negociatave mbi Ligjin për vetë-Qeverisje Lokale, interesi I PDSH duket se kaluar në menaxhimin e ' një aranzhmani tjetër afarist' me VMRO-DPMNE.

Ashtu si homologët e tyre të VMRO-DPMNE, liderët e PDSH irritohen nga akuzat që u bëhen për korrupsion, por duke mohuar ato, njëri nga këta ICG I ka thënë se ' ne nuk përfitojmë nga korrupsioni aq shumë sa mendoni ju".⁶⁷ Lideri parlamentar I PDSH nuk shpjegoi pse partia e tij nuk ka sfiduar akuzat e publikuara në të përjavshmen LOBI, të redaktorit Iso Rusi, se ' e arritura' më e madhe kishte qenë të fitojë në marrëveshjen me VMRO-DPMNE kështu që PDSH të merrte një-të-tretën e përfitimeve të qeverisë.⁶⁸

Megjithatë, një zyrtar I PDSH, akuzoi një anëtar të LSDM në parlament se është I involvuar në aferën e kompanisë farmaceutike që vazhdimisht I pagon FSH. Një importues I paanshëm farmaceutik thotë se firma kërkon ta vejë deputetin në fjalë në bordin e vet të drejtorëve, kështu që 'nëse opozita fiton zgjedhjet, ata veç më do të kenë ' lidhje' për këdo që do të emërohet si drejtor I ri I FSH.⁶⁹

Tendenca për ndarje të pushtetit sipas M. së Ohrit, si një mënyrë për ndarje të përfitimeve pushtetare me shqiptarët është një pengesë e madhe për realizimin e premtimit për Ligjin e Vetë-qeverisjes Lokale.

C. KORRUPSIONI MULTIETNIK: TRANSANKCIONET 'E KUSHTËZUARA' NË NJË MINISTRI

Një ish-zëvendës-Ministër I Ekonomisë në 'qeverinë e unitetit' të vitit të kaluar "⁷⁰ I ka dhënë ICG një, siç

'debatet parlamentare nuk shërbejnë për asgjë'. Megjithatë, shtoi ai, "çdokush e din se çfarë po ndodh me Fondin Shëndetësor' dhe insistonte se PDSH ende dëshiron emërimin "mbikqyrësit". Intervistë e ICG me koordinatoren e grupit parlamentar të PDSH, Zamir Dika, 25 qershor 2002.

⁶⁷ Ibid. Gjatë takimit, kur ai e dha komentin e cituar, Dika gjithashtu dorëzoi një letër, që në fakt mohonte akuzat ndaj partisë.

⁶⁸ "Maqedonia, një vit më pas: Ku po shkojmë?", *Lobi*, 25 shkurt 2002. Takimi me koordinatoren e grupit parlamentar të PDSH, Zamir Dika, 25 qershor 2002.

⁶⁹ Intervista e ICG me afaristin farmaceutik, 12 korrik 2002.

⁷⁰ Ishzëvendës ministër është Zoran Vitanov I partisë Socialiste. Kërkesa për një tej-shtrirje të marrëveshjes politike drejt konfliktit e bëri në nevojshme zgjerimin e

thotë ai, shembull të jashtëzakonshëm të bashkëpunimit mes shqiptarëve dhe maqedonasve në korrupsion. Supozohet, se në takimin e parë të tij me Shefin (shqiptar) të Ministrisë, Besnik Fetai:

[Pa pyetur unë,] Fetai ... sinqerisht më tha të flas me Inspektorin X⁷¹ dhe t'i kërkoj atij listën e 50 tregtarëve më të mëdhej. (Ai) më tha të zgjedh një nga këta tregtarë dhe të dërgoj Inspektorin X që të shkojë të 'gjejë parregullsitë'. Këto parregullsi do të bartnin dënimin prej 150.000 dollarë amerikanë. Ai tha se tregtari atëherë do të 'inkurajohej' të ofrojë 12-15,000 dollarë mite për t'iu shmangur dënimin. (Ai) më tha që paratë janë për mua, ndërsa rreth 20 për qind të tyre do t'i jepen Inspektorit X.⁷²

Kjo të jep të kuptosh se i deleguari do të kishte qasje më të lehtë në ekstraktin, duke e lënë rehat 'pjesën' e ministrit. Një ndarje e tillë e përfitimeve, sipas territoreve apo sektoreve, besohet të jetë një karakteristikë e zakonshme e koalicionit aktual. Në të vërtetë, ish-zëvendës Ministri përshkruan tronditjen reciproke të tijën dhe të Ministrit- të vetën me pranimin e ofertës, dhe të ministrit që I është rrefuzuar.

Interesi real I ministrit Fetai, sipas ish-zëvendës Ministrit dhe të tjerëve, nënkuptonte praktikën e 'kushtëzimeve' për çmime-fikse dhe shitje 'kontigjentesh'(të drejtën për importim të sheqerit, mishit dhe djathit). Ky manipulim I supozuar qëndron në të drejtën ligjore që të kufizohen importe të tilla, për të mbrojtur prodhuesit vendorë nga konkurrenca nga jashtë. Sipas ish zëvendës-ministrit, ministria në mënyrë artificiale rrit çmimet duke penguar importin për një periudhë të prolonguar. Atëherë 'kontigjenti' I një njësie blerëse i aprovohet importuesit, ndarsa paratë hyjnë në xhep.⁷³ Ish-zëvendës ministri në fjalë, gjatë kohës së shkurtër të

qeverisë PDSH-VMRO-DPMNE. Partitë opozitare (9PDP dhe LSDM) hynë në parlament më 8 maj 2001. Qeveria e tyre e unitetit zgjati deri në fund të vjeshtës. Prolongimi I ndryshimeve kushtetuese të Marrëveshjes së Ohrit u miratuan më 16 nëntor, dhe LSDM e lëshoi koalicionin më 21 nëntor.

⁷¹ Ish-zëvendës ministri I tregoi ICG emrin e inspektorit.

⁷² Intervistë e, 11 prill 2002. Ish-zëvendës ministri I ka thënë publikisht disa nga gjërat e njejta më shumë se gjys viti më parë. Ai tani është anëtar I një partie opozitare. ICG ka intervistuar një burim tjetër I cili raportonte shitjen e kontigjenteve, për ç'gjë diskutohet në vazhdim.

⁷³ Kontigjentet aprovohen nga një bord, në të cilin përfaqësohen disa ministri.

tij në këtë post, llogarit që përfitimi që kanë zyrtarët arrin deri në 2.5 milionë dollarë, dhe se shumica e përgjithshme për të njëjtën periudhë ishte të paktën pesë herë më e madhe.

Në një intervistë që ministri Fetai dha gjatë këtij viti, e minimizoi rolin e vet në procesin e selektimit të përfitimeve nga kontigjentet:

Në Ministrinë e Ekonomisë është komisioni që ka selektuar kompanitë që kanë aplikuar për kontigjente të sheqerit, dhe jo unë. Në tender kanë aplikuar rreth 50 kompani, prej të cilave 30 vijnë nga industria e konfeksionit. Kryetari I komisionit, Imer Shabani, ka bërë vlerësimin dhe ka vendosur që importin t'ua ndajë dymbëdhjetë kompanive. Vendimi ishte I tyre dhe unë vetëm kam nënshkruar. Unë nuk di prej nga importohet sheqeri dhe as që e njoh afaristin që importon sheqer.⁷⁴

Kjo intervistë ishte jehonë e pohimit të ministrit një vit më parë se:

Vendimi I qeverisë ishte që sheqeri të importohet për shitje dhe jo për prodhim. 50 kompani konkurruan pranë Ministrisë së Ekonomisë, 12 prej të cilave janë firma tregtare, dhe 38 të tjerat merren prodhime ushqimore. Sipas vendimit të qeverisë dhe Nenit 24 (a) të Ligjit të Doganave, që thotë se nëse në treg ka mungesë të ndonjë produkti që është I rëndësishëm për standardin e jetesës së qytetarëve, Ministria e Ekonomisë ka të drejtën që të intervenojë në treg. Vendimi u mor në një nga seancat e qeverisë, pas së cilës kontigjenti qe ndarë. Kontigjentet ndahen me vendimin e Komisionit pranë Ministrisë së Ekonomisë, dhe unë vetëm firmos këto vendime.⁷⁵

Revista *Zum* magazine ka llogaritur 'çmimin' për të drejtën e shitjes së 15,000 tonë të mishit të dërrit në shumë prej 12.5 milionë. Supozohet se shitja e vetëm një kontigjenti për një zyrtar të afërt me ministrin kushton 200,000 dollarë. Revista gjithashtu shkruan se kompanitë të afërta me partitë në pushtet kanë pasur trajtim me preferenca sa I përket marrjes së kontigjenteve, dhe se eksportues të caktuar të mishit njoftohen paraprakisht për shitjen e

⁷⁴ "Ekonomia e Maqedonisë si pasojë e krizës ka pësuar humbje deri në 700 milionë DM", *Vecer*, 10 prill 2002.

⁷⁵ "Mega intervistë më Besnik Fetain", *Kapital*, 19 prill 2001.

kontigjentit dhe me këtë ata të ngisin çmimin e tyre.⁷⁶

Kontigjentet u ndahen sipas meritave të dëshmuara (shërbimeve, besueshmërisë, standardeve sanitare), ose në bazë të praktikës shërbimin e merr ai që vjen I pari (më ishpejti-më I zoti). The kështu ata detyrohen të shkojnë tek ata që paguajnë pavarësisht nga madhësia apo nevojat. Për shembull, një kontigjent për 1,000 tonë sheqer vazhdimisht I ndahej një kompanie me vetëm tre punonjës, përdërisa një kompanisë tjetër me më shumë se 20 supermarkete I janë ndarë vetëm 10 tonë.⁷⁷ Afaristë të tjerë raportojnë në ndarje të tilla bazuar në atë se kush do 'ta paguajë çmimin'.⁷⁸ Zum llogarit se praktika e shitjes së kontigjenteve buxhetit I kushton 20 milionë dollarë. Dhe lëre këtë anash, premtimi I paradokohshëm I SHBA ve për ta ndihmuar Maqedoninë në balancimin e pagesave arrin shumën 16,5 milionë dollarë.⁷⁹

Dhe një korrupsion tillë supozohet të ketë një ndikim të dyfishtë në ekonominë. Mashtron bankën kombëtare të të ardhurave, duke detyruar rritjen e tatimeve, dhe për më tej pengon rritjen, dhe bën që konsumatorët të paguajnë çmime më të larta.

ICG ka kërkuar nga Ministri Fetai që të diskutojë rreth akuzave që vijnë në adresë të tij. Ministri nuk I është përgjigjur ftesës së ICG për takim.⁸⁰

⁷⁶ "Firmat shqiptare fituan importin e mishit", *Zum*, 20 prill 2001.

⁷⁷ Ministri I Financave thotë se ministria e tij, e cila përfaqësohet në bordin përgjegjës, nuk I ka aprovuar këto shitje. Intervistë e ICG me Ministrin Gruevski, 16 prill 2002. ICG raportoi akuzat se profiti nga marrëveshja e ngjashme për sheqer, ku përfshihen 15,000 kg të sheqerit të rafinuar, llogaritet që në vitet 2000/2001 të ketë vlerën e 2.5 milionë dollarësh. Shih Raportin N°109 të ICG për Ballkan, *Cështja e Maqedonisë: Reforma apo Kryengritje*, 5 prill 2001, f.13. Raporti citonte artikullin në faqen e parë të *Dnevnik* 30 mars 2001.

⁷⁸ *Birraria Shkup*, p.shka bërë akuzë publike.

⁷⁹ Të dhëna nga Komunikata e Ambasadës amerikane, 12 mars 2002.

⁸⁰ ICG ka parashtuar kërkesë që të takohet me ministrin Fetai në fillim të prillit 2002, dhe ende nuk ka përgjigje. ICG, pastaj foli me Zamir Dika, zyrtar I lartë në partinë (PDSH) e ministrit, rreth veprimtarive të supozuara qoftë të Fetait apo të partisë në përgjithësi. Gjatë të njejtës intervistë, Dika I dha ICG një letër që konteston akuzat, dhe verbalisht duke komentuar se 'ne nuk përfitojmë nga korrupsioni aq shumë sa mendoni ju'.

Intervista e ICG me kordinatorin e grupit parlamentar të PDSH, Zamir Dika, 25 qershor 2002.

Ministri Fetai para do kohe I ka sugjeruar Dhomës Amerikane Tregtare në Maqedoni se anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë me një kërkesë paralele për të harmonizuar ligjin vendor me standardet ndërkombëtare do të ndihmonte në zgjidhjen e problemeve të tilla, sepse kjo do 'të rriste transparencën dhe zvogëlojë mundësinë për subjektivitet në trajtimin e bizneseve'.⁸¹ Shembujt e lartëpërmendur në fakt shihet që ilustrojnë se shpesh nuk është mungesa e ligjit ajo që nxit korrupsionin më shumë se rrjeti I vet rregullave dhe rregullativave. Sipas prfesorit Davitovski, Maqedonia 'realisht ka nxitur korrupsionin me adoptimin e rregulloreve që mistrave u jep të drejta të pakufizuara... Nëse ne parandalojmë mundësitë për të drejta opcionale, atëherë ne do 't'I shmangeshim korrupsionit në nivel të lartë'.⁸²

Elementi që me të vërtetë të habit rreth akuzave mbi manipulimin në shitjen e kontigjenteve është se ka një kohë të gjatë që është bërë publike, ndërsa I është dhënë pak rëndësi. Hulumtimet nga mediat janë publikuar para më shumë se një vit, dhe dhe akuzat nga ish-zëvendës ministri po për aq gjatë I janë paraqitur opinionit. Mirëpo, si zakonisht, qeveria ende nuk ka marë ndonjë aksion për të dënuar publikisht. Të paktën qeveria duhet të komunikojë të gjitha informatat që ka në dispozicion, kështu që opinionin publik të jetë I informuar dhe të mund të gjykojë mbi këto supozime.

Cinizmi masiv, evidencuar nga qytetarët e të gjitha komuniteteve rezulton nga kombinimi

I sensibilizimit të lartë të korrupsionin të supozuar me po aq sensibilizim të lartë se institucionet shtetërore nuk u kushtojnë vëmendje këtyre akuzave. Kjo shpjegon besimin të pakët publikqë ka Maqedonia në institucionet e veta, dhe vështirësinë me të cilën ballafaqohen liderët e shoqërisë civile, të cilët duan ta mobilizojnë opinionin kundër korrupsionit.⁸³ Profesori Marjanoviç nuk dakordohet me atë se pushteti dhe imuniteti janë partnerë të natyrshëm në Maqedoni: 'Ata në pushtet janë të pakapshëm; dhe kjo definohet me atë se nëse je I

⁸¹ Revista e Dhomës Ekenomike të SHBA, 'Rregullat e Tregtisë të Lirë' (Free Market Rules), shkurt/mars 2002, f. 8.

⁸² "Intervisrë me Borçe Davitovski, Profesor në Fakultetin e Drejtësisë", revista *Aktuel*, 5 prill 2002.

⁸³ Ashtu si edhe drejtori ekzekutiv i Transparency Macedonia, Taseva, dhe kryetari, Zoran Jacev, dhe drejtori I Institutit për Shoqëri të Hapur (IOS) në Maqedoni, Vladimir Milçin.

arritshëm atëherë t'i nuk je një pushtet kredibil'.⁸⁴ Tasheva nga shton se korrupsioni në Maqedoni mbetet një 'aktivitet me pak rrezik dhe mjaft i shpërblyeshëm'.⁸⁵

Parëndësia për të zbuluar ende është prezente tek politikanët e Maqedonisë. Ish-zëvendës Ministri Vitanov thotë se ai dy herë ka diskutuar me Kryeministrin për manipulimet me kontigjene, duke paralajmëruar atë se ka për qëllim që edhe të dalë para opinionit. 'Vazhdo' I ka thënë vazhdimisht Kryeministri, "këtu nuk ekziston një gjë e tillë si 'opinion publik'".⁸⁶

D. KONFRONTIMI ME HUA-DHËNËSIT NDËRKOMBËTARË: RASTI I TELEKOMIT TË MAQEDONISË

Sidoqoftë, korrupsioni nuk është aspak i kufizuar, për veprimet e zyrtarëve qeveritarë. Ky ngërthen të mundshmen e klimës për të bërë biznes në vend. Rasti në vazhdim mund të ilustrojë se sa konfidentë janë afaristët maqedonas në angazhimin e tyre në praktika problematike madje edhe kur këto vërrehen nga palë të jashtme. Sipas burimeve ndërkombëtare dhe maqedonasve të njoftuar rreth transakcioneve, Bordi i Telekomit të Maqedonisë vetës i shpalli dy dividente të rëndësishëm. I apri qe shpallur më 30 nëntor 2000, kur kompania ishte në mënyrë aktive e përfshirë në procesin e privatizimit. I dyti qe paguar pas pranimit të ofertës nga blerësit. Dividenta e parë numëronte shumën totale prej 25 dhe 30 milionë dhe e dyta, e cila është kontradiktore, mes rreth 8 dhe 20 milion dollarë amerikanë.⁸⁷

Ish-zyrtarë të Telekomit insistojnë në atë që të gjithë dividendat kanë qenë krejtësisht të njohura për blerësit që në fund kanë paguar 362.5 milionë Euro për kompaninë.⁸⁸ Megjithatë, blerësit thonë se nuk kanë qenë të njoftuar për dividendën e dytë dhe se kanë sfiduar shumën e 'sponsorizuesve' (grante

në kesh) të dhënë nga menaxhmenti i Telekomit gjatë dhe pas periudhës për pagesë.⁸⁹

Burime maqedonase shpalosin se dividendat kanë shkelur konventat e huasë të formuluar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Në të vërtetë, ata pranojnë se dividenta e dytë pasi që EBRD ka paralajmëruar qartë Bordin e Telekomit se po vepron në kundërshtim me rregullat për hua.⁹⁰

Kjo përvojë, të paktën është një anekdotë paralajmëruese për investitorët e huaj të cilët mund të mvaren nga disciplina që huadhënësit e fuqishëm si EBRD mund të ndodhë t'ua imponojë huamarrësve të vet.⁹¹ Sidoqoftë, Maqedonia e ka vështirë e ka që t'u kundërvehet investimeve. Përderisa shumë ndryshojnë varësisht nga definicionet, brenda një viti normal Maqedonia pranon 50-75 milionë dollarë nga investimet e huaja

Duke lënë anash shitjen jo të zakonshme të telekomunikacionit (që prodhoi 362.5 milionë €), investimet në vitin 2001 ranë nga 60-70 për qind⁹² dhe në 2002 mbeten të pakta.⁹³

Rënia e investimeve të huaja rrit çmimin e kapitalit për firmat e vendit që duan të fillojnë apo ta vazhdojnë biznesin, dhe e ngadalëson ekonomine në përgjithësi. 'Asnjë projekt biznesi nuk mund të japë mite nëse kjo shfrytëzon kredi që duhet të kthehet me kamatë deri në 20 për qind', thotë një kompani private.⁹⁴ Kamatat e larta nënkuptojnë që firmat duhet të shfrytëzojnë më shumë të ardhura për borzhin e shërbimeve se për prodhimtarinë dhe stafin punonjës.

⁸⁴ Intervistë e ICG, 3 prill 2002.

⁸⁵ Kjo është përse ai organizon fushata për ndryshime të ligjeve rregulloreve, që të bëjë të mundshëm konfiskimin e pasurive. P.sh; Transparency Macedonia kërkon që vlera e talsave për prona prejardhja e të cilave nuk të caktohet (e thënë në projekt-ligjin për anti-korrupsion) duhet të rritet në mënyrë të konsiderueshme.

⁸⁶ Intervistë e ICG, 11 prill 2002

⁸⁷ Intervistë e ICG, me një maqedon nga brenda, 12 korrik 2002, dhe me burime ndërkombëtare, përfshirë edhe një individ, 12 August 2002, që ka lidhje me konzorciumin e blerjes.

⁸⁸ Intervistë e ICG, me një maqedon nga brenda, 12 korrik

⁸⁹ Intervistë e ICG, me edhe një individ që ka lidhje me konzorciumin e blerjes, 12 August 2002.

⁹⁰ Intervistë e ICG, me një maqedon nga brenda, 12 korrik 2002.

⁹¹ Ka pasur edhe tregime tjera sinjalizuese, përfshirë edhe disa që kanë të bëjnë me më shumë se kontradita parashë. Gideon Sandel, një qyteatar Izraelit që përfaqëson biznese të ndryshme, i ka paraqitur me shkrim ICG se ai i është nënshtruar një paraburgimi të montuar për tre muaj në burg gjatë periudhës së qeverisë para kësaj (kur LSDM ishte në pushtet).

Ai akuzon për atë se atij i qe mohuar jo vetëm procesi, por edhe të dhëna se në base të çështjeve arrestuar.

⁹² Intervistë me IMF, dhe ndaras me ata të Fondit për Asistencë bisneseve të Vogla.

⁹³ Intervistë me IMF, 25 qershor 2002.

⁹⁴ "Kreditet e larta dhe korrupsioni Pengojnë Zhvillimin", *Kapital*, 7 shkurt 2002.

Kërkesa e përgjithshme bie, përfshirë edhe për kompanitë që nuk mvaren nga investimet e huaja, dhe aktiviteti ekonomik minimizohet. Humbja e investitorëve të huaj gjithashtu nënkupton humbjen e biznesit dhe teknikave menaxhuese të huaja, të nevojshme për ndërtimin e një ekonomie stabile.

Kështu që pasi dihen rreziqet ekonomike, qeveria maqedonase duhet që në mënyrë emergjente të ndërmarë në shqyrtim programin e vet të privatizimit për t'u siguruar se operon në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe që meriton besimin e investitorëve.

E. PRIVATIZIMI I RAFINERISË OKTA

Si në shumicaën e vendeve në tranzicion, privatizimi I pronës shtetërore në Maqedoni shumë shpesh nuk ka qenë transparent, duke rezultuar kështu me paqartësi nëse çmimi I blerjes dhe disa aspekte të marrëveshjeve, përfshirë edhe sjelljen e zyrtarëve të lartë, ka qenë I pranueshëm.

Në disa raste, blerjet nuk bëhen për vetë vlerat materiale (gjë që mund të jenë të vjetra dhe struktura të ndryshkura socialiste), por për të drejtat për monopol dhe marketing që t'i përshtaten firmës.. Këto të drejta ishin interesi më I madh për investitorët grekë, Hellenic Petroleum and Meton-Etep,⁹⁵ gjatë negociatave në 1998 dhe 1999 për ta fituar rafinerinë e naftës OKTA në Maqedoni. Në Maqedoni, Marrëveshja rezultoi me shitjen me çmim, që analistët objektivë mendojnë, të jetë I levërdishëm për blerësit jo vetëm për një beneficion shtetëror, por në të vërtetë mundësinë e saj që të kontrollojë importin dhe vlerësimin e një vlere strategjike, naftës. Një pjesë e madhe e sovranitetit energjetik të Maqedonisë në

mënyrë efektive u transferua tek një kompani nga një shtet fqinj me të cilin Maqedonia ka një sërë problemesh politike.⁹⁶ Zyrtarë ndërkombëtarë financiarë rekomandojnë ICG se vlera prej 32 milionë dollarë nuk përfaqësonte vlerën e drejtë të tregut dhe se krijimi I një monopoli privat nuk ishte I rekomanduar. Një investitor I pavarur, I njoftuar rreth marrëveshjes, haptas komentoi se ajo mund të ishte arritur vetëm 'nga një idiot ose zyrtar I korruptuar'.⁹⁷

Rruga deri marrëveshja për KTA-n qe përgatitur në janar të 1999 me miratimin e ligjit të ri për Privatizim, I cili I hoqi kërkesat standarde që privatizimi të nxjerret për tender ndërkombëtar në favor të një strategjie të re që lejon 'negociata të drejtëpërdrejta' me blerësin. Në këtë rast, qeveria ka negociuar vetëm me Hellenic dhe në fakt në këtë mënyrë inxorri jashtë loje konkurrentët potencialë (për shembull, disa kompani të mëdha ndërkombëtare të naftës).⁹⁸

Praktika e negociatave të drejtëpërdrejta të dyshimta kanë tërhequr vëmendjen e Bankës Botërore, por vetëm pasi shitja kishte përfunduar. Sipas një bankieri të fuqishëm maqedon, I cila tha se ai ka pasë bisedime me drejtorin e Bankës Botërore, James Eolfensohn në vjeshtën e vitit 1999 (pas shitjes). Banka I ka shkruar një letër qeverisë duke shprehur shqetësime të mëdha rreth transaksionit.⁹⁹ Dhe pas arritjes së marrëveshjes, Banka I imponoi Maqedonisë të adoptojë një metodë të re për tender publik dhe transparent si një kusht imediat për pagesën e transhit të dytë të një krediti të madh.¹⁰⁰

Ministri I Financave thotë se FMN dhe Banka Botërore rekomanduan që Maqedonia të shkojë drejt ' shitjes private'. Megjithatë, një zyrtar I lartë I Bankës Botërore mohon këtë dhe insiston në atë se

⁹⁵ Hellenic Petroleum dhe Meton-Etep Okta-n e blenë përmes kompanisë aksionere, të quajtur El.P.ET – Balkanike, Societe Anonyme Petroleum Trading and Investment. Meton-Etep është firma që menaxhonte ndërtimin e naftësjellësit që përfundoi para pak kohe, që lidh rafinerinë Okta me Selanikun, ndërsa Hellenic Petroleum është kryesisht shitës I naftës. Qeveria greke është aksioneri më I madh në Hellenic Petroleum. Intervista e ICG me Petros Karalis, Drejtor menaxhues I Okta-s dhe gjithashtu I El.P.ET.Balkaniki, më 8 gusht 2002. ICG I shkroi Hellenic Petroleum më 31 korrik 2002 për një takim ku do të diskutonin akuzat rreth marrëveshjes së Okta-s, dhe gjithashtu edhe Meton-Etep I shkroi të njëjtën ditë për të njëjtin qëllim. Hellenic Petroleum u përgjigj se Mr Karalis do të flaës rreth kësaj. Meton-Etep nuk u përgjigj. Sidoqoftë, gjatë takimit më 8 gusht 2002 të cituar më sipër, Mr Karalis I Okta-s tha se ai mund të flaës për të dyja, Hellenic Petroleum and Meton-Etep në këtë temë

⁹⁶ Kontradita politike u shfaqën në Greqi, dhe kështu u vendos një embargo gati e tërësishme për tregti ndaj maqedonisë prej 1993 deri 1995.

⁹⁷ Mbi diskutimet rreth akuzave ndaj Okta-s, shih *Start*, 28 maj 1999, "Strategjia e Naftës – ‘Kali Trojan I Naftës' I EL.P. ET. BALKAN?"

⁹⁸ Ministri i Financave, Nikolla Gruevski konfirmon se qeveria ka negociuar vetëm me Hellenic por thotë se kjo ndodhi për shkak se blerësit e tjerë potencialë asnjëherë nuk treguan interes të madh.

Intervistë e ICG me Ministrin e Financave, Gruevski, 8 gusht 2002.

⁹⁹ Intervistë e ICG me zyrtar të lartë financiar, 29 korrik 2002.

¹⁰⁰ Transhi I dytë i FESAL (Kredia për Rregullimin e Sektorit Financiar) numëronte deri në 30 milionë dollarë. Shih Raportin e Bankës Botërore N°P 7935 MK, 17 nëntor 2000.

institucionet financiare ndërkombëtare vazhdimisht kanë nxitur për tenderë publikë.¹⁰¹

Sibas një kopie të Marrëveshjes për Blerje dhe Koncesion të Ndarë, e arritur në maj të 1999, të cilën tani e ka ICG, blerësit e OKTA-s premtojnë të paguajnë 32 milionë dollarë amerikanë Brenda tri viteve. Dhe po për këtë, ata jo vetëm që morrën resurset e OKTA-s, por edhe 'të drejtën ekskluzive' për të përmbushur nevojat e njëpasnjëshme të Maqedonisë përmes importit brenda pesë vitesh.¹⁰² Importet duhej praktikisht të ishin të shlyer nga tatimet doganore (në tatim prej 1 për qind, dhe jo atë se çka një konkurrent për OKTA-n pretendon të jetë normale-22 për qind).¹⁰³ Blerësit gjithashtu The purchasers also fituan të drejtën për t'i vënë çmim naftës (sipas një formule) në çdo dy javë. OKTA mori të drejtën që llogarisë sasinë e përgjithshme të naftës, e nevojshme për të përmbushur nevojat energjetike të Maqedonisë, duke përdorur aktin e vet rafinerisë për eksport si një kriter. Së fundi, qeveria vazhdoi të mbajë përgjegjësinë mbi borxhet e OKTA-s deri në ditën e finalizimit të marrëveshjes.¹⁰⁴

Ekspertë financiarë që shqyrtuar raportet e OKTA-s thonë se firma, gjatë viteve 2000 2001 ka arritur të përfitojë gati 5 deri në 6 milionë dollarë amerikanë.¹⁰⁵ Nëse kjo qëndron, kjo do të thotë se

përfitimet e kompanisë gjatë këtyre dy viteve kanë mbuluar përafërsisht një-të-tretën e çmimit blerës, siç duket për këtë revista maqedonase e ka kundërshtuar çmimin blerëskur shkruante se 'partneri grek do ta blejë OKTA-n me paratë e ayetarëve të Maqedonisë'.¹⁰⁶

Supozohet se në fakt janë paguar vetëm 15 milionë nga 32 milionë dollarë të çmimit blerës. Ministri i Financave, Gruevski, konfirmon se transhi i fundit i blerjes nuk është paguar akoma, edhe pse ai thotë se pritet që kjo të bëhet së shpejti.¹⁰⁷ Afër një-e-treta e çmimit blerës (U.S.\$10 milionë) sipas kushteve të marrëveshjes, është dashur të pagohet si kapital i ndarë për naftësjellësin që lidh rafinerinë e Shkupit me portin grek të Selanikut., një projekt ky i njërit prej blerësve (Meton-Etep).¹⁰⁸

Blerësit e OKTA-s insistojnë në atë se me marrëveshjen ata kanë 'humbur para, si pasojë e investimeve të mëdha në infrastrukturën'.¹⁰⁹ OKTA dhe qeveria qëndrojnë në atë se Maqedonia ka përfutuar nga marrëveshja sepse ka siguruar 1,200 vende pune. I pyetur rreth marrëveshje, Kryeministri, Ljubço Georgievski vazhdimisht thotë se OKTA ka qenë një projekt i vjetëruar dhe i dështuar.¹¹⁰

Kushtet e marrëveshjes OKTA konsiderojnë se pozita e preferuar e objektivit të firmës mund të jetë e paligjshme; në këtë rast, marrëveshja imponon një obligim mbi qeverinë që të caktojë tatim, për të

¹⁰¹ Intervista të veçanta të ICG më 8 gusht 2002 me Ministrin e Financave, Gruevski dhe (përmes telefonit) Me drejtoreshën e Bankës Botërore në Vend, Marie-Helene Bricknell. Gruevski i ka dhënë një kopje të një letre Drejtorit menaxhues të FMN nga Drejtori i Bankës Qendrore, me datë 1 qershor 1998, duke treguar strategjinë e qeverisë që të ofrojë shitje direkte të pasurive shtetërore. Gruevski i shkroi një letër Bricknell më 12 maj 2000 ku premtoje se do të hiqet ligji që lejon shitjen e pronave shtetërore përmes marrëveshjeve direkte.

¹⁰² Marrëveshja për Blerjen dhe Koncesionin e Aksioneve, Neni 5.

¹⁰³ Ibid, Neni 8, thotë se blerësi nuk do të pagojë më shumë se 1 për qind të taksës. Makpetroli, konkurrenti i Okta-s, i ka pohuar ICG se taksa normale është 22 për qind. Makpetrol and Okta konfirmojnë se kanë arritur një mirëkuptim, sipas të cilit Makpetrol do t'i blejë prodhimet e naftës nga. Intervista përmes telefonit e ICG me drejtorin e Makpetrol, 8 gusht 2002, dhe takimi ndaras me Karalis të Okta-s, gjithashtu më 8 gusht 2002.

¹⁰⁴ Ibid, Neni 6, cakton hipotezat e detyrimeve ligjore të kompanisë dhe thotë se 'Aksioneri do të paraqitet dhe fillojë në datën e përfundimit të plotë dhe në mënyrë të parevokueshme të të gjitha detyrimeve ligjore të Kompanisë siç thuhet deri në/ përfshirë edhe ditën e fundit....'

¹⁰⁵ Drejtori menaxhues i Okta-s thotë se profiti vjetor është rreth 4 milionë dollarë. Intervistë e ICG me Petros Karalis,

Drejtori menaxhues i Okta dhe i El.P.ET.Balkaniki, on 8 gusht 2002.

¹⁰⁶ Start, 28 maj 1999.

¹⁰⁷ Intervista e ICG me Ministrin e Financave, Gruevski, 8 gusht 2002.

¹⁰⁸ Marrëveshja për blerjen e aksioneve, paragraph 4.1(d). Si pasojë, blerësit e Okta-s besohet të gëzojnë tani të drejtën ekskluzive për furnizimin e Maqedonisë përmes naftësjellësit, në njëzet vitet e ardhshme.

Në mënyrë kontraktuale, kjo do të duket se bllokoi projektin konkurrent "AMBO" (Shqipëri – Maqedoni – Bullgari) i cili, sipas disa analistëve, mendohet të sjellë një baraspeshë të rëndësishme në stabilizimin lindje-perëndim për zhvillimin rajonal. Shih vlerësimet "Krijimi i një relacioni bazuar në interese mes Maqedonisë dhe SHBA-ve.", prezantuar nga Glenn Levine, Praktikant në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, Uashington, DC, në Procesin 2002 Tryezë e Rrumbullakët mbi Sigurinë Kombëtare të Maqedonisë, 11 maj 2002.

¹⁰⁹ Intervistë e ICG me Petros Karalis, Drejtori menaxhues i Okta dhe i El.P.ET.Balkaniki, on 8 gusht 2002.

¹¹⁰ ICG e pyeti Kryeministrin rreth marrëveshjes Okta dhe për korrupsionin, në forumin publik të sponsorizuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur, më 21 qershor 2002.

siguruar që OKTA do ta ruajë pozicionin tepër ekskluziv.¹¹¹ Konkurenti më Iserioz I OKTA-s, Makpetroll, ka një sfidë para Gjyqit Suprem, kur pretendon se monopoli I OKTA-s mbi importin është joligjor dhe kontradiktor me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (tregtia e lirë) që Maqedonia ka nënshkruar me Unionin Evropian (prill 2001).¹¹²

Kushtet e plota, përfshirë "Marrëveshjen për Blerje dhe Koncesion të Ndarë", nuk janë publikuar,¹¹³ dhe kjo 'ndihmon në ngjalljen e shqetësimeve në masë të gjerë, për atë se zyrtarët maqedonë ndodh që të kenë marë 'shuma' të majme si pjesë të marrëveshjes. Një politikan ka llogaritur që këto shuma të arrijnë deri në 5 milionë dollarë; një tjetër llogaritje supozon që rreth 5 deri në 15 milionë dollarë kanë përfunduar në llogari private.¹¹⁴ Drejtori menaxhues I OKTA-s, I cili thekson se ai gjithashtu mund të flet edhe në emër të Hellenic dhe Meton-Etop, të cilin ICG e pyet direct nëse është paguar shuma në lidhje me shitjen e OKTA-s, thotë se ' nuk beson që një shumë e tillë është paguar'.¹¹⁵

Përmasat e marrëveshjes OKTA dhe implikimet eakuzave që rrethojnë atë, janë të një magnitude të tillë sa që opinioni në Maqedoni ka të drejtë dhe interes të qartë që ta ekzaminojë gjithë dokumentacionin për atë se çfarë është bërë në emër të tyre nga përfaqësuesit të zgjedhur nga vetë ata. Qeveria e Maqedonisë duhet të japë dokumentacionin e plotë për t'I mbushur mendjen opinionit bazuar në të gjitha të dhënat e mundshme.

¹¹¹ Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve, Neni 8.

¹¹² Intervista e ICG me menaxherin e Makpetrol Josipovski, 12 prill 2002. Makpetrol citon paragrafin 33 të MSA. Dokumenti I Makpetrol, paragrafet 7.2 dhe 7.3.3. MSA autorizon heqjen ose uljen e taksave progresive për të gjithë importuesit, dhe jo vetëm të firmave të selektuara. Shih MSA, Titulli IV "Lëvizja e Lirë e Mallrave", Kapitulli I "Prodhimet Industriale", Neni 18. Dokumenti I Makpetrol, paragrafi 7.3.2.1. Edhe pse Makpetrol dhe Okta kanë arritur marrëveshje mbi blerjen e prodhimeve të naftës së Okta-s, zyrtarë të Makpetrol insistojnë se kjo nuk ndikon mbi rastin para Gjyqit Kushtetues.

Intervista me telefon e ICG me drejtorin e Makpetrol, 8 gusht 2002. Okta konteston atë se qeveria po shkel kontratën duke i lejuar konkurrentit Makpetrol ta importojë naftën, në kundërshtim me pozitën monopolistike që gëzon Okta. Intervistë e ICG me Petros Karalis, Drejtori menaxhues i Okta dhe I El.P.ET.Balkaniki, on 8 gusht 2002.

¹¹³ Dokumenti I Makpetrol, paragrafi 4.

¹¹⁴ "Tregimet mbi Korrupsionin në Maqedoni", Rrjeti Alternativ Informativ (AIM), 30 prill 2001.

¹¹⁵ Intervistë e ICG me Petros Karalis, Drejtori menaxhues i Okta dhe I El.P.ET.Balkaniki, on 8 gusht 2002.

F. UJDIA E BRENDSHME: BANKA E MAQEDONISË

Pasi që korrupsioni në Maqedoni shpesh po del në shesh, herë pas here lind nevoja për të gjetur 'frontet' për të zëvendësuar rëndësinë e vërtetë të pronësisë, Mediat kanë identifikuar një sërë rastesh të tilla, ndoshta më I njohuri nga të gjithë involvon transferin e pronësisë që ka të bëjë me bankën e madhe ' Bankën e Maqedonisë'.

Në vazhdim të blerjeve të shumta nga partia VMRO-DPMNE, Gjyqi Suprem, në vitin 2001 hoqi rregulloren në ligjin financimin e partive politike që siç duket ndalonte prona të tilla.¹¹⁶ Gjyqi Suprem bëri të qartë se ishte alarmaur që partitë politike të mos angazhohen në veprimtari tregtare fitim-prurëse. Në vend që të distancojë veten duke rrespektuar këtë rregullore, VMRO-DPMNE siç supozohet ka pozicionuar aksionet e Bankës së Maqedonisë, me të cilat kamata të konsiderueshme kanë përfunduar në duart e 'tre ushtarëve' të partisë- të ashtuquajtur ' beqarë': Drejtori I Shërbimeve Elektrike (ECM)-Llambe Arnaudov, Drejtori I Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Sekretari I përgjithshëm I VMRO-DPMNE-Vojo Mihajlovski, dhe Marjanço Koneski¹¹⁷, me profesion vozitës. Sipas zyrtarëve të Bankës, 'beqarët' para pak kohe Ia kanë transferuar aksionet eveta një individi, identiteti dhe historia e të cilit nuk është është krejtësisht e qartë.¹¹⁸

Zyrtarë të Bankës Qendrore dhe Banka Botërore kanë konfirmuar se është bërë transferimi I aksioneve të 'beqarëve'¹¹⁹. Banka Qendrore fajëson Bankën Botërore për mundësimin transfereve të gabueshme të aksioneve, duke insistuar në ndryshimin e legjislaturës e cila Bankës Qendrore ia heq mundësinë që t'u kundërvihet pagesave prej më pak se 10 për qind të kapitalizimit të përgjithshëm. Ata thonë se VMRO-DPMNE pati mundësinë ta shfrytëzojë këtë duke e bërë transferin për beqarët në transaksione ku secila prej tyre ishte shumë afër asaj

¹¹⁶ Vendimi I Gjyqit Kushtetues, publikuar në Edicionin me Numër 70/92 të Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë. Gjthashtu shih, "Gjyqi Kushtetues mbyll kompanitë partikae", *Dnevnik*, 1 mars 2001.

¹¹⁷ Besohet se VMRO-DPMNE reagoi në mënyrë të ngjashme edhe me institucionet tjera ku kishte interesin më të madh, por rasti me Makedinska banka është rasti më famëkeqe.

¹¹⁸ Intervistë e ICG me zyrtarë bankarë, 21 dhe 25 qershor 2002.

¹¹⁹ Ibid.

që do të kërkonte aprovimin e Bankës Qendrore.¹²⁰ Gazeta e pavarur ditore, *Dnevnik*, ka identifikuar në mënyrë transakcionet e sakta të bursës kështu siç vijon: Kompania për printim Goce Delcev, që siç dihet është nën kontroll të VMRO-DPMNE,¹²¹ hiti rreth 10 për qind të aksioneve të veta në Bankën e Maqedonisë ia shiti vozitësit Koneski, siç thuhet për shumë më pak sa vlejën ato Supozohet që Arnaudov ka fituar një sasi të njejtë aksionesh për çmim të njejtë; dhe Mihajlovski ka marrë 8 për qind nga aksionet e përgjithshme nga tre kompani të ndryshme.¹²² Z. Mihajlovski ftesës me shkrim nga ICG për të diskutuar rreth kësaj çështjeje.¹²³

Në një intervistë të rëndësishme me Krye-ministrin Georgievski, I pyetur se si jë vozitës mund bëhet bashkë-pronar I një banke, ai nuk e kundërshtoi këtë por u përgjigj se sipas 'dekretit të Gjyqit Kushtetues'.... VMRO-DPMNE vendosi që gjithë aksionet që janë në disa kompani t'ua ndajë anëtarëve të vet, ose aksionet t'ua shet anëtarëve të partisë me çmim të ligjshëm. Atëherë Krye-ministri doli me njoftim se qëllimi I transakcioneve ishte bërë në veçanti për ta ruajtur kapitalin në mënyrë efektive nën kontroll të partisë, që do të thotë t'I shmangët qëllimit imediat të dekretit të Gjyqit Kushtetues. Pyetjes vijuese të gazetës, 'Cka nëse ato që kanë marrë aksionet distancohen nga partia?', Georgievski u përgjigj: ' Besojmë që ata nuk do të largohen. Këtu kemi të bëjmë me anëtarë të besueshëm të partisë'.¹²⁴

Banka e Maqedonisë nuk është vetëm edhe një belrje me çmim të ulët/zbritje. Sipas një zyrtari të lartë të Bankës Qendrore, një qëllim për të cilën banka është depozituar është që kapitalin ta drejtojë tek firmat tjera, të cilat janë blerë nga partia dhe u që pastaj janë transferuar 'ushtarëve partiakë' përmes të njejtës mënyrë transferimi.¹²⁵ Kontrolli I një banke u lejon pronarëve të vet informata mbi gjendjen financiare të depozitorëve apo kreditorëve, e cila është një resurs që në mënyrë potenciale

mund të shfrytëzohet për ndikuar në veprimet e saj. Të keshë një bankë nën kontroll partiak, do të thotë gjithashtu se fondet- pamvarësisht nga cili burrim-mund të hyjnë dhe dalin jashtë vendit pa ndonjë rrezik të madh për t'u vërrejtur.

Transferi I aksioneve tek anëtarë të besueshëm të partisë mund të ketë mbetur në përmbajtjen e letrës zyrtarë të ligjit (dhe në të vërtetë kjo është e mundur sepse për transakcione tjera VMRO mund të mos ketë kontroll efektiv ndaj bankës) , mirëpo siç duket kjo punë aspak nuk ndrit peshë mbi etikën politike. Do të ishte e dobishme për individët dhe oragnizatata që I shqetson kjo punë, që të shtrojnë përpara të gjitha hollësitat me qëllim që t'u mundësojnë qytetarëve të Maqedonisë që në mënyrë të informuar të gjykojnë mbi këto dekrete.

Pasi ka dukjen krejtësisht të një bankë *private*, partia gjithashtu nuk përtoi të sigurohet që do të ruante ndikimin politik në një bankë *shoqërore*-Banka e Maqedonisë për Zhvillim Në shkurt 2002, qeveria kurdisi flakjen nga puna të Vladimir Naumovski, drejtor I nderuar I Bankës së Maqedonisë për Nxitje të Zhvillimit. Diplomatat mendojnë se arsyeja e vërtetë për largimin e Naumovskit është se ai ka rrefuzuar aprovimin e kredive të dyshimta për aleatë të qeverisë dhe se me bankën e tij, veç më e caktuar që të mbikqyrë fondet e donatorëve për përkrahje të Biznese të Vogla dhe të Mesme, ai mund të ketë qenë pëengesë që është dashur të largohet.¹²⁶

Ministri i Financave, Gruevski mohon arsyen për largimin e tij, dhe në vend të kësaj shton se deri aty ka ardhur për shkak ujdive të dyshimta që ka bërë Naumovski.¹²⁷ Ai që zëvendësoi Naumovskin, Dragan Martinovski, jo vetëm që shprehet se Naumovski ka qenë I korruptuar por gjithashtu tha se ish-drejtori mban përgjegjësinë që Banka për Zhvillim mban një 'portfolio jo-produktive' prej gati 70 për qind të.¹²⁸ Edhe pse ai akuzon prezantimin e

¹²⁰ Ibid.

¹²¹ Shih, p.sh; "Grevë në Shtypshkronjën 'Goce Delçev'", Utrinski Vesnik, 9 gusht 2002: "Shtypshkronja është pronë e VMRO-DPMNE".

¹²² "VMRO-DPMNE rrit kapitalin e vet bankar", *Dnevnik*, 20 qershor 2001.

¹²³ ICG ka kërkuar takim me z. Mihajlovski, përmes letrës dhe thirrjeve telefonike, më 15 korrik 2002 dhe 29 korrik 2002 prej të cilit s'ka marrë përgjigje.

¹²⁴ Intervistë me Krye-ministrin Ljupço Georgievski, *Dnevnik*, 31 dhjetor 2001.

¹²⁵ Intervistë e ICG me zyrtar të lartë të Bankës Qendrore më 25 qershor 2002.

¹²⁶ Ky aspak nuk është shembull i dorës së dytë nga ndonjë sektori të parëndësishëm sepse ekonomistët rritjen e NVM-ve si s'gjighe për papunësinë të madhe në Maqedoni, të cilën Enti i Statistikës të Republikës së Maqedonisë e vlerëson mes 30 dhe 40 përqind, kurse thajse një e katërta nga ata të cilët punojnë nuk marrin rroga rregullisht.

¹²⁷ Intervista e ICG-së me ministrin e financave Gruevski, 16 prill 2002

¹²⁸ Intervista e ICG me drejtorine e Bankës Maqedonase për zhvillim, Dragan Martinovski, 22 prill 2002. Naumovski i mohoi akuzat dhe tha se ka dokumente me të cilat mund ta dëshmojë këtë. Gjithashtu, ai tha se në vendimin e tij askund nuk përmendet puna e gabueshme. Intervistë e ICG me

dobët gjatë menaxhimit të Naumovskit, Martinovski bën të ditur se, ndryshe nga ish-drejtori, ai nuk ka aspak përvojë në menaxhimin e një portfolio bankare të çfarëdo lloji.

G. PRESIONET NDAJ GJYKATAVE: MARRJA E MAK TABAK

Kompania e duhanit, Makedonija Tabak 2000, menaxhohet nga Stevco Kocevski, i cili është i afërt me gruan e Kryeministrit Georgievski, Snezhana.¹²⁹ Instalimi i anëtarëve të familjes, siç del, ka qenë prioritet i partisë së Kryeministrit me qëllim që ta marrë kompaninë. Sipas aksionerëve dhe ish-anëtarëve të bordit, presioni mbi ish-kryetarin e Makedonija Tabak, Straso Nelovski, anëtar i partisë LSDM për të dhënë dorëheqje ka filluar në shtator të vitit 1999. Kur Kocevski e zuri vendin e tij, u larguan edhe 8 anëtarë të tjerë të bordit.¹³⁰ Në Dhjetor 1999, bordi i renovuar mori vendim që të krijojë një kompani të re, Makedonija Tabak 2000.¹³¹ Në gjashtë muajt e ardhshëm, kompania paraprake, Makedonija Tabak, shpalli bankrot, dhe për këtë u zgjodh një administrator për ta përcjellur punën e saj.

Sipas aksionerëve dhe të tjerëve që e njohin rastin mirë, administratori i bankrotit lejoi që përfitimet të kalohen në kompaninë e re "Mak Tabak 2000", ndërsa shpenzimet, që siç duket arrijnë shumën prej 25 milionë dollarë të mbetën te kompania e parë.¹³² Atëherë, "Mak Tabak 2000", me një shkathtësi financiare përmes investimeve të veta në një

kompani tjetër ("Gold Mak"), arriti të bëhet aksioneri më i madh në Kombinatin e Duhanit (Tutunski Kombinat) – një firmë së cilës Makedonija Tabak i mbetët borxh së paku 4 milionë Euro. Me fjalë të tjera, grushti ndaj ish-bordit të Makedonija Tabak rezultoi në formimin e një guace krejtësisht të re që absorboi jo vetëm gjithë vlerat e saj- duke i lënë obligimet e veta pas- por edhe të gjithë kreditorët e saj.

Aksionerët dhe ish-anëtarët e bordit të Makedonija Tabak ndritën padi praën Gjykatës së Shkupit në qershor të 2001 duke kërkuar 'çregjistrim zyrtar të Makedonija Tabak 2000 dhe që gjyqi të ndalojë kompaninë që të disponojë me ndonjë pasuri.¹³³ Në gusht 2001, Gjyqi një urdhër që faktikisht ngrin pasurinë e kompanisë në pritje të një vendimi përfundimtar mbi të drejtat e aksionerëve. Aksionerët pohojnë se Makedonija Tabak 2000 ka injoruar vendimin e gjyqit dhe e ka shitur pronën në kohën e parashtrimit të ankesave. Në dhjetor 2001, gjyqi i Apelit përkrah vendimit e gjyqit më të ulët. Në prill 2002, siç thonë më tej aksionerët, Makedonija Tabak 2000 e transferoi selinë nga Shkupi në Shtip për të komplikuar kështu karakterin e rastit dhe për të kërkuar gjykatës më të favorshëm. Tani gjykata e Shkupit duhet të mbështetet në gjykatën e Shtipit për shumë aspekte, dhe kjo e fundit, siç thonë aksionerët, është në miqësi me Makedonija Tabak 2000.¹³⁴

z. Kocevski drejtor i Makedonija Tabak 2000, ka mohuar akuzat e aksionerëve para ICG dhe ka dhënë qëndrimin e vet se 'procesi gjyqësor ka përfunduar'. Ai e pa dokumentacionin konfidencial që ka të bëjë me marrjen dhe transformimin e Makedonija Tabak, por Kocevski nuk kundërshtoi legjimitetin e tyre por tha se këtu nuk ka asgjë të parregullt. Ai tha se vendimet kyçe për këtë janë marrë nga një 'këshill i atyre personave që kanë poseduar pasuritë' dhe procesin e marrjes dhe transformimit në Makedonija Tabak 2000 e përshkroi që paska 'një histori speciale' Ai e shpjegoi kalimin formal të kompanisë në Shtip si pasojë e asaj se firma nuk ka qenë

Vllado Naumovskin, 26 prill 2002. Ministri i financave për ICG deklaroi se puna e gabueshme nuk përmendet si arsye zyrtare për shkak se Qeveria do të ishte e detyruar të shkojë në gjyq, kurse "nuk ka prova". Intervistë e ICG-së me Gruevskin, 16 prill 2002.

¹²⁹ Motra e Kocevskit, Vesna Takovska, është e martuar për vëllaun e Snezhanës. Zonja Takovska është drejtoreshë e Tabak Sigurimit, ndërmarrje e cila rodhi nga ndërmarrja e dikurshme Makedonija Tabak.

¹³⁰ Sipas avokatit të aksionarëve të Makedonij Tabak-ut, në kohën kur z. Kocevski u bë drejtor, 63 përqind nga kapitali i firmës u ka takuar aksionarëve, kurse 37 përqind Agjencionit për Privatizim. Intervistë telefonike e ICG-së me Sasha Krstiq, 12 gusht 2002.

¹³¹ Makedonija Tabak 2000 formalno u regjistrua në shkurt 2000, edhe pse vendimi për themelimin e ndërmarrjes ishte miratuar para dy muajve, bile edhe para se të bankrotojë. Aksionerët insistojnë se Makedonija Tabak nuk ishte bankrot. Intervistë e ICG-së me ish-anëtarët e Këshillit të Aksionarëve të Makedonija Tabak, 2 korrik 2002.

¹³² Intervistë e ICG-së

¹³³ Aksionerët kanë parashtruar padi të veçantë me të cilën kërkojnë gjyqi të vërtetojë se ata janë pronarët ligjor të ndërmarrjes. Aksionerët i treguan një letër shkurajuese ICG-së nga ministri i financave dhe një dokument të veçantë nga Regjistri për indosimin e tij. Intervistë e ICG-së me aksionerët, 3 korrik 2002.

¹³⁴ Ibid.

pronare e ndërtesës së madhe me zyra moderne në Shkup (atje ku u zvillua takimi me ICG).¹³⁵

Aksionerët që rrëfehen për rastin Makedonija Tabak para ICG thonë se ata mendojnë se gjykatësit që shqyrtojnë rastin e tyre nuk janë aq të korruptuar sa janë të kërcënuar. Neda Zdraveva, Koordinatorë e Programit për Drejtësi në Institutin për Shoqëri të Hapur në Maqedoni, thotë se ndërhyrja politike në drejtësi është një problem kronik dhe se politikanë të lartë janë përpjekur që të ndikojnë në zgjedhjen e gjykatësve për rastet ku ata kanë pasur interes.¹³⁶

Në një shembull të paradokohshëm në kërkim të mundësisë për të imponuar ndikim politik mbi gjykatësit, Tomislav Stojanovski, një politikan i lartë i VMRO-DPMNE-së dhe nën-kryetar i parlamentit, Tomislav Jovanovski, djali i të cilit është Drejtori i Doganave, Dragan Daravelski, më 18 korrik 2002¹³⁷ qeu emërua anëtar i Këshillit të Juristëve me një mandat shtatë vjeçar (supozohet të jetë komision i pavarur që selekton kandidatët trupit gjykues dhe i cili mbikqyr 'kompetencën dhe etikën e gjyqtarëve gjatë punës së tyre'¹³⁸). Del se ky emërim ka ardhur në konflikt me konventën, e cila ndalon që anëtarët e këtij komisioni të mbajnë poste të tjera publike apo të jenë aktivistë të ndonjë partie politike.¹³⁹

Zdraveva thekson se anketat tregojnë që opinioni ka njohuri që korrupsioni në radhët e trupit gjykues të jetë i lartë. Sidoqoftë, me që edhe gjykatat janë të përfshira në korrupsion, përpjekjet e Makedonija Tabak 2000 që të ndryshojë lokacionin të jep të kuptosh se disa gjyqtarë janë të qëndrueshëm ndaj presioneve dhe miteve. Gjyqi Kushtetues, në tërësi del që të tregojë se është jashtëzakonisht i pavarur.

E rëndësishme është fakti që gjyqtarët më shumë janë nën presion të ndikimit politik se sa nga një korrupsion i gjithanshëm. Distancimi i gjyqtarëve

nga presioni politik është më i mundshëm se sa shkulja e korrupsionit malinj nga vetë trupi gjykues.

H. TRAFIKIMI SHTETEROR: TREGTIA ME DUHAN

Industria e duhanit është një element jetik i ekonomisë së Maqedonisë, në të cilën përfshihet 16 për qind e popullatës. The tobacco industry is a vital element of Macedonia's economy, engaging 16 per cent of the population.¹⁴⁰ Për gjatë kohë ka lidhje me qeverinë dhe politikën. Para ardhjes së Kocevskit dhe ekipit të tij që ka lidhje me qeverinë aktuale, biznesi dominohej nga legjendari Danço Sutrakov, i cili është i afërt me qeverinë e LSDM-së, dhe për gjatë kohë ai njihej si baroni i duhanit të Jugosllavisë.

Megjithatë, në Maqedoni, duhani gjithashtu historikisht ka pasur edhe anën e vet të errët. Kontrabanda me duhan është 'e natyrshme' për vendin, dhe atë në dy mënyra: e para, për nga pozita gjeografike si një udhëkryq i Ballkanit që lidh Greqinë, Bullgarinë, Kosovën dhe Serbinë jugore, dhe Shqipërinë; e dyta, si një prodhues i konsiderueshëm (në botë radhitet në vendin e shtatë) i kualitetit të lartë të duhanit Oriental (aromatic). Ish-ministri i Punëve të Brendshme, Pavle Trajanov, revista *Fokus*, dhe të tjerë thonë se Drejtori i Doganave, Dragan Daravelski është sot projektuesi i kontrabandës së duhanit në Maqedoni, dhe se ai ka përkrahjen e plotë të qeverisë në nivelin më të lartë.¹⁴¹ Supozime tjera thonë se Kombinati i Duhanit (Tutunski Kombinat) në vendlindjen e Daravelskit, Kumanovë, që prodhon disa nga llojet më të njohura të cigareve dhe të cilën e ka blerë Makedonija Tabak 2000, është qendër e prodhimit të cigareve falco.¹⁴²

Drejtori i Doganave, Daravelski absolutikisht mohon çfarëdo implikimi në trafikim të paligjshëm të duhanit dhe thotë se në Maqedoni nuk prodhohen

¹³⁵ Intervistë e ICG-së me Stevço Kocevski, 8 korrik 2002.

¹³⁶ Intervistë telefonike ICG-së me Neda Zdraveva, 3 korrik 2002.

¹³⁷ Kushtetuta e Maqedonisë, neni 105.

¹³⁸ "Tomislav Stojanovski u emërua anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë", *Dnevnik*, 18 korrik 2002.

¹³⁹ Shikoni Kushtetutën e Maqedonisë, neni 104 (5) "funsioni anëtar i Këshillit Gjyqësor Republika është e papajtueshme me kryerjen e funksioneve tjera publike, profesione ose me anëtarësi në parti politike". Gjithashtu, shikoni Ligjin për Këshillin Gjyqësor Republikan, nenet 5 dhe 7.

¹⁴⁰ Stevo Kocevski, drejtor i "Makedonija Tabak 2000", "Disa komente për kushtet e prodhimit të duhanit në botë dhe vendin tonë", *Buliten i Ministrisë së Financave*, 12/2001, f. 100.

¹⁴¹ Në pranverën e vitit 2001 *Fokus* botoi një cikël detaj në tri pjesë të artikujve për atë çka ishte përshkruar si operacion kontrabandist i Daravelskit, duke cituar emra, adresa, sasi dhe metoda. ICG kishte intervista të ndara me autorin e artikullit dhe burime tjera të cilat vërtetuan të dhënat e revistës.

¹⁴² Për shembull, shikoni në *Fokus* ciklin prej tre pjesëve të përmendur, pranverë 2001.

cigere falco.¹⁴³ Megjithatë, dalin rrethana të pazakonshme që meritojnë hulumtime nga afër nga autoritetet maqedonase përkatëse. ICG ka një dokument të Kombinativit të Duhanit-Kumanovë, në të cilin kompania bën të ditur se prodhon cigare të firmës 'Assos'. Pronari i llojit 'Assos' thotë për ICG se nuk ka pasur ndonjëherë marrëveshje me ndonjë kompani maqedon për prodhim të cigareve të llojit të vet.¹⁴⁴ ICG gjithashtu posedon druj prodhimi supozohet nga Kombinativit i Duhanit-Kumanovë që del se vverifikon prodhimin e bjë numri llojesh të cigareve, përfshirë edhe atë ' Monte Carlo', pronar i së cilës tani është Duhani Japonez (Japan Tobacco). Kjo kompani para do kohe ka shkruar një letër të ashpër në adresë të Kryeministrit të Serbisë, duke iu ankaur për një 'skemë masive të falsifikimit dhe kontrabandës, përfshirë edhe llojin Monte Carlo në Jugosllavi'.¹⁴⁵

Daravelski gjithashtu akuzohet për përdorimin e të njëjtave metoda për ta larguar ose kufizuar konkurrencën në industrinë e duhanit, ashtu si edhe për preferencan mbi kompanitë e transportimit të mallrave. Për shembull, një zyrtar i doganave i tregon ICG se kompania sllovene Tobacma, thuhet të ketë blerë fabrikën e duhanit në Shkup-TKS, me siç duket çmim të levërdishëm, dhe se prodhimi që bllokuar nga Dogana me qëllim të vjeljes së 'bakshishit' prej 1.5 milionë dollarë.¹⁴⁶ Z Daravelski para ICG vendosmërisht i mohoi këto akuza.¹⁴⁷

Kryeministri Georgievski në mënyrë indirekte bëri të ditur se me duhanin ka dalur problem kur ai ka shprehur

nevojën që të heqë taksat mbi cigaret, gjë që nxit kontrabandën.¹⁴⁸ Mediat edhe Ministri i Financave për gjatë kohë kanë folur mbi parregullsitë në Doganat.¹⁴⁹ Prokurori Publik, Xhikov, i emëruar nga VMRO-DPMNE, për ICG konfirmon shqetësimin e tij për veprimet doganore.¹⁵⁰

Para e madhe fitohet me kalimin e cigareve, qoftë ato prodhime të licensuara apo prodhime falco, në tregjet e Evropës Perëndimore dhe Lindore.¹⁵¹ Një llogari jep vlerën e një kamioni të vetëm të ngarkuar me cigare të falsifikuara prej afërsisht 100,000 dollarë amerikanë (këtu edhe përqindja që normalisht marrin zyrtarët e doganës).

Trafikimi i cigareve falco është një formë e krimit të organizuar. Sidoqoftë, ndryshe nga krimi i organizuar në Perëndim, rrjetet kriminale në Ballkanin Perëndimor zakonisht funksionojnë përmes institucioneve shtetërore, dhe jo përreth tyre.

Një numër i madh i zyrtarëve të doganave dhe shërbimeve të sigurimit në rajon (qoftë ata të rregullt apo jo) kanë reputacion për baashkëveprim aktiv në kontrabandë. Dhe në këtë kuptim, 'trafikimi shtetëror' apo 'trafikimi i përkrahur nga shteti' mund të jetë termi më i përshtatshëm se ai 'kontrabandë'.

Mes tjerash, edhe pse cigaret mund të trafikohen në mënyrë shumë të tjeshtë dhe të rehatshme se bimët narkotike, femrat ose armët, aktivitetet janë ngajshme dhe të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Një studim i bërë para pak kohësh mbi krimin e organizuar, korrupsionin dhe trafikimi i armëve

¹⁴³ Intervistë e ICG-së me drejtorin e Administratës së Doganës, Daravelski, 23 korrik 2002. Edhe pse Daravelski mohonte se në Maqedoni ekziston çfarëdoqoftë prodhimi i palejuar cigareve dhe se kjo është jashtë kompetencave të Administratës së Doganës, ai na dha një kopje të revistës zyrtare të Doganës, *Carinik*, në të cilën ishte botuar një artikull për, gjoja, fabrikën ilegale të Marlboros në Kosovë. Daravelski, njësoj si edhe ministri Gruevski, deklaroi se Kosova është "gjeneratori i kriminaliteti dhe korrupsionit në Rajon". Shikoni *Carinik*, nr. 9, prej 5 korrikut 2002, "Marlboro të prodhuar në Gjilan, (Kosovë)". Sipas raportit vjetor të Administratës së Doganës (f.20), në vitin 2001 u inicuan vetëm gjashtë paraqitje penale.

¹⁴⁴ Dokumenti është "Vendim" i " Kombinativit të Duhanit Kumanovë" prej 1.11.1999. Pronari i markës "Asos" është ndërmarrja për cigare "Papastratos" nga Atina, Greqi. Intervistë e ICG-së me Arvanidis-in, drejtor i eksportit të "Papastratos-it", 31.7.2002.

¹⁴⁵ "Këtë javë mbledhja në katër sy me Japan Tobacco dhe Zoran Gjiniçiq-in", *Сведок*, 23.7.2002, f.3.

¹⁴⁶ Intervistë e ICG-së me nëpunës doganor për çështjen e shpedicionit, shikoni më lart, kapitulli IIIA.

¹⁴⁷ Intervistë e ICG-së me drejtorin e Administratës Doganore, Daravelskin, 22 qershor, 2002.

¹⁴⁸ Kryeministri në Konferencën për korrupsion të Institutit Shoqëria e Hapur, *Nova Makedonija*, 22 qershor 2002.

¹⁴⁹ "Dogana...ende është një ngapikat më të dobëta në institucionet e sistemit", në "Krim, ekonomi e përhitur dhe korrupsion", ministër i financave Nikolla Gruevski, 31 mars 2002. Qëndrimet e veta Gruevski i elaboroi në intervistën për ICG-në më 16 prill 2002.

¹⁵⁰ Intervistë e ICG-së me prokurorin publik Stavre Xhikov, 25 prill 2002.

¹⁵¹ Evropa Lindore është e njohur si treg i jashtzakonshëm për mall të falsifikuar. Para do kohe UE nisi dhe humbi kontest në të cilin deklaronte se gjigantet amerikane të duhanit Filip Moris dhe R. J. Reynolds me qëllim i furnizojnë tepër shtetet nga Evropa Lindore, për shkak të kontrabandës me tepicës së cigareve në UE, çka kushtoi mijarda në tatime të humbura. ". Gjyqtari hodhi posht padinë e UE kundër kompanive të duhanit". Associated Press, 20 shkurt 2002. Shtypi danez hapi çështjen rreth asaj a është e mundur prodhuesi më i madh i cigareve në atë vend, ST, të eksportoje cigare për shkak të furnizimit të kontrabandistëve "në vendet siç është Maqedonia", *Politiken*, 13.2.2002.

tregon se rritja e trafikimit me bimë narkotike, njerëz dhe kontrabanda tjera është paral dhe 'I lidhur ngushtë' me trafikimin e armëve.¹⁵² Zyrtarë ndërkombëtarë humanitarë që angazhohen për të ndihmuar femrat në Maqedoni, të cilat kanë rënë në kurthën e zinxhirëve të prostitucionit, konfirmojnë se ato veprojnë në linja nacionale dhe në mbarë vendin; femrat, kryesisht nga Moldavia dhe Ukraina trafikohen tek dhe përmes zinxhirëve shqiptarë në bashkëpunim me maqedonët dhe jo-shqiptarët e tjerë.¹⁵³

Thënë shkurt, nëse për kufijtë gjehet kompromis me ndihmën e agjencive të caktuara për të kontrolluar ato, nuk ka kufi për natyrën e kontrabandës që të operojë. Për qeverinë maqedonase interesi i qartë publik është që t'u japë përparësi hetimeve mbi akuzat dhe mohimet, dhe që të shtrojë para vetës të gjithë të dhënat, kështu që qytetarët, si të informuar, të mund të arrijnë në konkludime.

I. BASHKËPUNIMI NDER-ETNIK NE KONTRABANDE

Ish-ministri I Punëve të Brendshme, Pavle Trajanov është njëri nga ata të cilët në mënyrë direkte e implikojnë Dravelskin në kontrabandën me duhan. Ai thotë se Daravelski ka marë 10,000 – 15,000 dollarë për kamion në kalim të kufirit.¹⁵⁴ Trajanov gjithashtu pohon se tregu i duhanit ndahet me shqiptarët. Nën-kryetari I PDSH, Menduh Thaçi, siç thotë ai, transporton duhanin e importuar, përderisa Daravelski koncentrohet në prodhimin vendor të cigareve falco.¹⁵⁵ Supozohet që përmes kontakteve me kosovarë, serbë dhe malazezë cigaret arrijnë në tregjet e majme të Evropës Perëndimore. Mendohet që Peja të jetë qendra e këtij aktiviteti në Kosovë.

¹⁵² "Krimi i organizuar, korrupsioni dhe tregtia ilegale me armë në UE të zgjeruar", raport i Saferworld, autorë Ian Davis, Chrissie Hirst dhe Bernardo Mariani, dhjetor 2001, f.5.

¹⁵³ Bisedë me nëpunës të OJQ-së e inkuadruar në përkrahjen e grave të cilat janë subjekte të tregtisë ilegale, prill 2002.

¹⁵⁴ Intervistë e ICG-së me Pavle Trajanovin, 24 prill 2002. Para pozitës ministër i punëve të brendshme, Trajanovi ishte përgjegjës për hetime në po atë Ministri. Tani është udhëheqës i partisë politike Lidhja Demokratike, e cila nuk është në aleancë me asnjë parti maqedonase të madhe. Trajanov është njësoj i hapur me pohimet e tija për korrupsionin në kohën e qeverisjes së LSDM-së dhe në kohën e qeverisjes së VMRO-DPMNE-së.

¹⁵⁵ Trajanov, pa ngurrim, pohon se tregtia joligjore me duhan lulëzonte edhe në kohën e Qeverisë paraprake të LSDM-së.

Trajanov gjithashtu bën të ditur se një pjesë e madhe e tregut të përgjithshëm për eksport në Kosovë është në duart e Thaçit. P.sh; ai thotë se në vend që të jetë I rrezikuar nga kompania, siç supozohet, e favorizuar e Daravelskit, kompanitë transportuese të afërta me PDSH kanë përparësi në Maqedoninë Perëndimore.¹⁵⁶

Trajanov, I cili ka qëndrime të ashpra mbi çështjet e shqiptarëve, pritet që të ekzagjerojë përfitimin e tyre nga pasuritë shtetërore. Sidoqoftë, disa shqiptarë gjithashtu kanë ngritur zërin me akuza të tilla. Në një takim zyrtar me ICG dhe duke folur para ' Këshillit të Partive Politike shqiptare' të cilin ai e kryeson, Ali Ahmeti ashpër kritikoi ' liderët tonë politikanë, disa prej të cilëve në pushtet qëndrojnë për t'u pasuruar'.¹⁵⁷ Xhevat Ademi, një figurë opozitare radikale shqiptare Partia De mokratike Kombëtare (PDK), publikisht ka akuzuar koalicionin qeveritar shqiptaro-maqedon për kontrabandë:

Kontrabanda është bërë një problem ndërkombëtar, dhe kjo veprimtari abolutikisht involvon të gjithë politikanët në qeveri. Politikanët tanë gjithashtu janë të përfshirë në veprimtari jashtë vendit. Politikanët tanë shfrytëzuan luftrat e vonshme për veprimtari kriminale (përfshirë) kontrabandën me cigare, derivateve të naftës, trafikimit të bimëve narkotike, prostitucionit të organizuar.¹⁵⁸

Zëra të njhur nga mediat gjithashtu akuzojnë ' koalicionin e korrumpuar' shqiptaro-maqedon, PDSH-VMRO-DPMNE si kundërshtarë të interesave të përbashkëta. Iso Rusi, redaktor I të përjavshmes së pavarur në gjuhën shqipe, *Lobi*, shkruan se e arritura më e madhe e liderëve të PDSH, Arben Xhaferi and Menduh Thachi ishte se me përfaqësimin e 'shqiptarëve në parlament, ata merituan pjesën prej minimum një-të-tretës të ' biznesit qeveritar'... Edhe pse krejtësisht pa maskë, strikturat në pushtet janë mjaft të lidhur me njëri-

¹⁵⁶ Siç u përmend më lart, Daravelski mohon se ka çfarëdo lidhje me kontrabandën ose me shpëditerët ose se është i angazhuar në çfarëdo veprimi qëllimi i të cilit është të vë firmat në pozitë të privilegjuar ose të paprivilegjuar. Intervistë e ICG-së me drejtorin e Administratës Doganore, Daravelskin, 22 korrik 2002.

¹⁵⁷ Takim i ICG-së me Ahmetin dhe Këshillin e partive politike shqiptare, 6 mars 2002.

¹⁵⁸ Ademi në *Fokus*, 19 prill 2002. PDK është haptas kundër Marrëveshjes Kormizë sepse nuk ajo lejon "federalizimin" (p.s. ndarjen etnike) të Maqedonisë. Edhe Kryetari i PDK-së, Kastriot Haxhirexha, edhe Ademi janë vënë në "listën kontrolluese" amerikane për të cilët Uashingtoni mendon se i kontribuojnë jostabilitetit në rajon.

tjetrin në përpjekjet e tyre të vetme, të suksesshme, për t'i mbushur xhepat".¹⁵⁹

Një autor e ka përshtypjen marë nga' maqedonasit e të gjitha klasave që kanë ndjerë se sistemi po çahet nga korrupsioni. Intelektualët shqiptarë dhe maqedonas po ngjashëm kritikojnë partitë politike si 'sulltane', që do të thotë se ato janë kryesisht makina politike të udhëhequra nga shefa të korrumpuar autoritarë të partisë.¹⁶⁰ Nëse perceptimet dhe akuzat e tilla janë të vërteta, koalicioni qeveritar multi-etnik është diçka pak më shumë se një shemë të cilën *Dnevnik* e quan 'për ndarjen e mallit të plaçkitur (gjahut)'.¹⁶¹

Siç përmendet më lartë, një zyrtar i lartë i PDSH thotë për IG se 'ne nuk përfitojmë nga korrupsioni aq sa mendoni ju'.¹⁶² Lideri i PDSH, Arben Xhaferi vazhdimisht e arsyeton përfshirjen e shqiptarëve në korrupsion si " të logjikshme pasi ' sllavët' dominojnë me sektorin shtetëror. Cfarë mund të bëjmë nëse nuk jemi pjesmarrës në të"?¹⁶³ Redaktori Rusi, shkruan se imazhi i përgjithshëm i '[kriminalitetit] Thaçi-PDSH' u konvenon maqedonasve ' që pas tyre ata të fshehin bosat vërtetë të korrumpuar të krimit të organizuar".¹⁶⁴

' Përfitimi' i shqiptarëve nga korrupsioni është me më pak rëndësi se sa duket të jetë i konsiderueshëm dhe rezultat i një pjesëmarrjeje me dëshirë. Arsyetimi Xhaferit- se nëse nuk përfitojmë, atëherët do ta bëjnë këtë të tjerët- është i pranueshëm vetëm nga një kënd: lufta kundër korrupsionit kërkon një përpjekje ndër-enike të përbashkët. Dhe për të pasur sukses në këtë, siç thotë një anëtar i partisë së Ahmetit, BDI, ' ne shqiptarëve na duhet një partner maqedon, i vendosur në këto përpjekje".¹⁶⁵

¹⁵⁹ "Maqedonia një vit pas: Ku shkojmë?", *Lobi*, 25 shkurt 2002. Shumica e akuzave të këtu, si duket, nuk bëjnë dallim mes akuzave të lidhura me fitimin e mjeteve për partinë politike, ose për qëllime personale.

¹⁶⁰ "Mes paqes së keqe dhe luftës së mirë: Njohje dhe mësim nga thuajse-lufta në Maqedoni", Rober Hislope, (dokument në rishqyrtim), f. 16.

¹⁶¹ Citat nga *Dnevnik-u* në dokumentin e Hislopes.

¹⁶² Intervistë e ICG-së me udhëheqësin parlamentar të PDSH-së, Zamir Dikën, 25 qershor 2002. Në takimin e njëjtë Dika dorëzoi një letër, adresuar ICG-së, në të cilën në të vërtetë mohoi akuzat ndaj partisë së tij për korrupsion..

¹⁶³ Intervistë e ICG-së me Arben Xhaferin, 23 janar 2002.

¹⁶⁴ "Tregim për të rriturit", Iso Rusi në *Caravan* (botim i *Kërkim i Bazës së Përbashkët*), korrik 2002. Duhet shënuar se në këtë artikull Iso Rusi përsërit pohimin e vetë se PDSH merr një të tretën nga plaçkës së qeverisë..

¹⁶⁵ Fjalët e anëtares të Këshillit të BDI-së, Dr. Teuta Arifi në konferencë partiake për shtyp në Shkup, 16 korrik 2002.

Politikanët maqedonas të preokupuar me korrupsionin, mbajnë të njëjtin qëndrim: asnjë qeveri nuk mund të ketë sukses në luftën kundër korrupsionit deri atëherë kur partitë shqiptare dhe maqedonase në pushtet të mos jenë të determinuar të veprojnë kështu.

IV. KONSPIRACION APO MARREVESHJE: SI NDIHMOI KORRUPSIONI TË SJELLE MAQEDONINE NE PRAG TE LUFTES

Akuza më kruciale ndaj korrupsionit ndër-etnik është ajo se po kjo mbante përgjegjësinë për konfliktin e vitit 2001. Qytetarët e Maqedonisë, si edhe fqinjët e tyre të gjithë nacionaliteteve, kanë prirje për teori konspirative, dhe disa janë të bindur se pas luftimeve ka qëndruar një 'marrëveshje. Të paktën, një zyrtar i lartë, si kryetari Trajkovski, ka bërë një lidhje direkte mes krimit të organizuar dhe konfliktit, kur thotë se 'njëri nga elementet më kryesore të krizës [në 2001] ishte pikërisht krimi i organizuar në rajon'.¹⁶⁶

Të fillosh me atë se si ndërthehet korrupsioni dhe krimi me konfliktin ndër-etnik është kritike që të bësh përpjekje pasi që strategët nuk janë të gatshëm të ndërmarrin hap të luftojnë korrupsionin, pa arritur të kuptojnë se ka ndikim të madh në stabilitetin.

Ekzistojnë dy disciplina të përgjithshme që lidhin korrupsionin me konfliktin e vitit kaluar:

Shkolla e 'konspiracionit të lartë'. Ata që besojnë në këtë pikëpamje mendojnë se elitat që udhëheqin me korrupsionin, u projektuan që të krijojnë apo së paku, të menaxhojnë me aspektet e konfliktit të vitit të kaluar me qëllim që të arrijnë qëllimet reciproke. Me ndarjen e 'territoreve' për eksploatim, thotë teoria më ekstreme, partitë në pushtet nxitën një luftë me qëllim që të formalizojnë ndarjen e vendit. Motivi afat-shkurtër gjithashtu është i pranishëm: nevoja e suposuar për 'luftime të kontrolluara, për të tërhequr vëmendjen e opinionit nga një skandal eskalues mbi përgjimin, i cili i kërcënohej qeverisë.¹⁶⁷

Skolla për krijimin/dobsimin e kapaciteteve Besimtarët e kësaj pikëpamjeje kundërshtojnë atë se krimi i

organizuar dhe elementet e korruptuara të shtetit kombinohen për *krijimin* e kapaciteteve ekstremiste për resurse humane dhe për dobësimin e kapacitetit dhe legjitimitetit të institucioneve shtetërore. Korruptueshmëria e partitë në pushtet dhe sindikatat kriminale, htotë kjo shkollë, ka inkurajuar ekstremistët që të rrokin armët. Qoftë për arsye ideologjike (të irituar nga se PDSH po pasurohej pa avancuar agjendën shqiptare) ose për arsye thjesht biznesi (patronët e fuqishëm në Kosovë sigurisht të hidhëruar nga Thaçi), ata siç duket e panë veten të përjashtuar nga marrëveshja, mbase [paqesore] ndër-etnike të cilën e shijonin partitë në pushtet. themselves excluded from the cosy cross-ethnic arrangement enjoyed by the ruling parties. Më tej, thotë teoria, trafikimi shtetëror lehtësoi qasjen drejt armëve dhe kontrabandës, e nevojshme për të armatosur dhe financuar një kryengritje. Elementi kontribuues i kësaj teorie

është besimi se mos prania e policisë maqedonase në vendet kritike që u dha kryengritësve rastin që të zhvillojnë bazë dhe të rekrutojnë, ishte pasojë e një strategjie qëllimisht të neglizhuar- siç thuhet që të nderrojnë kërkesën e PDSH për 'hapësirë të lirë për kontrabanduesit'

A. NUK KA KOMPLOT TË MADH

Ish-ministri i Punëve të Brendshme, Pavle Trajanov është në mesin e atyre që duket të besojnë se konflikti i 2001 ishte deri në shkallë të konsiderueshme një veprim i aranzhuar. Ai skicon një skenar ku ndarja e parcelave për korrupsion lehtësoi rëshqet në një ndarje të territorit. Në fact, thotë ai, korrupsioni funksionoi si një 'provë gjenerale' për ndarje etnike formale. Ai thekson si dëshmi presionin e vazhdueshëm që ai (si Ministër i Punëve të Brendshme) thotë të ketë përjetuar nga Georgievski dhe Xhaferi për t'u shtirë si i verbur ndaj rekrutimeve dhe trajnimeve të supozuara të kryengritësve shqiptarë,¹⁶⁸ dhe ndaj, që ky e quan,

¹⁶⁶ Fjalimi i kryetarit Trajkovski në "Klubi Ballkanik", Shkup, 30 mars 2002..

¹⁶⁷ Shikoni raportin e ICG-së për Ballkanin, nr. 209, "Çështja maqedonase: reformë apo rebelim", 5 prill 2001, f. 13-14, në janar...udhëheqësi i partisë më të madhe të opzitet, LSDM-së, akuzoi Qeverinë për përgjimin e bisedave telefonike të mbi 100 personave publike". Akuzat u zgjeruan në përgjim të diplomatëve, kurse mbikëqyrësit u pajtuan se kjo paraqiste kërcënim të madh për qëndrimin e Qeverisë - e tëra kjo deri te momenti i konfliktit..

¹⁶⁸ Trajanovi pohon se i ka qenë thënë të injorojë minieren plot me armë e cila është zbuluar në afërsi të Kumanovës në maj 1999. Ai thotë se operacioni i mbledhjes së armës në Reçicën e Vogël (afër Tetovës), u ndërpre me urdhrin e Kryeministrit në korrik 1999, dhe se, çka është më senzacionale, një shqiptar të cilin "shërbimet kundër-zbuluese të jashtme" e kanë identifikuar aktivist të All-Kaedës, është arrestuar për akuza më të lehta për shkak të presionit të Xhaferit dhe Georgievskit. Trajanovi insiston se ky person ka qenë konkretisht i identifikuar si aktivist i Al-Kaedës, e jo si "terrorist". Intervistë e ICG-së me Pavle Trajanovin, 24 korrik 2002.

shprehisë së qeverisë që të lirojë të dyshuarit 'terroristë' shqiptarë pa ndonjë shpjegim.¹⁶⁹

Nëse kjo është pjesë e dizajnit nadhështor, apo jo, shpërngulja e policisë maqedonase nga zonat shqiptare, veçanërisht nga kanalet kontrabanduese në afërsi të kufirit kosovar, ishte një parakusht I rëndësishëm I planit. Një vëzhgues pat thënë për këtë zhvillim:

Opiniononi është në dijeni... Se arsyeja kryesore pse në vitin 1998, qeveria (pas ardhjes në pushtet të VMRO dhe PDSH) u distanca nga patrullimi I zonës kufitare pas tërheqjes së UNPREDE-it [forcave paqeruajtëse të KB, të cilat u larguan në v. 1999] lejoi trafikimin e trafikimit përmes kufirit...dhe atë me fjalën e Menduh Thaçit në bashkëpunim me elemente, të afërt me udhëheqësinë e VMRO-DPMNE.¹⁷⁰

Qëndrimi nuk-pashë-asgjë të keqe I policisë maqedonase u lejoi fshatrave kontrabanduese, si Tanusha (që gjendet ne kufi, 36 kilometra në veri të Shkupit) që në fakt të jenë "territore të lira". Fshati, jo vetëm që u bë pikë tranzitëse për kontrabandën, por ai shërbente edhe si bazë rekrutimi dhe trajnimi për radikalët shqiptarë, aktivë në Luginën e Preshevës-Serbi jugore.¹⁷¹ Kur ekipi I televizionit maqedonas u mbajt nga gerilët e armatosur, raportet e tyre në vazhdim krijuan senzacion, nxitën reagim të shpejtë të njërive maqedonase dhe ndezën angazhimin e parë serioz.¹⁷²

Megjithatë, neglizhenca e qëllimshme e detyrës së policisë si në Tanushë, nuk është njejtë me konspiracionin aktiv për të filluar luftë. Në të vërtetë, të fillosh me atë se ka pasur një konspiracion të planifikuar mes VMRO-DPMNE and PDSH që të nisë konflikti, dikush do të duhet të tregojë se UCK ishte pjesë I një plani të elaboruar I projektuar së bashku me Arben Xhaferin (dhe përmes tij, me

Kryeministrin Georgievski). Në fakt, supozimet më të bujshme publike tregojnë se ishte e kundërta: PDSH ka dashur të blejë UCK që ajo të ndalë luftimet.

Në një intervistë dhënë të përjavshmes së pavarur *Lobi*, komandanti I njohur I UCK, me nofken 'komandant Hoxha' (Xhezair Shaqiri) deklaroi se nën-kryetari I PDSH, Menduh Thaçi ' e dërgoi emisarin e tij Flamur Ame në Tanushë që të na shpjegojë se na duhet të presim edhe një vit [për ta filluar konfliktin], dhe se nëse ne dëshironim ai do të na transferonte para në bankë ose të na jep paratë në dorë. Thaçi dërgoi edhe emisarë të tjerë, por ne I rrefuzuam. Ne nuk ishim atje për tregti...ne kishim një ideal të sinqertë dhe përfundimi li luftës (me marrëveshjen e Ohrit) tregoi se askush s'mund të na blejë..."¹⁷³

Dy zhvillime të jashtme janë të mjaftueshme të sqarojnë pse Tanusha ishte vendi ku filloi lufta e 2001: së pari, fundi I imponuar I luftës në Preshevë nga ana e NATO-s kishte mbyllur teatrin për kryengritësit shqiptarë, dis prej të cilëve qenë vendosur në fshat; së dyti, marrëveshja e shkurtit 2001 mes Beogradit dhe Shkupit mbi demarkimin e kufirit kosovar, irritoi shqiptarët, duke u dhënë kështu shkak kryengritësve. Këtyre supozimeve analistët u shtojnë edhe arsyen e tretë , më të fshehtë: një hakmarrje e mundshme ndër-shqiptare mes Thaçit dhe grupeve të fuqishme në Kosovë, që thuhet të jenë të acaruar për monopolizimin e tij të tregtisë së provincës deri në një shkallë shumë të lartë. Sipas kësaj rezonance, UCK mund të jetë nxitur nga patronët që duan ta shohin PDSH në vendin e saj.

Teoria e planifikuar madhështore e konspiracionit gjithashtu nuk merr parasysh marrëdhëniet politike mes Xhaferit dhe Ahmetit. Shumë shqiptarë kujtojnë deklaratën publike të ashpër të liderëve të PDSH për UCK, para se të nënshkruhet ' Deklarata e Prizrenit' (një marrëveshje që bashkon UCK dhe liderët kyç të politikës shqiptare, rreth programit për më shumë të drejta brenda Maqedonisë se sa për

¹⁶⁹Mes tyre është Sami Habibi, i akuzuari në sulmin fatal mbi stacionit policor në fshatin Tearc, në janar 2001 dhe Xhavid Hasani, i liruar me kaucion në prill 2000 me këmbim për ushtarët e kidnapuar maqedonas. Hasani në fund ka ikur, kurse kaucioni i tij prej 100.000 dollarë amerikan u transferuan në buxhetin shtetëror, pasi që u akuzua - në mungesë..

¹⁷⁰ "Krizë në Maqedoni", dokument punues, Etnobarometër 6 (Romë, 2002), f. 14.

¹⁷¹ Raporti i ICG-së, }_shtja Maqedonase, citat: "Tanusha u bë më e ngatërruar dhe gërshetuar me Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit (UCPMB)"..

¹⁷² Njësoj.

¹⁷³ "Komandanti i njohur mirë 'Komandant Hoxha': 'Ata të cilët dëshironin të më vrasin turpëroheshin nga vetvetja", *Lobi*, nr.54, 25 shkurt 2002. Hoxha ishte anëtar i Kryeshtabit të Ahmetit. Edhe Hasani i përmendur u lajmërua nga Tanusha. Si duket "sinqeriteti" i ideleve të UÇK-së u vë në provë në Tetovë disa javë më vonë dhe se ajo u tregua joadekuate, shikoni më posht..

ndryshim të kufijve).¹⁷⁴ Dhe, shumë vëzhgues besojnë se përfshirja e jashtëzakonshme e Xhaferit dhe Thaçit nga Ali Ahmeti në takimin inagurues të 'Këshillit të Partive Politike Shqiptare' të tij, afërsisht një vit pas fillimit të konfliktit, ishte një mënyrë e 'amnestimit' të tyre për kundërvëniet ndaj UCK para se ata ta kenë të qartë popullaritetin e saj në radhët e votuesve.

Përkundër dëshmime kundërshtuese, nocioni se ka pasur 'ujdi' për ndarjen e Maqedonisë mbetet.¹⁷⁵ Madje edhe ata të cilët pohojnë se konflikti nuk ishte rezultat i një konspiracie madhështore, besojnë se partitë në pushtet të paktën planifikuan të manipulojnë opinionin publik gjatë asaj periudhe. Disa të tjerë thonë, p.sh; se publikimi i planit për ndarje të vendit, nga ana e Akademisë së Maqedonisë për Shkencë dhe Arte (MANU) u 'rastësisht' u përcoll me konfrontimet më të mëdha të konfliktit- beteja e Haraçinës, fshati vetëm disa kilometra larg Shkupit. Disa kujtohen në reagimin ambivalent të kryeministrit Georgievski ndaj planit të AMSHA (MANU), që ngjante në përkrahje të ndarjes, në kontekst të tensioneve të ngritura në Haraçina.¹⁷⁶

Përsëri, një ekzaminim më i afërt fare pak perkrah teorinë. Ali Ahmeti I ka thënë ICG se okupimi i Haraçinës nga UCK- prej nga teoritikisht kërcënohej Shkupi dhe aeroporti- shërbeu si një refuzim evident i planit të AMSHA-s, i cili do të kishte rezultuar me shpërnguljen e mijëra shqiptarëve nga Shkupi dhe Kumanova.¹⁷⁷ Një këshilltar i lartë qeveritar, i cili qe

aktiv gjatë asaj periudhe, gjithashtu dyshon të ketë pasur marrëveshje mbi cilësinë do aspekt të dramës së Haraçinës.¹⁷⁸

Shembulli më kredibël për një marrëveshje të partisë qeveritare përfshin edhe një tjetër ngjarje të njohur mirë, e ashtu-quajtura ofanziva tek kalaja mesjetare në Tetovë më 25 mars 2001, nga e cila Tetova është në pëllëmb të dorës. E prezantuar para opinionit si një fitore madhështore, një komandant maqedonas i 'Ujqërve' (forcave speciale) u ka thënë hulumtuesve se forcat e tij në të vërtetë nuk patën hasur në rezistencë. Luftëtarë të rinj shqipatërë, të disorientuar janë gjetur nëpër gropa duke u fshehur, të shokuar sepse komandantët e tyre papritmas ishin larguar. Komandanti maqedonas shprehu dyshim që të ketë pasur ndonjë marrëveshje mes partive qeverisëse që ka mund t'i sjellë ushtarët e vet në rrezik të një sulmi të papritur.¹⁷⁹

Me të madhe qarkullon spekulimi se liderët e PDSH, të koordinuar me VMRO-DPMNE, luftëtarëve u ka ofruar një shumë të konsiderueshme parashë që të tërhiqen, kështu që ushtria maqedonase të pretendon 'fitore' (Ofanziva kishte publicitet të madh si e tillë). Një zyrtar i lartë maqedonas thotë se pasi forcat maqedone filluan sulmin e tyre, ky I ka treguar për këtë Xhaferit, i cili qe përgjigjur: "S'ka asgjë këtu për t'u shqetësuar. Tërheqja ka qenë e ujdurur".¹⁸⁰

Fatkeqësisht, Marrëveshja e Ohrit dhe progresi në vazhdim nuk u dhanë fund spekulimeve rreth një konspiracioni ose ndarje të Maqedonisë. Në të vërtetë Ali Ahmeti dy herë I ka thënë ICG se ai ka pranuar oferta për ndarje të vendit- një herë edhe pas nënshkrimit në Ohër.¹⁸¹ Para pak kohësh, marrëveshja del aparente gjatë konfrontimit potencialisht eksploziv më 8 korrik 2002, kur disa qindra maqedonë bllokuan autostradën kryesore Tetovë-Shkup (afër fshatit Zhelinë), siç duket në protestë për fatin e paazgjidhur të 12 maqedonasve të zhdukur që nga konflikti i vitit të kaluar. Protesta shpejt i nxiti shqiptarët të mblidhen

¹⁷⁴Duhet përmendur se Ahmeti nuk u paraqit si udhëheqës publik i UÇK-së para shpërthimit të konfliktit. Ndërmjetës në lidhjen e deklaratës së Prizrenit ishte Robert Frowcik, në cilësi të përfaqësuesit special të OSBE-së. Edhe pse pjesëmarrësit ndërkombëtarë menjëherë hoqën dorë nga Frowciku, Deklarata e Prizrenit ishte vendimtare për procesin paqësor. .

¹⁷⁵ Mendimi për marrëveshje mes VMRO dhe shqiptarët për ndarjen e vendin rrjedh nga periudha e të luftuarit, si dhe nga periudhat fashiste bullgare dhe shqiptare gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore..

¹⁷⁶ Për planin e AMSHA-së Georgievski tha: " Mendoj se idea e tyre rrjedh nga fakti se Maqedonia është në luftë qe tre muaj. Në të vërtetë kemi kryengritje të armatosur të shqiptarëve në Maqedoni, kurse akademikët u përpoqën të gjejnë zgjidhje paqësore për këtë krizë." Por, Kryeministri shtoi se ai nuk e pranon këtë ide. Vërejtjet e cituara në MILS, 31 maj 2001. Shikoni edhe në Raportin e ICG-së për Ballkanin nr. 113, *Maqedonia: mundësia e fundit për paqe, 20 qershor 2002.*

¹⁷⁷ Intervistë e ICG-së me Ali Ahmetin, mars 2002. Ahmeti kundërshtimin e vet rreth ndarjes të Maqedonisë e shndërroi në parim të dukshëm kryesor në platformën e partisë politike të tij, Bashkimi Demokratik për Integrim..

¹⁷⁸ Intervistë e ICG-së me këshilltar të lartë, më 24 korrik 2002..

¹⁷⁹ Intervista me "Ujqit" e udhëheqte Vladimir Millçin, drejtor i Institutit Shoqëria e Hapur më ose rreth 6 prillit 2001..

¹⁸⁰ Intervistë e ICG-së me ish funksionar të lart maqedonas, 24 korrik 2002. Nga ana e tij, komandant Hoxha, i cili është nga Tanusha, insiston në atë se aktiviteti i atjeshëm kryengritës ishte reaksion në vrasjen e fshatarit shqiptar nga ana e forcave maqedonase të sigurimit. Shikoni më posht, në intervistën e cituar me Hoxhën në *Lobi*.

¹⁸¹ Intervista e ICG-së me Ahmetin, dhjetor 2002 dhe mars 2002..

në pyjet përreth, disa prej të cilëve edhe gjuajtën me armë. Tensionet menjëherë u ngjiten në Tetovë, deri në ditën e nesërme kur u hoqën bllokadat në rrugë.

Ka disa indikacione që bllokada të ketë ndodhur jo si protestë e vërtetë por me qëllim të nxitjes së tensioneve dhe të heqjes së vëmendjes nga një raport kritik ndërkombëtar mbi çështjen për personat e zhdukur.¹⁸² Anëtarët e 'Luanëve' të parrespektuar, njësi nën kontroll kjo të Ministrit të Brendshëm dhe zyrtarit të lartë të VMRO-DPMNE, Ljube Boskovski dalloheshin në turmën e njerëzve që kishin dalur në rrugë. Por burime ndërkombëtare gjithashtu thonë se shqiptarët që u paraqitën në afërsi të Zhelinës nuk ishin banorë të fshatit dhe thonë se dy partitë qeveritare, ajo maqedone VMRO dhe partia shqiptare PDSH, ndodh të kenë punuar së bashku për ta ngjallur këtë incident.

Dhe e tërë kjo, pasi që të dhënat për të përmbajtur një konspiracion madhështor janë të pakta, Është e fuqishme të ngjarët se modeli I sjelljes së partive qeveritare – me marrëveshje (veçanërisht sa I përket strategjisë) dhe korrupsioni – dobësuan shtetin dhe hapën shtigje për ekstremistët.

B. KRIMI, KORRUPSIONI DHE KAPACITETI NË RRIJJE PER KONFLIKT: PROBLEM SHQIPTAR APO RAJONAL?

Teoria e krijimit/dobësimit të kapaciteteve e konfliktit në Maqedoni që zhvilluar nga një vëzhgues akademik, Profesori Robert Hislope, I cili kundërshton që forcat simbolike të krimit shqiptar të organizuar dhe korrupsioni I shtetit maqedon në mënyrë të konsiderueshme kontribuan në shpërthimin e konfliktit.¹⁸³ Qëndrimi I Hislope

¹⁸² Ambasadori i NATO-s, Nicholas Biegan, siç thonë, ka deklaruar se bllokimi i rrugës Tetovë-Shkup ka qenë i organizuar mirë dhe se njerëzit nuk janë mbledhur në mënyrë spontane për shkak të personave të zhdukur. Biegan bëri insinuata se mes demonstruesve ka pasur anëtarë të "Luanëve". "Si duket ka pasur njerëz të cilët i njohën anëtarët e "Luanëve", edhe pse duhet kontrolluar a u takojnë ata ende kësaj njësie." Biegan thot: "Është ofenduese për Qeverinë një grup i armatosur të vë bllokadë", *Dnevnik*, 15 korrik 2002. Përshtypje të njëjta kanë edhe gazetarët dhe vëzhguesit tjerë, duke përfshirë edhe personelin e ICG-së i cili ishte në vendin e ngjarjes.

¹⁸³ "Krimi i organizuar në shtetin e dezorganizuar : si i kontriboi korrupsioni miniluftës maqedonase", Robert Hislope, docent i shkencave politike, Union College, Schenectady, New York. *Problemet e postkomunizmit*, vëllim 49, nr. 3, maj/qershor 2002, f.33-41. Për pasqyrë të

është se, në njërin anë, korrupsioni me përmasa të gjera në strukturat e shtetit ndali zhvillimin demokratik, dëmtoi legjimitetin e institucioneve dhe kontribuoi në frustrimin e pakicës shqiptare. Në anën tjetër, me kontrabandën e cigareve, bimëve narkotike dhe trafikime tjera, 'sindikata shqiptare' në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose indirekt (përmes paraardhësës të saj UCKosovës)I furnizoi kryengritësit e UCK me armë.¹⁸⁴

Edhe pse Hislope bën të ditur se ' lidhjet e UCK-së me mafian nuk janë aq të dukshme sa ato të UCKosovës' ai mbetet në atë se direkt ose indirekt ' mafia ishte njëra nga disa burime për finansim dhe furnizim me armë'.¹⁸⁵ Nevojat tjera financiare u përmbushën nga diaspora shqiptare.¹⁸⁶

Komandanti I UCK,Hoxha, përkrah supozimet për blerjen e armëve ndërmjet shqiptarëve, kur thotë se "nuk është e vërtetë [se të I gjithë armatimi ynë ka ardhur nga Kosova]; një numër të madh armësh gjetëm në Maqedoni dhe Serbi Mafia nuk çan kokën për kombe apo religjione. Mafias I intereson vetëm paraja. Nëse ke para, mund të marrësh armë", shpjegon ai.¹⁸⁷

Vërrejta e Hoxhës ndërlidhet me grupin e vogël mbikqyrës për armë- Saferworld (Një botë më e sigurt), ei cili në një studim të bërë para ca kohe, shënon se 'lidhja e pastërt mes krimit të organizuar dhe trafikimit të armëve gjithashtu mund të shtrihen në situata konflikti, ku në mënyrë të pashmangshme

përgjithshme së lidhjes të korrupsionit, krimit të organizuar dhe kontrabandës me armë, shikoni raportin "Krimi i organizuar, korrupsioni dhe kontrabanda ilegale e armës në UE të zgjeruar", Ian Davis, Chrissie Hirst dhe Bernardo Mariani, Saferworld Report, Dhjetor 2001.

¹⁸⁴ Hislope, "Krimi i organizuar", op. cit., f. 1, 14. Gjithashtu shikoni edhe te Tim Judah, *Kosova:Luftë dhe hakmarrje* (New Haven, 2000). Judah tregon (p. 70) se rrënja e komunizmit në Shqipëri në vitin 1991 do të thonte se "tani janë hapur rrugë të mëdha dhe të reja për udhëtimin e drogës të cilat kalojnë nëpër pjesë të Maqedonisë, Kosovës dhe në Serbinë më të ngushtë të banuara me shqiptarë dhe - gjithsesi - nëpër vet Shqipërinë. Rëndësia e kësaj, në kuptimin e çështjes së Kosovës, nuk duhet të mbivlerësohet. Por, megjithatë, është fakt se një shumë e caktuar e "parave të përljera" ndihmoi financimin e kauzës kosovare është më se i dukshëm dhe është fakt të cilin duhet shënuar."

¹⁸⁵ Hislope, "Krimi i organizuar", op. cit., f. 16. Ai mendon (f. 18) se "provat për lidhjen e UÇK-së tani dalin në sipërfaqe".

¹⁸⁶ Njësoj, f. 15. Një funksionar shqiptar i lartë i tregoi ICG-së për mjetet në lartësi prej 2,5 milionë dollarë amerikan të mbledhura nga diaspora në SHBA-të.

¹⁸⁷ Njësoj.

grupet kriminale janë active, duke I furnizuar palët me pajisje luftarake dhe municion të kontrabanduar.¹⁸⁸

Krahas hapjes së rrugëve për trafikim ilegal të armëve, në fund mund të thuhet se çmimi i koluzionit në lidhje me çështjet e policisë ishte shumë i lart. Ata, supozohet, të kenë projektuar ndryshimin në ligjin që ka të bëjë me komunikimin e informative nga të ashtuquajtur "dokumentacione të policisë secrete". Dhe, para zgjedhjeve lokale të vitit 2000, një këshilltar I lartë qeveritar pohon se zyrtarë të lartë të VMRO në qeveri komunikuan një sërë dokumentacionesh që përmbanin emrat e informatorëve shqiptarë, aktivistë të PPD. PDSH I shfrytëzoi këto informata për të diskredituar kandidatët e rivalit të saj kryesor. Sipas qëndrimeve të litarit të lartë, kjo tradhti ndaj burimeve kishte pasoja të rënda për sigurinë pas shpërthimit të konfliktit sepse pak burime shqiptare guxuan të japin informatat, duke vështirësuar kështu punën e Qeverisë për shkak të informacioneve të dobëta të shërbimit të fshehtë.¹⁸⁹ Edhe pse të dy elementet e 'forcave binjake' të Hislope-it- strukturat shtetërore të korruptuara dhe krimi shqiptar I organizuar- janë mjaft të njohura, rëndësia relative e së cilës prej tyre është një element normal lidhës mes shqiptarëve dhe maqedonëve. Ministri i Financave, Nikola Gruevski (maqedon) përsërit shumë maqedonas të cilët insistojnë se 'gjeneratori më I madh I krimi, korrupsionit dhe ekonomisë së zezë në Evropën Jug-lindore është Kosova, dhe kjo rrezikon jo vetëm Maqedoninë, por edhe Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë, dhe përmes tyre, edhe vende të tjera të rajonit'.¹⁹⁰

Por ish-ministri i Financave, Minister Xhevdet Hajredini (shqiptar) mbetet në atë se kontrabanda nuk mund të konsiderohet si profesion që u përket 'vetëm shqiptarëve', "Për të kontrabanduar duhan, bimë narkotike, armë, Maqedonia duhet të jetë e lidhur jo vetëm Kosovën, por edhe me Bullgarinë, Rumaninë dhe vende të tjera. Dhe për një lidhje të tillë, kontrabanduesit duhet të kenë bashkëpunim zyrtar (d.m.th. maqedon)."¹⁹¹

Me fjalë tjera,me që është e qartë se kriminaliteti shqiptar pjesërisht ka finansuar armatimin e kryengritësve, aktorët kriminelë shqiptarë dhe maqedonas, brenda dhe jashtë vendit, kanë bashkëpunuar. In other words, ëhile it is clear that Albanian crime partly funded the rebels' weapons, Macedonian and Albanian criminal actors, inside and outside the state, were cooperating. Ky rrjet I supozuar mes sindikatave kriminele (të të gjitha kombeve) dhe shtetit ndoshta është ajo së cilës I rreferohej kryetari Trajkovski kur I paralajmëroi liderët e Ballkanit mbi kompleksin –shtetëror kriminal:

Të gjitha këto veprimtari kriminale [përfshirë] kontrabandën me cigare, bimë narkotike, njerëz, larje parashë, korrupsion dhe terrorizëm nuk do të ishin të mundshme pa një bashkëpunim të afërt me grupe dhe individë të caktuar Të cilat përfaqësojnë qeveritë e vendeve tona.¹⁹²

¹⁸⁸ Cituar nga raporti i Saferworld-it "Krimi, korrupsioni dhe tregtia ilegale me armë e organizuar", f. 5.

¹⁸⁹ Intervista e ICG-së me këshilltar të lartë të Qeverisë për siguri, 29 korrik 2002.

¹⁹⁰ "Krim, ekonomi e përthitur dhe korrupsioni", ministri Gruevski, e vënë në ëeb faqen e Ministrisë të Financave, 31 mars 2002.

¹⁹¹ Intervistë e ICG-së me Xhevdet Hajredinin, 16 prill 2002.

¹⁹² Fjalimi i kryetarit Trajkovski në "Klubin Balkanik", 30 mars. Edhe shqiptarët i bënë vërejtje fjalimit të Trajkovskit. Udhëheqësi i lart i PDK-së, Xhevat Ademi, deklaroi se "ish pioni i VMRO-DPMNE-së dhe PDSHA-së (trajkovski), Kryetar i tanishëm, i tregoi me gisht ata të cilët janë përzier në aktivitete jopartiake (d.m.th. kriminaeistike)". Intervistë me Xhevat Ademin në "Thaçi dhe Lubço nga Tetova bënë Kolumbi, Fokus, I 19 prill 2002.

V. PERPJEKJET E MJERRA TE QEVERISE KUNDER KORRUPSIONIT

Në të njejtin fjalim, më 30 mars 2002, kryetari Trajkovski bëri aluzion për involvimin e qeverisë në zinxhirët kriminele kur kritikoi 'besimin konfuz se disa pjesë të strukturave kriminele mund të jenë aleatët tonë në arritjen e disa qëllimeve të vogla apo të mëdha, apo më saktë thënë, qëllimeve politike'. Këto vlerësime hasën në interpretime të gjera në Shkup, si kritikë për qeverinë e e Georgievskit.¹⁹³

Pasi që PDSH e Xhaferit gjithashtu ka përjetuar sulme të kombinuara nga partitë rivale shqiptare, mediat vazhdimisht e kanë goditur VMRO-DPMNE me akuza për korrupsion, që nga konferenca ndërkombëtare e donatorëve.¹⁹⁴ Akuzat dhe kundër-akuzat tregojnë se 'korrupsioni', të paktën tani për tani, ka zëvendësuar 'terrorizmin' si një çështje dominante në politikëm maqedonase.

Qeveria është përgjigjur me ndërmarrjen e disa hapave, dhe jo të gjitha janë inkurajuese. Marë anën positive, për qytetarët krijoi një linjë të rregullt ku ata mund t'i parashtrajnë ankesat e tyre për korrupsion. Gjithashtu ka edhe propozime për implementimin e privatizimit të kujdesit primar shëndetësor (sipas marrëveshjes së janarit 2002 që ka të bëjë me Ligjin e Vetë-qeverisjes Lokale).¹⁹⁵

Tri ditë pas fjalimit të Trajkovskit, qeveria kumtoi formimin e një "Komisioni për Ndëshkim të Korrupsionit". Megjithatë, zgjidhja kontraverze e kryetarit të këtij Komisioni është Ministri I Brendshëm, Boskovski, në adresë të së cilit kanë

¹⁹³ Kryeministri, i cili ishte mes publikut, gjoja gjatë fjalimit ka treguar shqetësim të dukshëm.

¹⁹⁴ Me rastin e konferencës dhuruese në Bruksel më 12 mars 2002, kryetari i ICG-së, Gareth Evans, botoi një artikull në *Wall Street Journal* (botimi evropiane), të titulluar "Pastroni Maqedoninë". ICG botoi edhe kumtesë për mediat me apel dhuruesve: "Financoni paqen në Maqedoni, e jo korrupsionin". Sipas revistës *Forum*, "Nuk ka porosi më të përmbledhur nga titulli [kumtesa e ICG-së] dërguar bashkësisë ndërkombëtare për atë që në Maqedoni me vite të tëra është "sekret publik" - po fundosemi në korrupsion. ICG luante rolin e fëmijës në "Robot e reja të mbretit", kryeartikul: "Bëni grevë kundër korrupsionit!" *Forum*, 28 mars 2002.

¹⁹⁵ Intervistë e ICG-së me ministrin e financave, Gruevskin, 16 prill 2002. Për ngjarjet tjera pozitive shikoni në artikullin e cituar të Gruevskit, "Krim, ekonomi e përhitur dhe korrupsion".

arritur akuza për korrupsion.¹⁹⁶ Si sinjalizim se komisioni nuk do ta sulmonte ashpër korrupsionin vendor, qeveria kumtoi se veprimi I saj I parë do të ishte ekzaminimi 'I shfrytëzimit të ndihmës humanitare gjatë krizës kosovare' Kjo ishte një shuplakë për Trajkovskin, I cili në vitin 1999 kishte rolin kyç në koordinimin e relacioneve me komunitetin ndërkombëtar për ndihmë. Po kështu, qeveria aktivizoi procedura kriminale kundër drejtorëve të disa bizneseve të mëdha, përfshirë edhe Fershped, Birrarinë-Shkup, Alkaloid, Rubin-Karmin dhe TV A1, sepse secila nga këto ose kanë marë pozicion kundërshtar ndaj qeverisë ose nga që besohet se kanë rrefuzuar të 'shpagohen'.¹⁹⁷

Qeveria e ka për obligim që të hulumtojë akuzat e rënda, dhe pa dyshim, të paktën, disa prej tyre.¹⁹⁸ Problemi më shumë qëndron në atë se veprimet e para të Komisionit për Ndëshkim të Korrupsionit të vë në dukje që ka motive politike transparente. Fershped, për shembull, ka lidhje me të përditshmen *Vest*, gazetë kjo që para pak kohësh publikoi një tregim për 'pallatin' që flitet të ndërtohen në emër të kumatës së Kryeministrit.¹⁹⁹ Nuk besohet që aksionet e tilla mund të arrijnë të rrisin konfidencën publike ndaj institucioneve.

¹⁹⁶ Në vjeshtë të vitit 2001 Boshkoski u akuzua publikisht se ka marrë 1 milion dollarë amerikan në një vepër jologjore me orizin. Ai u përgjegj me një mohim të pazakonshëm: "Nuk më interesojnë milion dollarë. Unë fitoj aq para çdo ditë në mënyrë të ndryshme." *Dnevnik*, 2 tetor 2001. Boshkovski ICG-së i tha "se nëse gjenden çfarëdo prova për atë se jam i korruptuar, unë do të djeg veten në shehsin e qytetit siç bëri Jan Pallah në Çekoslovakia". Intervistë e ICG-së me Lube Boshkovskin, 22 mars 2002.

¹⁹⁷ "Procedurë penale kundër drejtorave të ndërmarrjeve më të forta maqedonase", *Dnevnik*, 2 prill 2002, dhe "Sipas MPB-së, Fershped ka larë milionë dollarë [amerikan]", *Dnevnik*, 17 prill 2002. Në artikullin e dytë thuhet se MPB-ja konsideron se pesë ndërmarrje të mëdha maqedonase kanë transferuar në bankat e huaja 300 milionë dollarë amerikan. Për Fershpedin pohohet se i ka transferuar para filialës së saj, Fer-Agjent-it, e cila ka filialat e veta në Gjermani dhe Greqi.

¹⁹⁸ Mes atyre të cilët bëjnë insinuata për drejtorin e televizionit A1, për shembull, është edhe larja e parave, dhe, për ata qeveria nuk është burimi i vetëm i tyre.

¹⁹⁹ "Kryetari i komunës së Shkupit thot se pallati misterioz i kumatës së Kryeministrit është jologjore", *Vest*, 20 mars 2002.

VI. SI NDIHMON KOMUNITETIT NDËRKOMBËTAR QË KORRUPSIONI TË JETË I MUNDSHËM

Ndërkombëtarë të lartë në Maqedoni tregojnë, disa herë edhe pohojnë, një agjitacion primitiv mbi çështjen e korrupsionit. Njëri thotë ' ne vallëzojmë rreth problemit'. Një zyrtar tjetër thotë ' Ambasadorët (evropianë) nuk duan të mërren me të'.²⁰⁰

Të pyetur nëse kanë ndonjë koment, zyrtarët ndërkombëtarë tentojnë të mos dramatizojnë korrupsionin në Maqedoni, kur thonë se është karakteristikë e vendeve në tranzicion. Kjo inkurajon qeverinë që ta racionalizojë problemin. Për shembull, pas deklaratës së ICG në kohën e konferencës së donatorëve, revista mujore, *Macedonian Business*, qëndronte në atë se ' ky nuk është vetëm problem i maqedonisë'... ishte ky qëndrimi unanim, gjatë konferencës në Bruksel, I kryeministrit Georgievski dhe Drejtorit të Bankës Botërore në vend, njëkohësisht Koordinator Rajonal për Evropën jug-lindore, Christian Poortman.²⁰¹ Ministri i Financave Gruevski, dha një vlerësim të ngjashëm si dëshmi që " ne mund të mos jemi engjuj, por kjo s'do të thotë që dikush tjetër është I pafajshëm".²⁰²

Në fakt, siç është përshkruar edhe më lartë, imazhi I Maqedonisë duket të ketë të jetë zbehur, përderisa I vendeve fqinje, përfshirë edhe Shqipërinë, të jetë përmirësuar.²⁰³ Mirëpo, krahasimi me indekset mbi

korrupsionin në vendet tjera në tranzicion e injoron qëllimin. Vetëm disa vende të tjera po luftojnë të ruajnë pikërisht aftësinë e shtetit duke përdorur korrupsionin si fundament për 'menaxhimin' e marrëdhënieve ndëretnik. Në një shtet esencialisht të mjerrë si Maqedonia, me një ekonomi relativisht të vogël, mega-korrupsioni në mënyrë të konsiderueshme bëhet shkak për një kaos të madh. Duke minimizuar seriozitetin e korrupsionit në Maqedoni, është një gabim që vetëm mund inkurajojë qeverinë për të prolonguar reformat.

Një shembull se si komuniteti ndërkombëtar i shmangët problemit është premtimin që ka dhënë për të imponuar një kontroll të ashpër nbi fondet e donatorëve. Është mirë që Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe organizata tjera donatore po ndërmarrin hapa që të sigurojnë se ndihma shkon për qëllimet e saj immediate. Por ndihma për projekte formon më pak se gjysmën e zotimive të përgjithshme nga ana e donatorëve, për të cilat u angazhuan në mars të 2002 në Bruksel. Pra, mbi gjysmën e një-të katërtës miliardë dollarë nga shuma e përgjithshme e premtuar (165 million dollarë amerikanë) ishte për një infuzion direct për thesarin e vendit si asistencë për balancim të pagesave

Ministri i Financave, Gruevski, me përkrahje të zyrtarëve ndërkombëtarë, kundërshton atë se defiqiti në balancim e pagesave rezultoi nga kriza e 2001: " Me shfrytëzimin e rezervave të saj të valutave të huaja dhe rezervën e buxhetit... [qeverisë] iu desh që menjëherë të blejë një sasi më të madhe armësh, municion dhe pajisje tjera ushtarake që të mund të mbrohet nga sulmet²⁰⁴ Madje edhe në sektorin e mbrojtjes, sidoqoftë, korrupsioni drejtëpërsëdrejti I ngriste shpenzimet dhe rriti defiqitin. Në një skandal që bëri bujë të madhe, ish-ministri I Mbrojtjes, Ljuban Paunovski akuzohet të ketë vjelur deri në 6.5 milionë dollarë në blerje për nevoja të ushtrisë nga firma, pronarë të së cilës janë vjerri dhe kunati I tij.²⁰⁵

²⁰⁰ Banka Botërore është mjaft sinqerte për të pranuar hutinë e vet. "Edhe pse Banka gjithmonë është kujdesur për integritetin e operacioneve të saja, ajo nuk fliste në mënyrë kategorike për "korrupsionin" si të tillë...para mesit të viteve të 90-ta. Ajo çka neve sot na duket si një çështje e qartë, atëherë konsiderohej tepër e ndieshme politikisht, ose, thjesht, për tepër politike..." Politika e këtillë vazhdoi deri - 1996, kur kryetari James Wolfensohn angazhoi Bankën në luftën kundër "kancerit të korrupsionit". Nga web faqja e Bankës Botërore, "T'u ndihmohet vendeve të mposhtin korrupsionin/roli zhvillimor i Bankës Botërore, përpjekje të Bankës Botërore".

²⁰¹ "Maqedonia t'i shpall luftë korrupsionit", *Javore afariste maqedonase(Makedonski deloven nedelnik)*, mars 2002, nr. 5, viti I, f. 4. Portman nga Banka Botërore para ICG-së përsëriti qasjen se korrupsioni është problem në shumë shtete, Intervistë më 27 qershor 2002.

²⁰² Ministri i financave, Nikolla Gruevski, "Krim, ekonomi e përhitur dhe korrupsion", është vënë në web faqen e Ministrisë të Financave, 31 mars, 2002.

²⁰³ Për shembull, shikoni fusnotën 33 më lart.

²⁰⁴ E shkruar e ministrit të financave në *Buletin*, 12/2001, f.3. Përveç për furnizime ushtarake, Qeveria duhej të shpenzojë më shumë mjete edhe për thirrjen e rezervistëve, së të atyre të policisë, ashtu edhe të ushtrisë.

²⁰⁵ Shikoni raportet e mediave prej 23-25 prill 2001, mes të cilave edhe "Qetësi para stuhisë në Ministrinë e Mbrojtjes" *Dnevnik*, 25 prill 2001. Z. Paunovski në fund dha dorëheqje dhe tani pret aktakuzën. Ai dha disa deklarata në të cilat bënte insinuata se kur do të fillojë procedura ai do t'i zbulojë atë "të cilën ai e di" për transaksionet tjera të korruptuara. "Paunovski tha se do t'i tregojë emrat, historijatin dhe rolin e disa funksionarëve partiak të cilët, sipas tij, janë krijuesit

Për shkak se paraja është si kërpudhat, ruajtja e këtij deficieti është dhe do të mbetet një fond për shumicën e operacioneve qeveritare.²⁰⁶ Me fjalë tjera, fondet ndërkombëtare, I ndihmon Maqedonisë që t'i mbulojë boshllëqet e krijuara nga korrupsioni, si praktikë e ushtruar në mbarë qeverinë.²⁰⁷ Dikush llogarit se deri në 40 për qind të deficitit mund që direct t'i atribuohet korrupsionit- përjashtuar këtu rolin e korrupsionit në paksimin e investimeve dhe në rritjen e shpenzimeve. Një tjetër llogari tregon se korrupsioni arrin vlerën 3 për qind të GDP.²⁰⁸

Është një lloj gabimi që të trajtosh Maqedoninë si një vend "normal" në tranzicion kur kemi të bëjmë me korrupsionin. Është krejt diçka tjetër që të përkrahësh moefikasitetin e qeverisë dhe të mos kërkosh reforma. Duke e bërë këtë, komuniteti ndërkombëtar aksidentalisht kontribuon në shprehinë e korrupsionit në Maqedoni- duke I sinjalizuar ata në pushtet se praktika "një biznes I zakonshëm" do të vazhdojë të tolerohet edhe më tej. Atëherë, nuk është për çudi që shumë maqedonas nuk e shohin konferencën e donatorëve të marsit 2002 si një shprehje e angazhimit ndërkombëtar për stabilitetin e vendit por më shumë si një as a metodë afat-shkurtër për të arritur bashkëpunim.

Diplomatë dhe organizata si OSBE, përpiqen të besojnë se procesi delikat I rikthimit të policisë, I cili në përmasë të madhe mvaret nga bashkëpunimi I qeverisë, do të rrezikohej nëse ata ndrisin zërin e tyre

kundër korrupsionit.²⁰⁹ Të flasësh për lidhjen e qeverisë me korrupsionin, sidoqoftë jo gjithmonë do të thotë konfrontim.²¹⁰ Nuk ka arsye, p.sh., që të besohet se insistimi për një legjislacion mbi korrupsionin do të ndërhynte në bashkupinimin mbi një legjislacion të ri. Qeverisë thjesht I mungon niveli I përkrahjes vendore dhe ndërkombëtare që t'u shmanget angazhimeve të cilat I nënshkroi në Ohër.

Duke marë parasysh kushtet e jurisdikscionit, legjislacioni më I rekomanduar as edhe nuk paraqet ndonjë imediat për praktikat e korrupsionit në qeveri. Shikuar në kritikën që qeveria pranon përmes mediave, qeveria madje mund të mirëpresë angazhimin më të madh të ndërkombëtarëve mbi legjislacionin për korrupsion, nëse vetëm I jepet asaj shansë që para zgjedhjeve të përmirësojë reputacionin e vet mbi këtë problem.

Megjithatë, duke pasur në një anë maqedonasit që akoma me të madhe besojnë se M. e Ohrit ishte një rrugë-një-kahshe e kompromiseve, është e qartë se procesit të implementimit I mungojnë komponentat "integruese"- elementet që mund t'I çojnë shqiptarët dhe maqedonët drejt një qëllimi të përbashkët. Lufta kundër korrupsionit mund të jetë një element I tillë, duke stimuluar implementimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe jo duke bllokuar atë. Po sikur elitat qeveritare bashkëpunojnë nëpër linjat nacionale ose etnike për të plaçkitur pasuritë shtetërore, ashtu edhe aktorët tashmë të njohur të shoqërisë civile- ata që

kryesor të skandalit në Ministrinë e Mbrojtjes", *Utrinski Vesnik*, 20 qershor 2001.

²⁰⁶ Bisedat me FMN-ë dështuan në qershor 2002, me çka u zvogëluar ndihma e mëtutjeshme dhuruere për deficitin. Por, veç më janë paguar 90 milionë dollarë amerikan. Burimet ndërkombëtare thonë se bisedat me FMN dështuan për shkak të arsyeve të ndryshme, mes të cilëve është edhe vendimi i Qeverisë të vazhdojë me pagesën e mjeteve - pas vitit zgjedhor - për kursimtarët e bankave kursimoreve piramidale të cilat dështuan, si dhe pajtueshmëri të Qeverisë me kërkesën e Sindikatës për rritje të përgjithshme të rrogave të nëpunësve shtetëror. Ata tregojnë se edhe e kaluara e keqe e Qeverisë sa i përket korrupsionit ishte një faktor i cili i kontribuoi mospjesëmarrjes së bisedave, sepse pjesëmarrësit i nxitte t'i shikojnë me mosbesim parashikimet dhe premtimet maqedonase.

²⁰⁷ Kur ICG intervistoi Ministrin e financave, ai pohoi se korrupsioni paraqet barë për ekonominë dhe deficitin e buxhetit shtetëror. Intervistë me ministrin e financave, Gruevskin, 16 prill, 2002. .

²⁰⁸ "Korrupsioni 'han' 200 milionë dollarë në vjet", *Utrinski Vesnik*, 23 prill 2002. *Utrinski Vesnik* citon të dhëna nga studimi i financuar nga USAID-i.

²⁰⁹ Më 8 prill 2002 shefi i misionit të OSBE-së në Maqedoni iu përgjigj apelit me shkrim të ICG-së (në lidhje me Ligjin kundër korrupsionit) dhe premtoi se do t'i japë përkrahje të vazhdueshme "Strategjisë kundër korrupsionit" të cilën duhet ta realizojnë aktivistët e vendit.

²¹⁰ Lëkundshmëria kryesore, bile edhe te përfaqësuesit ndërkombëtarë, t'i bënë ballë akuzimeve për korrupsion është kryesisht përfytyrimi i gabueshëm për "provë". "provë" është koncept juridik. Por, bile edhe nëpër gjyqet, standardet për prova ndryshojnë. Por në SHBA "prova" lëviz nga ajo më e rrepta "jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm" në lëndët kritike deri te "superioriteti i provave" ose "më shumë e besueshme se sa jo" te disa lëndë qytetare dhe administrative. Si duket në këtë kontekst standardet për "provën" do të kishin qenë bile edhe më të ulëta. Bashkësia ndërkombëtare - Banka Botërore, FMN, UB - nuk janë "gjyqëtarë" të cilët përpiqen të hedhin ndokënd në burg. Ata janë palët e interesuara të cilat kanë të drejtë t'i nxisin çështjet atje ku akuzat janë të besueshme dhe serioze. Do të duhej të ekzistojë ndonjë lidhje logjike mes fakteve të përmendura dhe rolit të bashkësisë ndërkombëtare. Por, duke marrë parasysh interesin dominues të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin e qeverisjes së të drejtës në Maqedoni, realizimi i këtij standardi do të duhej të jetë i lehtë.

mund të ndihmojnë në nxitjen e krijimit të lidhjeve të nevojshme ndër-etnike për vënien në praktikë të Marrëveshjes Kornizë- mund të aktivizohen nëpër linjat ndër-etnike për të mobilizuar qytetarët në luftë kundër korrupsionit.²¹¹ P.sh; pa iniciativën e komunitetit ndërkombëtar, " Koalicioni Pa-Korrupsion", ka zgjedhur ish-Ministrin e Financave, Xhevdet Hajredinin (shqiptar) për kryetar të bordit të vet koordinativ.

Thënë shkurt, diplomatët ekzagjerojnë rrezikun se denoncimit të qeverisë për korrupsion edhe pse i kuptojnë përfitimet potenciale për ta bërë atë.

A. TESTIMI I ANGAZHIMEVE NDËRKOMBËTARE: LIGJI ANTI- KORRUPSION

Sipas Transparency Macedonia dhe revistës *Forum*, Ligji Anti-korrupsion, të cilin parlamenti e miratoi në prill të 2002, duhet të përbëjë esencën e "strategjisë anti-korrupsion".²¹² Mes të tjerave, ky krijon një 'Komision Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit' me obligime të mëdha, përfshirë edhe aprovimin dhe implementimin e një programi shtetëror për të luftuar korrupsionin, madje edhe fillimin e procedurave ndaj zyrtarëve të korrumpuar. Fatkeqësisht, siç thekson Transparency Macedonia, ligji ka shumë lëshime, përfshirë edhe vonesën 6 mujore para se Komisioni Anti-korrupsion të fillojë punën e vet.²¹³

²¹¹ Potenciali që me përpjekjet kundër korrupsionit të tejkalohen ndarrjet etnike mbështetet edhe me bisedat e paradokohshme në lidhje me Ligjin për Vetëqeverisje Vendore. Disa kryetar maqedonas të komunave, mes të cilëve edhe kryetari i Lidhjes së Kryetarëve të Komunave (dhe anëtar i partisë sunduese VMRO-DPMNE-së), u largua nga pozicioni i Qeverisë së tyre dhe iu bashkangjiti shqiptarëve me kërkesën për maksimizimin e shkallës së kompetencave të cilat barten mbi komunat.

²¹² Ekipi i *Forum-it* në bashkëpunim me Transparencë - Maqedoni dhe Sektorin për hulumtimetë *Forum-it*, "Grevë kundër korrupsionit!", *Forum*, 28 mars 2002.

²¹³ Transparencë-Maqedoni dha rekomandime për përmirësimin e Ligjit derisa ai ende ishte në procedurën parlamentare, mes së cilave edhe atë që Komisioni për kundërkorrupsion të jetë i balancuar dhe i liruar nga ndikimet politike, shikoni "Proklamim publik - rekomandime", Transparency International Macedonia. Në letrat e dërguara më 3 prill 2002 ambasadorëve të gjashtë shteteve të mëdha dhe dy funksionarë kyç ndërkombëtarë ICG përkrahu amendamentet e propozuara të Transparencës s Maqedoni .

Edhe nëse pëson ndryshime të pranueshme, Ligji Anti-korrupsion nuk do të kishte efektin që të përmirësojë gjithçka, as edhe Komisioni nuk do të fillonte së shpejti spastrimin e zyrtarëve të korrumpuar. Megjithatë, në zhargonin eluftës kundër korrupsionit, ligji, së paku, është një "pikë-nisje" e pranueshme: the laë is at least an appropriate "entry point": d.m.th., " një vend ku qëllimet janë të realizueshme dhe rezultatet konkrete mund të arrihen përbrenda një kohe të caktuar, dhe kjo sjall në përkrahjen e reformave të reja."²¹⁴ Zhvillimi dhe implementimi I 'strategjisë nacionale anti-korrupsion' aq shumë të diskutuar, do të jetë një nga obligimet kryesore të Komisionit.²¹⁵ Miratimi I legjislacionit, si një nga mënyrat e projektuara për ta luftuar korrupsionin, është ndër më të thjeshtat dhe më pak konfrontuese. Me këtë përfitim të vogël dhe të arritshëm, (sipas Bankës Botërore) është krijuar një "forcë esenciale e cila ndikon në opinionin publik dhe atë zyrtar"

Një presion inkurrajuese nga komuniteti ndërkombëtar për një ligj më të përpunuar anti-korrupsion në prill të 2002, sidoqoftë do të t'i kishte dhënë më shumë përmbytje angazhimit të Komisionerit të UE për marrëdhënie me Jashtë, Christopher Patten, ' që " në ish-Republikën jugosllave të Jugosllavisë dhe, në të vërtetë, në mbarë rajonin, të vërrejë përpjekje dhe vendosmëri për të shkukur nga rrënjët korrupsionin. Korrupsioni helmon jetën politike dhe ekonomike në mabrë rajonin: duhet që të preket me vendosmëri të plotë dhe të parrezervë".²¹⁶ Sidoqoftë, më 17 prill 2002, – ditën kur Patten (bashkë me Javier Solanën dhe Alain Le Roy) u takuan me Kryeministrin Georgievski dhe Ministrin e Jashtëm Casule – parlamenti rrefuzoi amendamentet që do të përmirësonin Ligjin anti-korrupsion.²¹⁷ Një ditë më pas, unanimisht miratoi legjislacionin me plot lëshime.²¹⁸

²¹⁴ "Antikorrupsioni në tranzicion - Kontribut debatit politik", Banka Botërore, f. 30, © 2000, e v-në në web faqen e Bankës Botërore.

²¹⁵ Projektligj, Kapitulli pesë - Komision shtetëror për pengimin e korrupsionit, neni 49 (1) rreshta 1 dhe 2.

²¹⁶ Fjalimi i Chris Patten-it para Forumit Demokratik të Ballkanit Perëndimor, Selanik, 11 prill 2002.

²¹⁷ Me njërin nga amendamentet (në pajtim me rekomandimet e Transparencës Maqedoni) - në momentin kritik - Komisioni kundër korrupsion do të fillonte me punë në afat prej 30 ditë. Në vend të kësaj, sipas dëshirës së Qeverisë, Komisioni nuk do të fillojë me punë para se të kalojnë gjashtë muaj nga miratimi - shumë pas zgjedhjeve.

²¹⁸ Në debatin para miratimit të Ligjit, udhëheqësi i PLD-së, petar Goshev, deklaroi: "Pohoj se Kryeministri është i

Komisari Patten mund ta ketë hudhur dorëzën, por komunitetit ndërkombëtar në Maqedoni ende I ka mbetur që ta ngrisë/zgjedhë atë. Sipas Delegacionit të Komisionit Evropian në Shkup, këta nuk kanë ngritur çështjen e ligjit në qeveri, dhe në vend të kësaj kanë preferuar të studiojnë draftin edhe më tej. As Delegacioni I këtij Komisioni nuk beson të ketë një platformë politike për ta shqyrtuar korrupsionin në qeveri, duke preferuar kështu finansimin e projekteve.²¹⁹ Po kështu edhe Këshilli I Evropës, ka preferuar që ta rishqyrtojë draftin dhe situatën e korrupsionit përmes krahut të vet GRECO (Grupi I Shteteve kundër Korrupsionit) dhe jo të merret me amandamentet. Ambasadorët e UE ligjin e kanë diskutuar në pika të shkurtra me Komisionin e Delegacionit.²²⁰ Përfaqësuesi Special I UE, LeRoy, I cili është krejtësisht I angazhuar me ligjet e Ohrit dhe pasi kështu mendon që të tjerët duhet të iniciojnë luftën kundër korrupsionit, draftin e ka diskutuar me qeverinë, por nuk deshë që të insistojë për ndryshimet e propozuara nga Transparency Macedonia dhe opozita.²²¹

Ambasada e Amerikës gjithashtu e ka ngritur problemin me zyrtarë.²²² Ambasadori Butler disa herë i është referuar publikisht nevojës për ta luftuar korrupsionin, përfshirë këtu edhe apelin më të fundit publik "që nëse qeveria nuk u shërben, shfrytëzoni zgjedhjet e ardhshme të për të kërkuar ndryshime".²²³

korrumpuar dhe e provokoj të më nxjerrë para gjyqit që të mund ta dëshmoj këtë." Përkthim nga raportet televizive të debatit parlamentar më 18 prill 2002. Goshevi jep deklarata të njëjta ose të ngjajshme edhe jasht Asamblesë, mes së cilëve edhe shtypit edhe në intervistën me ICG-në, ku imuniteti nuk e mbron. Për shembull shikoni "tribuna e PLD-së në Ohër", *Dnevnik*, 25 shkurt 2002 dhe "Petar Goshev: 'Bugarofili Georgievski dhe VMRO-DPMNE-ja e tij politikisht veç më janë të ndjerë'", *Dnevnik*, 17 qershor 2002.

²¹⁹ Intervistë e ICG-së me personelin e Delegacionit të KE-së 2002.

²²⁰ Intervistë e ICG-së me nëpunës të Delegacionit të KE-së, 16.04.2002. Nëpunës tjerë deklarojnë se ambasadorët e UE-së nuk kanë dëshirë të madhe të veprojnë në lidhje me çështjen e korrupsionit.

²²¹ Intervistë e ICG-së me të dërguarin e UE -së Alain LeRoy, 13.04.2002.

²²² Biseda të ICG-së me ambasadën e SHBA-ve.

²²³ "Nëse Qeveria nuk punon për ju, zgjedhjet janë rast për ndryshime", *Utrinski Vesnik*, 27-29.04.2002. Z. Butler theksoi se "punojmë me Transparency Macedonia, Këshillin e Evropës dhe me OECD-në për fuqizimin e luftës së Maqedonisë kundër korrupsionit".

Transparency Macedonia, Instituti për Shoqëri të Hapur²²⁴ dhe të tjerë kanë marë iniciativë që të zhvillojnë një 'Koalicion Të-pakorrumpuar' I përbërë nga aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile si mjet për të konvertuar averzionin e lartë publik në aktivitet produktiv. Zyrtarë të Ambasadës amerikane dhe zyrtarë të tjerë me përkrahje të SHBA-ve, dhe OSBE, kanë ofruar përkrahjen e tyre, ashtu si edhe Delegacioni I Komisionit Evropian, I cili ka pranuar të finansojë përpjekjet e Transparency Macedonia për projektimin e një 'strategjie' nacionale 'anti-korrupsion'. Koalicioni ka për qëllim të mobilizojë përkrahjen ndaj legjislacionit, sensibilizimit publik dhe përkrahjes publike. Aq sa mund të premton ky project, ai mund të jetë I suksesshëm vetëm nëse harmonizohet nga një përpjekje e fuqishme ndërkombëtare e llojit të propozuar nga Komisioneri Patten.

B. HUMNERA E UDHEHEQESISE NDERKOMBETARE

Prej ambasadave të mëdha në Shkup, vetëm ajo e Hollandës dhe e SHBA-ve ndodh të raportojnë programe aktive mbi korrupsionin si problem.²²⁵ USAID ka një numër programesh për reforma bankare dhe kontabiliteti, dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e Ligjit për Parandalim të Larjes së Parave (dhe ligje të tjera që prekin sektorin financiar). Departamenti amerikan I Thesarit ka mbajtur trajnime speciale mbi problemin e larjes së parave. Një zyrtar I lartë I USAID para pak kohësh tha se agjencioni konsideron që programi të nxit "vetëdijen etike dhe vlerat morale" si një mjet tjetër për ta luftuar korrupsionin. Një zyrtar tjetër thotë që, sidoqoftë, se programet USAID kryesisht janë dizajnuar që të parandalojnë mundësitë për korrupsion, dhe jo ta dënojnë atë. Qeveria britanike po finason 'Studimin mbi Integritetin Kombëtar' të Transparency Macedonia, paraprijës në zhvillimin e 'Strategjisë Anti-korrupsion'.

Delegacioni I Komisionit Evropian do të finansojë projektimin e 'Strategjisë Anti-korrupsion'. 'Dokumentacioni I Strategjisë për Vending' I Komisionit, për Maqedoninë, vetëm pak përmend korrupsionin, dhe në kontrast të kërkesës së Komisionerit Patten për një 'përpjekje me të vërtetë të

²²⁴ Drejtori i ISHH, Vladimir Millçin, veçmas, lansoi lëvizjen multietnike për luftë kundër korrupsionit të quajtur "Mjaft është".

²²⁵ Pyetje të ICG-së te ambasadorët në Shkup.

vendosur' e heq atë nga lista e sfidave kryesore me të cilat balafaqohet vendi.²²⁶ Delegacioni përgatit aktivitete për finansimin e partive politike, privatizimin dhe influencën politike në jurisprudencë, por akoma nuk jep informata për programe specifike.²²⁷

Hollanda finanson dy programe të Bankës Botërore mbi transparencën në administratën publike dhe privatizimet.²²⁸ Sidoqoftë, përkundër suksesit të treguar në privatizimin e punët e çelikut në Maqedoni, të dy programet, (FESAL dhe PSMAC), kanë kufizime.²²⁹ FESAL (Kredi për Regullimin e Sektorit të Biznesit) fillimisht ka për qëllim të "zgjidhë" çështjen (të mbyllë apo privatizojë) ndërmarrjet e mëdha që janë në humbje dhe të cilat datojnë nga periudha socialiste. Në parim, kjo I jep Bankës qëndrimin që të shikojë se rezolucioni është transparent. Në praktikë, Banka nuk lejohet të marrë pjesë në vlerësimin e tenderëve, kështu që " të brendshmit" ende mund të bëjnë ujdi të përshtatshme. Mes tjerash, sipas stafi të Bankës, qindra sipërmarrje janë tërësisht jashtë dhe prej këtu del se, janë jashtë mbikqyrjes së Bankës.

PSMAC është kryesisht një projekt " për krijimin e kapaciteteve", p.sh; që të imponojë kufizime të buxhetit për ministrinë.²³⁰ Banka gjithashtu mban një Kredi për Lehtësim të Tregtisë dhe Financave që të harmonizojë procedurat e doganës. Kjo më së shumti ndihmon në përmirësimin e teknologjisë informative dhe centralit fizik/ mekanikën, në trajnim dhe në harmonizimin e Ligjit të Doganës. Stafi I Bankës e kupton se këto përpjekje për përmirësimin e "kapacitetit administrativ" nuk u përgjigjen problemeve të mëdha të Shërbimit Doganor.

²²⁶ Në f. 3 strategjia thotë butë se "rritja e efikasitetit të vendit" është një nga sfidat më të mëdha. Fjala "korrupsion" përmendet udhës, katër herë. Programi CARDS për ndihmë për Maqedoninë, 2002 deri 2006.

²²⁷ Intervista e ICG-së me KE-në, 16 prill 2002.

²²⁸ Qeveria holandeze ka relacion të posaçëm me Maqedoninë për punë financiare të cilat i paraqet (bashkë me shtetet tjera ballkanike) në Bankën Botërore dhe në FMN-në. Gjithashtu, Holanda ndërmerr komandën e misionit të NATO-s më 26 qershor 2002, kurse përfaqësuesi i tanishëm i NATO-s është holandez.

²²⁹ Intervistë e ICG-së me nëpunës të lartë nga personeli i Bankës Botërore, 19 prill 2002 dhe më parë.

²³⁰ Personeli i Bankës thot se PSMAC gjithashtu mund të jetë nxitje për legjislationin. Ata pohojnë se legjislationi i paradokohshëm për furnizim publik është miratuar sepse ka qenë kusht për PSMAC-në. Intervistë me personelin e Bankës në Uashington, 27 qershor 2002.

Banka ka një strategji pesë-tehëshe për t'u marrë me "absorbimin e shtetit dhe korrupsionin administrativ" por që në mënyrë aktive I ndjek vetëm rrugët e kufizuara të përmendura, dhe vetëm deri në përmasat e interesit të qeverisë. Sipas fjalëve të një zyrtari të Bankës, " ne punojmë vetëm aty ku na kërkon klienti".²³¹

Sipas Drejtoreshës ekzekutive të Transparency Macedonia, shumë nga programet trajnuese me sponsorë ndërkombëtarë janë ngjarje në-kohë të cilave u mungon koordinimi dhe përcjellja e tyre më pas.²³² Kjo përcjellje e mbarëvajtjes gjithashtu mungon jashtëzakonisht në dy iniciativat e mëdha anti-korrupsion: Iniciative e Paktit të Stabilitetit e fokusuar gjerë në Anti-korrupsion (SPAI), dhe ajo më në thellësi, por me fushëveprim të kufizuar, puna e GRECO-s së Këshillit të Evropës (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit). Kjo e fundit Përfshin një Komitet Selektues të Ekspertëve mbi Evaluimin e mAsave kundër Larjes së Parave, dhe PACO (Programi kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Evropën Jug-lidore).²³³

Në takimin e madh rajonal të SPAI-t në Tiranë, në prill 2001, qeveria e Maqedonisë garantoj një sërë reformash (gati 30 rekomandime të ndara në pesë "shtylla"). Mirëpo SPAI nuk ka gati asnjë mjet që do të shtynte qeverinë të implementojë rekomandimet,

²³¹ Intervistë e ICG-së me Joel Hellman, specialist për plumb i Bankës Botërore, Sektorit dhe Administrimi Publik, Evropës dhe Rajonit të Azisë së Mesme bërë mes postës elektronike, 15 prill 2002. Pesë rremat e strategjisë së Bankës janë: përgjegjësia politike, sektori konkurrent privat, administrim në sektorin publik, pjesëmarrje e shoqërisë qytetare dhe kufizim institucional. "Antikorrupsioni në tranzicion - kontribut debatit për politikën", Banka Botërore © 200, f. xxii. Strategjia e Bankës kundër korrupsionit përmend katër fusha kryesore: ndaljen e korrupsionit në projektet dhe programet e financuara nga Banka; ndihmë në luftën kundër korrupsionit; bregosje për shkak të korrupsionit, si drejtim dominues në analizën për vendin dhe në gjetjen e zgjidhjeve; dhe kontribut përpjekjeve ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit. Web faqja e Bankës Botërore, "Përpjekjet e Bankës Botërore". ("World Bank Efforts").

²³² "Bashkësia ndërkombëtare dhe krimi i organizuar në Evropën Juglindore", shënime të drejtorit ekzekutiv të Transparncë Maqedoni, Slagjana Taseva, Londër, 18 mars 2002.

²³³ Saferworld rendit një duzinë të iniciativave rajonale të merren me çështjen e krimin dhe korrupsionit të organizuar. "Krimi i organizuar, korrupsioni dhe kontrabanda ilegale me armë në UE-në e zgejdruar", raport i Saferworld, autorë Ian Davis, Chrissie Hirst dhe Bernardo Mariani, dhjetor 2001, f. 31.

përveç konferencave periodike për shqyrtim, ku qeveritë raportojnë përparimet e tyre.²³⁴

Qasja e Këshillit të Evropës përfshin arritjen e standardeve evropiane; forcimin e kapaciteteve përmes bashkëpunimit teknik; dhe duke vëzhguar përputhshmërinë me standardet evropiane. Mirëpo mjetet për "monitorim të përputhshmërisë" janë të rastësishme dhe të kufizuara, dhe koncepti tërësisht injoron metodat për diagnostifikim të dështimeve mbi arritjen e standardeve dhe testimin (jo vetëm krijimin) e kapaciteteve.

GRECO po përgatit një raport që bën vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni, kryesisht në tri fusha: legjislacion, juridiksion dhe sjelljen e ligjeve në fuqi. Edhe pse kjo kuptohet si një 'mekanizëm eficient dhe fleksibël përcjellës', qeverisë do t'i duhen 18 muaj që t'i implementojë rekomandimet pas raportit I cili del në verën e 2002, dhe GRECO nuk do tëë ketë kapacitet ta nxisë këtë.²³⁵ Për një grumbull analizash mbi raportin, GRECO mvaret nga vetë përgjigjet e qeverisë për një pyetësor mjaft të gjatë. Qeveria gjithashtu mund të shqyrtojë raportin dhe të japë komente para se të publikohet

²³⁴ Takimi i fundit u mbajt kah fundi i muajit prill 2002 në Uashington. Megjithatë, përparimi i Maqedonisë në realizimin e obligimeve nga Tirana, prill 2001, nuk ishte pikë e veçantë i takimit. Sipas ekspertëve, hapja e programit për ndihmë teknike është e vetmja mënyrë tjetër për t'i nxitur qeveritë. Intervistë e ICG-së me anëtar të personelit të SPAI-së e bërë përmes telefonit, 11 prill 2002 and 26 korrik 2002. Shtyllat prej I deri IV janë: miratimi i instrumenteve evropiane dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare; promovimi i administrimit të mirë dhe administratë publike e përgjegjshme (sistemi i furnizimit publik; sistemi për administrim me shpenzimin publik; kontrollë financiare; aftësitë e nëpunësit shtetëror; sistem për për kontrollë të jashtme të sektorit publik); kriminalizimi i korrupsionit dhe larja e parave (njësi të specializuara; kapacitete hulumtuese); dhe promovim i transparencës dhe integritetit në punën afariste (pengimi i dhënjes së ryshfetit nëpunësve të lartë publik me rastin e transaksioneve afariste; promovimi i integritetit të punës afariste). Shikoni "Masa kundër korrupsionit në Evropën Juglindore - Shqyrtim i prioriteteve për reformë të shtetit", f. 25-36.

²³⁵ Në vend të kësaj, GRECO mbështetet në "presionin nga kolegët" dhe të "vlerësimit të ndërsjellë". Shikoni "Ç'është GREKO?" në web faqen të Këshillit të Evropës, GREKO. Personat të cilët do të bëjnë vlerësimin, gjithashtu, bëjnë intervista të shkurtëranë vendin e ngjarjes dhe bëjnë kontrollimin e të dhënave të siguruar nga burimeve tjera. Megjithatë, personeli thotë se përgjigjet e pyetësorit bëjnë thelbin e raportit. Komiteti i zgjedhur për vlerësimin e masave kundër larjes së parave është edhe një organizatë e Këshillit të Evropës e cila ka bërë vlerësimin dhe ka botuar raport në qershor 2000.

Një organizatë tjetër rajonale, Iniciativa për Bashkëpunim në Evropën Jug-lindore (SECI), u formua në vitin 1995 me qëllim të nxitjes së një bashkëpunimi më të afërt mes vendeve të Ballkanit, e sidomos në sjelljen e Ligjeve. SECI thotë se qendra e saj në Bukuresht është 'organizata e vetme ndërkombëtare për sjelljen e ligjeve e cila arrin të takojë përfaqësuesit e policisë dhe doganës', dhe kjo organizatë përmban emrin e përfaqësuesit të Doganës së Maqedonisë.²³⁶ Megjithatë, pjesëmarrja në SECI akoma nuk ka shkukur teposhtëzën e dukshme të Maqedonisë, në të cilën supozohet të jetë aktiv reketimi në sektorin e Doganës. Përvoja e Maqedonisë ilustron kufizimin e programeve rajonale në nxitjen e 'bashkëpunimit në sjelljen e ligjeve, kur vetë aktorët shtetërorë janë pjesëmarrës në, ose bashkëpunëtorë të kimit të organizuar.

Mungesa e një përcjelljeje intenzive ndaj përpjekjeve anti-korrupsion por të limituara, nga njëra anë shpjegon përse programet anti-korrupsion në përgjithësi, sipas studimit të hollësishëm të Bankës Botërore, kanë pasur vetëm "rezultate të përziera".²³⁷ Është mirë për SPAI që të jep një strategji anti-korrupsion të ndarë në pesë shtylla, apo për Bankën Botërore që të pajisë strategjinë e saj me pesë tehe, por pa një vëmendje më të madhe për të vëzhguar nëse rekomandimet brenda këtyre shtyllave/teheve janë përkrahur, atëherë shumë pak do të arrihet. Për momentin, asnjë agjensi ndërkombëtare ose aktor në Maqedoni, nuk duket që të besojë se të udhëheqësh apo të koordinosh luftën korrupsionit është përgjegjsi e veta.

Përpjekjet anti-korrupsion gjithashtu vuajnë nga strategji e tepruar dhe taktika të pamjaftueshme. Një zyrtar I lartë I Bankës Botërore duke folur për korrupsionin në një konferencë të rëndësishme, në mënyrë diskrete thotë se " 25 nga 28 vende në rajon kanë 'strategji anti-korrupsion', ndërsa rezultatet janë të mjjerra".²³⁸ Këto startegji, disa herë janë ushtrime që-të-ndjehen-mirë donatorët, të cilët mund 'të shënojnë kutizën' apo rumbullaksojnë se ' diçka

²³⁶ Shikoni web faqen SECI , www.secicenter.org, "Misioni, vizioni, qëllimet Qendrës SECI". SECI gjithashtu mundëson bashkëpunimin e prokurorëve të rajonit.

²³⁷ "Anti-korrupsioni në tranzicion – kontribut debatit për politika" Banka Botërore © 2000, f. 15.

²³⁸ Nëpunës i lartë i Bankës Botërore i cili foli në konferencën për Rrjetin kundër korrupsionit e mbajtur më 31 mars 2002 në Stamboll, e sponsoruar nga OECD-së.

është bërë'.²³⁹ Legjislacioni më I rëndësishëm dhe krijimi I 'kapaciteteve'. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, shtatë vite me seminare, seanca trajnimi, dhe 'krijim kapacitetesh, akoma nuk kanë rezultuar/kontribuuar në një ndëshkim të vetëm ndaj korrupsionit apo krimet të organizuar- madje edhe atje ku komuniteti ndërkombëtar ka pasur dëshmi.²⁴⁰

Profesori Marjanoviç, me një hidhërim të kutpueshëm thotë:

Për hir të zotit, këtu ne jemi duke u marë me harmonizimin e të gjitha ligjeve të mundshme me ato të UE.Ligji për Krime mbikqyrej nga Këshilli I Evropës dhe ndodhi të jetë pa gabime- në një hormoni të mrekulueshme me legjislacionin evropian mbi kriminalitetin! Dhe çfarë ndodhi? Asgjë!...Problemi qëndron aty se askush nuk çan kokën për zbatimin (e ligjit).²⁴¹

Madje edhe përbrenda vetë ligjeve, ekzistojnë boshllëqe. Taseva nga Transparency Macedonia mendon, p.sh; se as për së afërmi nuk i është kushtuar kujdes të mjaftueshëm përpunimit të rregullave, kështu që qeveria do të mund të marrë fitimin nga korrupsioni përmes konfiskimit të pasurive të fituara ilegalisht.

Transparency Macedonia, në përgjithësi, thotë se 'roli I komunitetit ndërkombëtar në përkrahjen dhe monitorimin e veprimtarive anti-korrupsion, se është I pamjaftueshëm'.²⁴² Megjithatë, fatmirësisht, disa zyrtarë të lartë amerikanë, duket të kenë kapur lidhjen mes erozionit të shtetit ligjor në Maqedoni dhe stabilitetit të vendit:

Sot, kërcënimi më I madh ndaj stabilitetit nuk vjen vendet, por nga jopërshtatshmëria e tyre-pamundësia e e demokracive të reja që të kontrollojnë kufijt, të promovojnë shtetin

ligjor, dhe t'u përgjigjen nevojave dhe pasigurive të qytetarëve të tyre. Një vit më parë, këto jopërshtatshmëri u shërbyen ekstremistëve të dhunshëm, të cilët gati sa nuk patën sukses në shpërthimin e një lufte të re Ballkanike, dhe këtë herë në Maqedoni.²⁴³

Por, këto paralajmërime të qarta nuk përcjellen me veprime. Përderisa komuniteti ndërkombëtar nuk përshtat përcaktimin e vet në arritjen e plotë të Marrëveshjes Kornizë me përpjekje të vërteta për të mundur korrupsionin, ai dokument I cili me shumë peripeci e dhimbje qe arritur në Ohër, ka rrezik të mbetet një letër paqeje, që pret një konflikt të ri për t'u grisur dhe rishkruar. Duke anashkaluar korrupsionin, komuniteti ndërkombëtar rrezikon që në Maqedoni ta përsërisë gabimin fundamental që ka bërë gjatë dekadës së kaluar: d.m.th; të interpretojë mungesën e një dhune të hapur si 'përparim', dhe problemet e vështira ti 'fsheh nën qilim'.

²³⁹ Ibid.Duhet shënuar përsëri se në takimin e SPAI-së në Tiranë, prill 2000, Maqedonia veç më ka ndërmarrë një varg të obligimeve ligjislative dhe administrative.

²⁴⁰ Biseda e ICG-së me nëpunës të lartë të Zyrës të përfaqësuesit të lartë nga "Njësia kundër mashtrimit", 29 mars 2002.

²⁴¹ Gjorgji Marjanoviq në *Dnevnik*, 22 prill 2002. Fjalët e pjesëmarrësit nga Republika e Gruzisë në konferencën e paradokohshme kundër korrupsionit. "Veç m ë kemi shumë ligje. Problemi qëndron në faktin se ne nuk i zbatojmë", përsërisin qëndrimin e Marjanoviqit. Konferenca e Rrjetit kundër korrupsionit është e sponsoruar nga OECD-së, Stamboll, 30 mars 2002.

²⁴² "Anti-corupsioni në Republikën e Maqedonisë", dokument i Transparencës Maqedoni, dhejetor 2001, f. 2.

²⁴³ "Strategjia e SHBA-ve për Ballkanin", prezantim nga Greg Schulte, drejtor i lartë për Evropën Juglindore të Këshillit Shtetëror për Siguri, Georgetown University, Washington, D.C., 20 March 2002.

VII. KONKLUDIM: GJETJA E MËNYRAVE PËR TA LUFTUAR KORRUPSIONIN TANI

Ky raport ilustron:

- si stabiliteti I maqedonisë I nënshtrohet korrupsionit endemic dhe dy-etnik në qeveri, dhe
- si komuniteti ndërkombëtar, duke besuar se ka një kontraditë mes konfrontimit të qeverisë mbi korrupsionin dhe arritjen e bashkëpunimit të saj mbi agjendën e ohrit, nuk do që të merret me problemin, përveç se me programet ' e zkonshme'.

ICG mendon se qasja e fundit është e gabuar, Larg nga të qenurit në konflikt me M. e Ohrit, të zëvendësosh një sistem të dëmtuar nga korrupsioni si bazë për të menaxhuar marrëdhëniet ndër-etnike, duhet të jetë prioriteti jetik.

Sidoqoftë, duke paramenduar vetëm se ku dhe si duhet që komuniteti ndërkombëtar të aplikojë përpjekjet e veta, as përafërsisht nuk është e evidente. Siç qe diskutuar, trendi në luftën kundër korrupsionit thekson "një qasje multidimensionale dhe të shenjtë". (p.sh; pesë tehet për Bankën Botërore, madje edhe njëmbëdhjetë shtylla për Transparency International). Një temë e zakonshme ka qenë "krijimi I kapaciteteve" – përforcimi I kornizës ligjore dhe aftësive institucionale, që është në kundërshtim me persekutimin dhe ndëshkimin e individëve të korruptuar. Tjetër gjë që vërrehet ka qenë se ' lufta kundër korrupsionit është një proces afat-gjatë dhe që nuk ndodh shpejt".

Të kuptuarit e këtyre dhe peshoret e tilla mund të jenë të përshtatshme për shumë vende në tranzicion, por jo për një vend që përpiqet që të shkon në atë rrugë përmes konfliktit ndër-etnik, në të cilin korrupsioni ka aq rol tinëzak. Qasjet "afat-gjata" dhe "të shenjta" përmbajnë një gabim përmbajtësor: nga natyra e tyre afatgjate, ato zvogëlojnë sensin e emergjencës. Nëse Maqedonia duhet të avancohet njëmbëdhjetë frontet e ndara për të përparuar më tej (siç do të sugjeronte programi I plotë i Transparency International), atëherë askush nuk mund të prejti që së shpejti të ketë rezultate. Pyetja qëndron në atë se, nëse Maqedonia ka aq kohë për të pritur. Nëse komuniteti ndërkombëtar mbetet në strategjinë aktuale kundër-korrupsion, qeveria gjithmonë do të ketë gati një justifikim me të cilin do të mbronte ngecjen. Transparency International (selia e saj) duket ta lejojë këtë duke nënvizuar rëndësinë e disa

"arritjeve të shpejta" për të kthyer përkrahjen dhe besimin publik.²⁴⁴

Koncepte tjera paralizuese janë insistimet e njëpasnjëshme në "pronësi" (nga qytetarët vendas) dhe "partneritet" (me autoritetet vendore). Përderisa konsultimi në nivel lokal është I rëndësishëm, termi "pronësi" vazhdimisht përdoret me të madhe nga ndërkombëtarët si një arsye për të mbetur përtacë. Në Maqedoni, me përplot OJQ lokale dhe një shoqëri civile të dobët, retorika ndërkombëtare rreth "pronësisë" del të jetë në shërbim të vetes. Pa qenë ndërkombëtarët ata të cilët do të udhëheqin me akuzat (apo të paktën të angazhohen rreth kësaj), përpjekjet e shoqërisë civile si me "koalicionin anti-korrupsion" buk do të çojnë askund. Në të vërtetë, një problem sinjalizues është mungesa e ndonjë shteti apo organizate ndërkombëtare e cila do të ngrihet dhe të luajë rolin kryesor, madje edhe në koordinim të përpjekjeve.

Një paralajmërim I ngjashëm I takon nevojës për " partneritet" me autoritetet. Sikurse edhe në Maqedoni, atje ku është e qartë se qeveria nuk ka anjë interes për t'iu bashkangjitur kësaj lufte , është naive që të insistohet për "leadershipin që nga koka" dhe "partneritetin qeveri-shoqëri civile".²⁴⁵ Udhëheqësia është në një masë të madhe pjesë e problemit në Maqedoni, dhe jo zgjidhja.

Kapitulli i Transparency International (TI) për Maqedoninë aktualisht është duke përgatitur një studim mbi "Sistemin e integritetit Kombëtar" të vendit", që do të ndiqet nga një "Strategji Kombëtare Anti-korrupsion", me kontribut nga disa burime. Ky projekt metodologjik do t'i zbulojë fushat që meritojnë të theksohen. Megjithatë, përvoja nga vendet tjera sugjeron që madje edhe strategjia më e elaboruar dhe më përmbajtësore nuk mund të zëvendësojë hapat për identifikimin e prioritetëve që komuniteti ndërkombëtar dhe shoqëria civile mund t'i ndërmarrin tani. Një pjesë e konsiderueshme e strategjisë së TI me siguri që do të fokusohet në përmirësimin e ligjeve të Maqedonisë, p.sh; në rekomandimin e ndryshimeve në rregullat evidentuese dhe eliminimin e nevojave

²⁴⁴ "Libër burimor TI 2000", Kreu 29: Leksione të mësuara – Raport për përparimin; Pjesa 3 dhe *passim*.

www.transparency.org/sourcebook/index.html

²⁴⁵ Banka thekson se "programi serioz kundër korrupsionit nuk mund të imponohet nga jasht, por ai imponon udhëheqësi të dedikuar nga ana e...qarqet më të larta të shtetit...Një program efektiv domosdo duhet të jetë i përkrahur nga më së larti". "Lufta kundër korrupsionit në tranzicion - kontribut politikës debatuese", f. xxx, Banka Botërore© 2000.

aktuale që, për ndëshkim, një zyrtar I korruptuar duhet që në të vërtetë të kapet në flagrancë. Miratimi i ligjeve kundër " të pasuruarit joligjor" dhe në aktivizimin e konfiskimit të përfitimeve ilegale janë rekomandime të thera të rëndësishme që mund të dalin nga ky studim.

Megjithatë, ekzistojnë dy probleme me theks mbi legjislacionin, E para, siç shënohet më lartë, janë pak mekanizma përcjellës të rëndësishëm për një sërë ligjesh tashmë të propozuar nga SPAI, GRECO dhe të tjerë. Këto shqyrtime siç kanë për synim të fokusohen më shumë në atë nëse një ligj specifik është aprovuar, se sa në kualitetin e direktivave të tij, ose çka është më e rëndësishme, në zbatimin e tij. Në rastin më të mirë, ekziston një besim çka është pak më tepër se "presion nga kolegu" që të inkurajojë përputhshmërinë e vërtetë.

Së dyti, përderisa një legjislacion I ri nevojitet aq shumë, Maqedonisë tani nuk I mungon korniza ligjore për persekutimin e rasteve. Influenca politike mbi persekutimin dhe gjykatave dhe përbrenda policisë duket të jetë një arsye e rëndësishme përse disa raste janë ndjekur penalisht. Në një intervistë me ICG, Prokurori Publik, Stavre Xhikov, nuk ofroi ndonjë arsye bindëse pse nuk janë persekutuar disa nga instancat më flagrante të korrupsionit.²⁴⁶ Një strategji efektive duhet të fokusohet në aktivizimin e sistemit ligjor, dhe jo vetëm t'I dorëzojë më shumë ligje. Siç vërren (selia e) TI "(disa) legjislaturat kanë miratuar ligje... të reja (për luftë kundër korrupsionit) ... Por ligjet dështojnë në çdo vend ku korrupsioni është në sistem, dhe ato më shumë dështojnë nga mungesa e sjelljes së ligjit se sa nga ndonjë papërshtatshmëri të vet ligjeve".²⁴⁷ TI shton, "është një kontraditë e rëndësishme në përpjekjen që të shfrytëzosh një sistem juridik të korruptuar që të përkrahësh Shtetin Ligjor".²⁴⁸

²⁴⁶ Intervistë me prokurorin publik, Stavre Xhikov, 25 prill 2002. Xhikovi përmendi lëndën kundër ministrit të mbrojtjes, paunovskit, si shembull për përpjekjet dhe hetimet e një rasti të ndjeshëm. Gjetja e bazës juridike për nismën e aktakuzës kundër Paunovskit tregon faktin se akuzat e këtylla megjithatë janë të mundura. Por fakti se në një numër të madh të rasteve nuk janë ngrit akuzat tregon se Paunovski ndoshta ka humbur patronatin e establishmentit politik dhe se kriteret politike caktojnë cilat akuzat do të ngriten, e cilat jo.

²⁴⁷ "Libër burimor TI 2002", Kreu 29: Leksioni i mëruar – Raport për përparimin, Pjesa 26., web faqja TI. www.transparency.org/sourcebook/index.html.

²⁴⁸ Ibid. pika 27.

Rekomandimet e ICG (më poshtë) janë dizajnuar ashtu që të plotësojnë strategjinë kombëtare në paraqitje me veprimet që jo vetëm krijojnë kapacitete, por edhe I testojnë ato. Shumë nga këto hapa mund të ndërmerren shpejt, nëse ekziston vullneti ndërkombëtar dhe nëse kërkohen vetëm shpenzime modeste.

Eshte një gjë të mendosh në zgjidhje të kuptueshme, dhe tjetër të arrish marrëveshje mbi ato. Fushata për zgjedhjet në prag të të cilave jemi paraqet një mundësi për progres të shpejtë. Fakti që qeveria mban anën mbojtëse, I jep komunitetit ndërkombëtar forcë të rrallë të ngrisë këto çështje me të. Diplomatat mund t'I mbajnë diskutimet diskrete, (ashtu si MNF) duke I publikuar vetëm nëse dështojnë në përfundimin e marrëveshjes. Liderët qeveritarë vështirë që mund të arrijë t'I japin opozitës dhuratën për t'u dukur këmbëngulës për propozime të pranueshme në krijimin e transparencës dhe kontabilitetit.

Një përparësi tjetër e të vepruarit tani është se zotimet parazgjedhore mund të të strukturohen që të lidhë secilën qeveri të ardhshme. Nga partitë opozitare duhet kërkuar të japin pajtimin e dhe përkushtimin e tyre për të njejtat reforma ashtu si qeveria, dhe madje edhe të nënshkruajnë për Strategjinë Kombëtare Anti-korrupsion (kur të paraqitet). Në anën tjetër, Komuniteti Ndërkombëtar konsiderohet që të fitojë një bashkëpunim më të vogël nëse pret deri pas zgjedhjeve, që të angazhohet me çështjen me cilat do parti, ose parti të vetme, të cilat/ e cila do ta fiton mandatin.

Të shtyjë qeverinë maqedonase të pranojë emërimin e " mbikqyrësve ndërkombëtarë" të cilët do të punojnë në institucionet që në çanti janë të ndjeshme për nga veprimtaritë e korrupsionit, përfshirë edhe Drejtorinë e Doganës, Fondin Shëndetësor dhe Ministrinë e Ekonomisë.

Nëse Maqedonia stabilizohet, ajo duhet të ketë kontroll demokratik dhe të përgjegjshëm mbi kufijt e saj. Kthimi I policisë dhe ushtrisë në ish-zonat e krizës dhe në kufijt (sipas Ma. Së Ohrit) bën pak dallim nëse i gjithë personeli në numër I madh bën lëshime ose madje edhe bëhet pjesëmarrës në korrupsion. Gjithashtu, duke instistuar që Ministria e Financave të përmirësojë mbledhjen e të ardhurave ose decentralizimin e sistemit për kujdes shëndetësor, nuk ka shumë rëndësi nëse fondet qeveritare derdhen të partitë politike ose te individët.

Partitë politike veç më kanë pranuar konceptin e mbikqyrësve në një marrëveshje shtesë e arritur për

Fondin Shëndetësor në lidhje me aprovimin e Ligjit për Veë-qeverisje Lokale. Banka Botërore refuzon konceptin e mbikqyrësve dhe nuk shpreh vullnet ta finansojë atë sepse frikohet që individit dalë joefektiv dhe ekzistimi i kësaj pozite, në fakt, mund të shfrytëzohet të prodhojë kuptim të rrejshëm të sigurisë në lidhje me korrupsionin. Këto janë shqetësime të pranueshme, por vlean të provohet inovacioni dhe Banka duhet ta rimarë në konsideratë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i gatshëm që të zgjedhë çmimin për mbikqyrës të ngjashëm për institucionet tjera qeveritare, ku joshjet nga korrupsioni janë të konsiderueshme. Përgjegjësitë e këtyre mbikqyrësve mund të strukturohen sipas modelit TË Fondit Shëndetësor. Elementet kyçe janë ato se mbikqyrësit fizikisht duhet të vendosen brenda zyrave të qeverisë, në afërsi të zyrtarëve më të lartë, duke pasur qasje të plotë në informatat dhe të dhënat.

Këto ekspertë ndërkombëtarë jo menjëherë do ta largojnë korrupsionin, por ata do të kenë mundësi t'u qasen proceduarve dhe veprimtarive jologjore. Nëse ata injorohen, ata mund të pyesin, pse. Ata mund të balafaqohen me dhe kundër ndërhyrjes politike, disi ashtu siç ndodhi në Bankën Qendrore të Maqedonisë, ku, sipas stafit, prania e Përfaqësuesit Rezident siguron një ekspertizë në vend të ngjarjes dhe ndihmon të pengojë ndërhyrjet politike.²⁴⁹ Aftësia e mbikqyrësve të brendshëm mund të demonstron me suksesin e revizorëve të finansuar nga USAID, të cilët janë të vendosur brenda Departamentit Kroat për Privatizim. Revizorët ofrojnë një 'shqyrtim sekondar' të tenderëve për privatizim, duke siguruar një kontroll mbi " ujdite e arritura brenda-për-brenda".²⁵⁰

"Mbikqyrësit" e tillë godisin baraspeshën mes mbështetjen e madhe në zyrtarët vendorë që t'i

²⁴⁹ Guvernatorët mund të refuzojnë të bëjnë shërbime ashtu që do të thonë "Asnjëherë nuk do të mund ta kaloj këtë për hskak të tipit nga FNM-ja". Precedent tjetër është bërë nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ku brigadiri briatnez shërben si këshilltar i brendshëm. Ministria e Mbrojtjes ka famë shumë më të mirë për sigurinë dhe bashkëpunimin për dallim nga Ministria e Punëve të Brendshme. Një tregim tjetër i suksesshëm nga Kroacia është ai ku një tim i ekspertëve të Price Waterhouse në Fondin për Privatizim ndihmon në sigurimin e transparencës së tërësishme dhe disponimin optimal të pasurisë shtetërore. Intervistë me Price Waterhouse në Zagreb më 14 qershor 2002. Bisedë telefonike me USAID Kroaci, i cili e financon projektin, 28 qershor, 2002.

²⁵⁰ Intervistë me nëpunës të KPMG-së në Zagreb, Kroaci 14 qershor 2002. Biseda të mëtejshme me nëpunësit e USAID-it konfirmuan jetësimin e shqyrtimit të dytë të ofertave të KPMG-së. Intervistë telefonike me nëpunës të USAID-it në Zagreb, 28 qershor 2002.

rezistojnë presionit dhe shkaqeve she involvimit të madh ndërkombëtar. Përgjegjësia mbetet tek qeveria; përderisa mbikqyrësi shërben si këshilltar i besueshëm dhe kanal vital i komunitetit ndërkombëtar, dhe jo një administrator nën hije. Koncepti u shmangjet konfuzitetit "pronësi" (duke u kërkuar maqedonasve të bëjnë më shumë se sa munden), si dhe "protektoratit zvarritës". Relative me çmimet e lejjimit të praktikës së keqe, për të vazhduar, mbikqyrësit gjithashtu janë një ujdj potenciale.

Të shtyjë qeverinë maqedonase të pranojë emërimin e " mbikqyrësve ndërkombëtarë" të cilët do të punojnë në institucionet që në veçanti janë të ndjeshme për ndëshkimin e korrupsionit, përfshirë edhe Zyrën e Prokurorit Publik dhe Jurispudencës.

Nuk do të ketë progres të gjithmbarshëm në luftën kundër korrupsionit deri sa të mos persekutohen rastet flagrante. Paralelisht me përpjekjen që të të shtyjë në funksion dhe të përmirësojë kodin ligjor, Maqedonisë I duhet përmirësojë veprimtarinë e saj në prokurori, polici dhe jurispudencë. Krijimi i 'kapaciteteve' (p.sh; trajnimi kadetëve të rinj policorë, dhe eventualisht përmirësimi i kapacitetit në shërbimin sekret të policisë që të grumbullojë sa më shumë informata dhe atë në kohë, gjë që të përdoren në luftë kundër korrupsionit, si dhe për veprimtari tjera kriminale) është esenciale për një periudhë afat-mesme, por nuk do të merret me neglizhencën dhe malverzimet politike që ekzistojnë tani.

Vendosja e mbikqyrësve në këto lëmi kyçe do të ndihmonte që të standardi të rritet dhe të minimizojë ndërhyrjet politike. Prokurori Publik I The Public Prosecutor has told ICG he could welcome the appointment of such an individual to his office.²⁵¹ Përvoja e njësisë anti-manipulum, në zyrën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë, të sugjeron se sa efektive është prezenca e një ndërkombëtar *përbrenda* sistemit juridik për të inkurajuar pengimin ndaj ndërhyrjeve politike dhe që të tejkalohet letargjinë e sistemit. Njëkohësisht, mbikqyrësit brenda sistemit juridik gjithashtu mund të asistojnë në shmangjen e persekutimeve hakmarrëse ndaj armiqve politikë të qeverisë në pushtet.²⁵²

²⁵¹ Intervistë me prokurorin publik Stavre Xhikov, 25 prill 2002.

²⁵² Analizatorët thonë se ky problem është paraqitur gjatë të dënuarit të korrupsionit në Bullgarinë fqinje, pas zgjedhjeve të fundit: "Siç është gjithkund në Evropën Juglindore dhe në ish Bashkimin Sovjetik, paralajmërimi për dënimin e

Emëro një Këshilltar të UE për Anti-korrupsion (KAK).

Ashtu sikur Përfaqësuesi Special I UE LeRoy e plotëson ditën duke u përpjekur që të bindë qeverinë dhe parlamentin që të projektojnë dhe miratojnë legjislacionin e Ohrit, kështu edhe këshilltari do të angazhohej që të zbatojë agjendën anti-korrupsion.²⁵³ KAK do të negociojë me ministrat dhe parlamentarët që të projektojnë ligje pa boshllëqe dh të veprojnë si kanal udhëheqës politik për "vëzhguesit ndërkombëtarë" në raste kur ata hasin në pengesa. Në të njëjtën mënyrë, KAK do t'i paralajmërojë ambasadat, Delegacionin e Komisionit Evropian dhe zyrtarët elartë ndërkombëtarë nëse has në pengesa tejet të vështira gjatë punës. Për të siguruarfuqi të mjaftushme gjatë punës me zyrtarë të vendit, KAK duhet të ketë autorizim që të rekomandojë suspenzimin e finansimit nga donatorët, atëherë kur e kërkon nevoja, dhe donatorët e medhej duhet të zotohen që të respektojnë rekomandimet e tilla. KAK, gjithashtu, në mënyrë të dobishme do të koordinohej me, ndihmojë dhe përkrahë përpjekjet anti-korrupsion nga ana e grupeve të shoqërisë civile dhe iniciativave të strukturave ndërkombëtare, siç është Pakti I Stabilitetit dhe Këshilli I Evropës.

Disa liderë të shoqërisë civile në Maqedoni e kanë përkrahur publikisht idenë për KAK, përfshirë këtu edhe drejtorshën ekzekutive të Transparency Macedonia- Slagjana Taseva, Profesorin Vlado Kambovski dhe Profesorin Gjorgji Marjanoviç.²⁵⁴ Në një takim me ICG më 6 mars 2002, Kryeministri Georgievski dha pëlqimin e tij imediat për konceptin, edhe pse deklaratat pasuese

korrupsionit nga ana e Qeverisë bulgare ndonjëherë më shumë duket si mjet për zvogëlimin e famës së parardhëses të saj, se sa si tentim të paanshëm për të mënjauar të keqen e cila saboton përparimin ekonomik, veçanërisht kur personat e involvuar i takojnë, ose kanë marrëdhëne të afërta me regjimin qeverisës. Prandaj, opinioni këto paralajmërime për dënimin e korrupsionit i shikon me cinizëm dhe indiferencë". "Bullgaria dhe korrupsioni", Ulrich Buechsenschuetz, Radio Evropa e Lirë, 28 qershor 2002.

²⁵³ Për shkak të zgjerimit të interesave të tij në Maqedoni, Unioni Evropian do të mund të vendoste dhe të operacionalizonte me sukses funksionin e KAK-së dhe prej të marrë rolin udhëheqës në përpjekjet për të fituar pushtet të mirë. Çështja rreth asaj se a duhet bartësi i pozitës t'i përgjigjet drejtpërdrejt Këshillit apo Komisionit, më së miri do të zgjidhet nga ana e miratuesve të brendshëm të vendimeve të UE-së.

²⁵⁴ "ICG kërkon ndihmë nga jasht kundër korrupsionit", *Utrinski Vesnik*, 13 mars 2002. Citim i Marjanoviçit në intervistën e dhënë për *Aktuel*. op. cit.

tregojnë më pak entuziazëm për masat pro-aktive.²⁵⁵

Të kushtëzohet ndihma financiare për qeverinë, në veçanti në balancin e pagesave dhe buxhetin, për ta marrë më seriozisht procesin endërmarrjes së reformave anti-korrupsion.

Konferenca e donatorëve në mars të 2002, jo vetëm që solli angazhime për rindërtim dhe implementim të M. së Ohrit, por edhe për përkrahje të defiçitit në balancin e pagesave. Në fakt, komponenti më I madh I vetëm I ndihmës së premtuar ishte infuzioni në kesh po për këtë qëllim. Edhe pse donatorët I kanë ndalur pagesat e tjera me dështimin e negociatave të FMN, shuma prej 50 milionë dollarë veç më ishte paguar. Ndihma apo kreditë akoma të pa paguara (tjetër nga ajo lë në mënyrë të drejtpërdrejtë ka lidhje me rikthimin e popullsisë nëpër shtëpi apo implementimin e Marrëveshjes), në mënyrë specifike duhet të përfshijë angazhimet dhe kushtet duke marrë parasysh korrupsionin-p.sh; pranimi I vëzhguesve ndërkombëtarë dhe Këshilltarit për Anti-korrupsion, siç u tha më lartë.

Edhe pse vështirë, do të ishte e nevojshme, që në bashkëpunim me qeverinë maqedonase të arrihen referenca realiste në vlerësimin e besimit të mirë dhe efikasitetit, me të cilat ajo sulmon korrupsionin. Po kështu, edhe për donatorët do të jetë vështirë të sjellin gjykime sa u përket pyetjeve siç janë: sa përqind nga ndihma e mundur mund të lirohet dhe me sa përqind të suksesit të sigurtë të Qeverisë. Sidoqoftë, thjesht nuk ka arsye që donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare të hezitojnë për një diskutim direkt me qeverinë e cila kërkon një asistencë të madhe financiare. Shikimi i thjeshtë mbi korrupsionin, përderisa japësh një ndihmë të kënaqshme, në të vërtetë do të ishte sikur të veprosh si ndonjë nga ata që mundësojnë shprehinë e e të korruptuarit, e cila dobëson si ekonominë ashtu edhe sigurinë e vendit.

Përkrahje Komisionit Anti-korrupsion

Ligji Anti-korrupsion I miratuar në prill të 2002, edhe pse pas gjashtë muaj, siguron krijimin e një Komisioni Anti-korrupsion. Nga fundi I vitit, Kuvendi është I obliguar të miratojë "Ligjin mbi Avokatin Popullor" që del nga M. e Ohrit, me qëllim që të forcojë pushtetin e Obudsman-it ekzistues.

²⁵⁵ Idea për këshilltar u paraqit para Kryeministrit. Ai "do të kishte funksionuar njësoj si [i dërguari special i UE-së]LeRoy, por në fushën e korrupsionit".

Joshja për devalvimin e luftës anti-korrupsion mbi Ombudsman-in duhet të rezistohet. Ajo që zyrtari veç më ka një përgjegjësi të madhe për mbrojtjen e të drejtave e cila rrjedh nga Marrëveshja e Ohrit (p.sh; të vetë-ruajsh parimin e përfaqësimit të barabartë) që në mënyrë të paevitueshme kërkon pjesën më të madhe të kohës në detyrë. Në kontakt, Komisioni ka për qëllim të fokusohet ekskluzivisht në përpjekjet anti-korrupsion. Ky duhet marë si institucioni primar qeveritar për këtë qëllim, dhe sipas kësaj, që ia vlen të ketë përkrahje dhe të ndihmohet financiarisht. Megjithatë, për momentin nuk është paraparë asnjë finansim specifik ndërkombëtar për Komisionin. Kjo duhet të korigjohet, në mënyrë që të fillojë të veprojë në mënyrë efektive menjëherë pasi të nisë punën në tetor të 2002. Donatorët gjithashtu duhet të jenë vigjilentë dhe të ushtrojnë presion për atë që është e nevojshme, në mënyrë që të sigurojnë që ata që do të emërohen në Komision kanë kualifikime të përshtatshme dhe nuk janë veç se "të dërguar politikë".

Të caktojnë qëllime që do të sjellin rezultate sa I përket ndëshkimit dhe konfiskimit.

Përpjekjet anti-korrupsion në Maqedoni duhet të fokusohen jo vetëm në legjislacionin dhe krijimin e kapaciteteve, por edhe në ndëshkimin e mashtruesve dhe konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme. Në vend të qëndrimit të qetë dhe të kënaqur sa herë që parlamenti aprovon ndonjë ligj të ri, komuniteti ndërkombëtar (dhe shoqëria civile) duhet të caktojë caqe, relevante me ato ligje, që të ushtrohet presion ndaj institucioneve qeveritare, përfshirë edhe gjyqet, që këta të veprojnë sipas tyre.

Përkrahje Përpjekjeve të Transparency International në Maqedoni që të zhvillojë një Strategji anti-korrupsion dhe përpjekjeve në krijimin e "një koalicioni anti-korrupsion".

Transparency International, deri tani ka identifikuar katër masa legjislative "immediate"

- ndryshimin e Ligjit anti-korrupsion, në mënyrë që t'I mundësojë Komisionit Anti-korrupsion për të qenë më efektiv që nga vetë starti;
- ndryshimin e Nenit 17 të Kushtetutës që lejon përgjimin;
- sjelljen e masave për konfiskime në vet kodin kriminal; dhe
- përmirësimin e dispozitave dëshmore direktivave evidencuese në kodin kriminal

TI gjithashtu ka identifikuar tri masa legjislative afat-mesme:

- projektimin dhe miratimin e ligjit mbi intereset që bijnë në konflikt;
- projektimin dhe miratimin e ligjit mbi qasjen e lirë në informata; dhe
- krijimin e një bashkëpunimi rajonal për iniciativat kundër korrupsionit.²⁵⁶

TI më tutje parashtron nevojën e kufizimeve mbi "të qenurit diskret" sa I perket zyrtarëve publikë, siç është strategjia "shërbehet ai që vjen I pari" për korigjimin e keqpërdorimeve në shitjen e kontigjenteve.

Deri tani, vetëm Delegacioni I UE, dhe ambasada e SHBA, Britanike dhe Hollandeze kanë shfaqur interesim në përkrahje financiare të përpjekjeve të TI në Maqedoni. Nëse iniciativat e paqëndrueshme të shoqërisë civile do të kenë sukses, atëherë esenciale është një përkrahje më e gjerë ndërkombëtare. Në veçanti, me projektimin e strategjisë dhe me identifikimin e masave prioritare mbi legjislacionin dhe të tjerave, shoqërisë civile do t'I nevojitet një përkrahje e fortë ndërkombëtare, me qëllim që t'I konvertojë ato në startegji publike dhe ligje.

Angazhimi I Partive shqiptare dhe shoqërisë civile në përpjekjet anti-korrupsion.

Për arsye se shumica e përpjekjeve që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe reformat qeveritare, përqëndrohen në Shkup, arrish në përfundim se ka tendencë që koncentrimi të jetë në komunitetin maqedon. Legjislatorët shqiptarë dhe ekspertë të veçantë si Xhevat (Xhevdet) Hajredini, ish-ministër I Mbrojtjes dhe kryetar aktual I "koalicionit anti-korrupsion", mund të angazhohet në fushatën, por jo dhe komunitetit shqiptar, më gjerë.. Sidoqoftë, anketat tregojnë se shqiptarët janë vazhdimisht në dijeni mbi korrupsionin dhe po atë që irrituar sa edhe maqedonët.

Përderisa implementimi I M. së Ohrit tenton të shikohet nga një pjesë e madhe e vendasve si një llijë me rezultat zero, për t'I plotësuar kërkesat e shqiptarëve, angazhimi me partitë politike

²⁵⁶ "Plan veprimi- Koalicion: Maqedonia pa korrupsion", 22 prill 2002, f.2. Edhe pse ishte i identifikuar nga ana e Delegacionit të Komisionit Evropian në vend të TI-së, Ligji për Financim të partive politike gjithashtu do të kishte qenë qëllim i vlefshëm.

shqiptare, shoqëria civile dhe mediat ndaj problemit të korrupsionit, siguron një rast për dialog dhe bashkëpunim mes dy grupeve më të mëdha etnike. Kjo do t'u ndihmonte maqedonasve që të fillojnë ta shohin Marrëveshjen jo thjesht si një plan për "terroristët që të ekspozohen si luftëtarë për të drejta të njeriut", por si mjet për krijimin e institucioneve më të besueshme, në të gjithë nivelet qeveritare.

Relaksimi I restriksioneve të MNF për punësimin e një peroneli shtesë në Zyrën e Revizionit Shtetëror.

Zyrtarët në Zyrën e Revizionit Shtetëror, në mënyrë të hapët argumentojnë se restriksionet buxhetare ashpër pengojnë mundësinë e tyre që të ushtrojnë qoftë edhe një sasi të vogël të revizionit për të cilën ata janë të obliguar. Madje edhe nga ky pozicion ata del që të kenë zbuluar parregullsi të mëdha. Si një komponentë vitale në krijimin e një baze për hulumtime të mëtejshme e rasteve të korrupsionit që duhet të persekutohen, Zyra e Revizionit Shtetëror duhet të përjashtohet

nga restriksionet strikte për punësim të gjerë qeveritar, të imponuara nga FMN. Një Zyrë më efektive e Revizionit Shtetëror mund të bëhet më parë një "shumëfishues buxhetar" sesa një kompenzimi i shpenzimeve të stafit shtesë.

Për këtë zyrë gjithashtu duhet të konsiderohet edhe "Binjakëzimi" I ekspertëve ndërkombëtarë për revizion.

Inkorporimi I elementeve "përcjellës" në të gjitha programet e trajnimit për anti-korrupsion.

Mungesa e përcjelljes është një problem i zakonshëm në programet që disa vende dhe organizata ndërkombëtare I organizojnë për trajnim të zyrtarëve vendorë në teknikat për reduktim të shkallës së korrupsionit. Kursi mbahet, instruktori largohet, dhe askush nuk kontrollon se si dhe nëse metodat e reja aplikohen. Nëse duam që të jetë efektiv, trajnimi anti-korrupsion duhet të inkorporojë një formë që të përcjellë mbarëvajtjen e shkathtësive të fituara. Për t'iu shmangur shpenzimeve që do të mbulonin ardjen e ekspertëve në Maqedoni, donatorët mund të bashkëpunojnë me TI apo OJQ tjera për të monitoruar implementimin.

Të limitohet fushëveprimi I partive politike gjegjëse në emërimin e stafit punues.

Kufizimi I mundësive për patronazh politik duhet të jëtë prioritet në secilën betejë për një qeverisje të

